



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Kaçanikut
Opština Kaçanik
Municipal Kaçanik
Kuvendi i Komunës
-Kryesuesi i Kuvendit-

01Nr. 60/01-14754/23
Kaçanik, 21.06.2023

FTESË PËR MBLEDHJE

Të nderuar Anëtarë të Kuvendit të Komunës,

Në bazë të nenit 43 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, e thërras mbledhjen e VI (gjashtë) të Rregullt të Kuvendit të Komunës Kaçanik për vitin 2023.

Mbledhja do të mbahet në sallën e kuvendit të komunës, në katin e tretë të objektit të komunës, me 30 qershor 2023 (e Premte) në ora 11:00.

Mbledhjen do ta kryeson dhe udhëheq Kemal Murseli, Kryesues i Kuvendit.

Ju mirëpresim!

Me respekt!

Kryesuesi i Kuvendit
Kemal Murseli

Në mbledhjen e Kuvendit të Komunës të datës 30.06.2023 do të shqyrtohet ky:

REND PUNE

1. Aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja e kaluar e Kuvendit të Komunës;
2. Propozim Rregullore për mënyrën dhe kushtet e shfrytëzimit të shtëpisë së kulturës “Xheladin Kurtaj” në komunën e Kaçanikut;
3. Korniza Afatmesme Buxhetore (KAB) e komunës së Kaçanikut 2024-2026;
4. Raporti i Auditimit për pasqyrat financiare vjetore të komunës së Kaçanikut, për vitin 2022;
5. Plani i Veprimit për zbatimin e rekomandimeve të dhëna në Raportin e Auditimit, nga Zyra Kombëtare e Auditimit për PFV 2022;
6. Propozim Vendimi për transferin e mjeteve nga rezerva komunale, sipas buxhetit të vitit 2023;
7. Propozim Vendimi Paraparak për dhënien e pronës së paluajtshme të komunës në shfrytëzim afatgjatë dhe afatshkurtër, në Zonat Kadastrale: Doganaj, Koxhaj, Begracë, Kaçanik;
8. Propozim Vendimi për formimin e komisionit vlerësues për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës;
9. Propozim Vendimi për ndarjen e masës drusore të konfiskuara, shkollave të komunës;
10. Raporti i KRM “ Pastërtia” SH.A- Njësia Kaçanik, lidhur me menaxhimin e Parkingjeve publike në komunën e Kaçanikut;
11. Kërkesa e MMPHI, për Rishqyrtimin e Vendimit 01Nr. 104/02-9142/23 i datës 28.04.2023 për shpallje me interes të përgjithshëm publik të pjesës së PK Nr. 00516-1 ZK Kaçanik, për rregullimin e rrugës dhe ndërtimin e urës mbi lumin Nerodime;
12. Kërkesa e MMPHI për Rishqyrtimin e Vendimit 01Nr. 104/02-11896/23 të datës 30.05.2023, për caktimin e lokacionit për nevoja të HANDIKOS.



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Kaçanikut
Opština Kaçanik
Municipal of Kaçanik

01Nr. 60/01-11910/23
Kaçanik, 30.05.2023

PROCESVERBAL

Nga mbledhja e **V(pestë)** e rregullt e Kuvendit të Komunës Kaçanik për vitin 2023 (Legjislatura e shtatë), mbajtur me 30 maj 2023. Mbledhja u mbajt në katin e tretë të objektit të komunës, në sallën e kuvendit, në ora 11:00.

Nga përbërja e përgjithshme e Kuvendit të Komunës prej 27 anëtarëve, pjesëmarrës në mbledhje ishin 26 anëtarë. Në mbledhje me arsye mungoj, Betim Shala.

Nga Ekzekutivit i Komunës, në mbledhje morën pjesë: Kryetari i Komunës-Besim Ilazi, Nënkryetari i Komunës- Sabedin Vishi, Drejtorët e drejtorive: Zahir Doda-DA, Ramadush Osmani-DSHPE, Qamil Stagova- DUKMM, Suhad Dullovi- DBPZHR, Dardana Tafili-Dauti-DAP, Pranvera Loku-Zharku- DZHET, Sali Malsiu-DSHMS, ndërkaq nga zyrtarët e komunës në kuadër të detyrave të punës ishin: Bejtulla Dalloshi, Fadil Guri, Fatlume Guri-Selimi, Mavije Murseli, pati edhe zyrtar tjerë komunal.

Nga strukturat vendore mbledhja monitorohet përmes Teleprezencës nga Gëzim Sahiti- zyrtar i lartë për monitorim të komunave në MAPL. Mbledhja ka transmetim të drejtpërdrejtë.

Mbledhjen e kryesoj, Kemal Murseli- Kryesues i Kuvendit
Procesmbajtës, Makfire Malsiu.

Kryesuesi i Kuvendit z. Kemal Murseli: Të nderuar pjesëmarrës, së pari iu përshëndes të gjithëve, iu dëshiroj mirëseardhje, konstatoj kuorumin, prezentë janë 26 anëtarë, me arsye mungon Betim Shala. Kushte pune me u mbajt mbledhja ka, e hapi mbledhjen e V (pestë) të rregullt të Kuvendit të Komunës për vitin 2023, data 30 maj, me këtë:

REND PUNE

1. Aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja e kaluar e Kuvendit të Komunës;
2. Draft Plani komunal për Ri integrimin e qëndrueshëm të personave të riatdhesuar dhe integrimin e të huajve në komunën e Kaçanikut, 2023-2025;
3. Propozim Vendimi për Shfuqizimin e Vendimit 01Nr. 104/02-7676/22 për dhënien në menaxhim të përkohshëm parkingjet në pronësi të komunës, ndërmarrjes publike KRM “ Pastërtia, Sh. A- Njësia në Kaçanik;
4. Propozim Vendimi për Emërimin e komisionit përzgjedhës për Drejtor të institucioneve arsimore;
5. Propozim Vendimi për shpallje me interes publik pjesën e PK 00382-2 ZK Bajnicë, në emër të Xhemal Fazli, për këmbim me pjesët e parcelave 00379-0; 00384-0, pronë shoqërore rrugë publike;
6. Propozim Vendimi për shpallje me interes publik pjesën e PK 00439-1, ZK Duraj, në emër të Adem Salihaj, për këmbim me pjesën e parcelës 00452-0, pronë shoqërore rrugë publike;

7. Propozim Vendimi për shpallje me interes publik pjesën e PK 00905-2, ZK Nikaj, në emër të Fatmir Gula, për këmbim me pjesën e parcelës 00920-1, pronë shoqërore rrugë publike;
8. Propozim Vendimi për shpallje me interes publik pjesët e PK 00980-0; 00982-0, ZK Kaçanik në emër të Naser Dema, për këmbim me PK 00979-0, pronë komunale;
9. Propozim Vendim për caktimin e lokacionit për nevoja të HANDIKOS;
10. Raporti i punës i Komitetit për Komunitete për vitin 2022;
11. Propozim për organizimin e një punëtorie me anëtarët e KK, për çështjen e PZHK.

Pika e 11 u propozua nga Kryesuesi i Kuvendit, i cili theksoj se këtë çështje e kemi diskutuar edhe në KPF, ndërkaq një diskutim publik lidhur me PZHK u mbajt në sallën e KK, por pjesa dërmuese nuk ishin. Grupi punues ua kam ofruar si njoftim, diskutojmë dhe e marrim një vendim se ku do të mbajmë punëtorinë. Lidhur me rendin e propozuar të punës e hapi diskutim:

znj. Ardita Rrahmani: Të pika 2, në mbledhjen e KPF kemi kërkuar një raport të kompanisë “Pastërtia” për menaxhimin e parkingjeve publike. Nëse nuk ka raport, kërkoj të shtyhet kjo pikë për mbledhjen vijuese, se nuk mundemi me diskutuar pa e pasur një raport pune, për me ditur sesi janë menaxhuar parkingjet publike.

Kryesuesi i Kuvendit: Kur të vijmë të ajo pikë diskutojmë, e shikojmë arsyetimin e drejtorit dhe mundem me hequr nga rendi i punës. Kërkesa është se kompania “Pastërtia” nuk po mundet me menaxhuar parkingjet, ndërkaq llogari mundem me kërkuar jo vetëm sot, por çdo herë nga të gjitha kompanitë publike.

z. Adnan Reka: Unë sa po e kuptoj kolegen, ajo nuk po pajtohet me rendin e ditës.

znj. Kadrije Lika –Troni: Unë në mbledhjen e KPF e kërkoja raportin e kompanisë “Pastërtia” për menaxhimin e parkingjeve publike, u kuptuam edhe me nënkryetarin që raporti me na ardhur në email deri me mbledhje të KK. Nënkyetari na ka thënë: Nëse nuk vjen raporti për mbledhje të KK, e tërheqim këtë pikë nga rendi i ditës në mbledhje të KK. Nënkyetari mundet me treguar për këtë çështje, ndërkaq nëse drejtori ka pasur ndonjë arsyetim, është dashur me na e dërguar.

Kryesuesi i Kuvendit: Duhet të jemi të qartë se raporti nuk u kërkuar vetëm nga znj. Kadrije, raporti është kërkuar edhe nga unë, fillimisht unë e kam kërkuar raportin.

Nënkyetari i Komunës-Sabedin Vishi: Në mbledhjen e KPF drejtori i DSHPE nuk ka qenë në mbledhje. Unë e kam marrë për obligim me ia përcjellë drejtorit, kërkesën e pozitës dhe opozitës për këtë pikë. Drejtori është i informuar që keni kërkuar raport financiar. Për me gjerë sqarime iu jep drejtori.

z. Ramadush Osmani: Kërkesa e juaj me ka ardhur me kohë. Me të drejtë keni kërkuar një raport të tillë. Ju e dini se ndërmarrja publike, KRM “Pastërtia” është ndërmarrje regjionale, ndërkaq vetëm në aspektin financiar e kemi nda. Hartimi i raporteve financiare ka një procedurë, raporti duhet me u miratua edhe në Bord të Drejtorëve-BD. Raport të thjeshtë unë mund të kërkoj për me na i sqaruar procedurën, por për me ardhur me protokoll, ai raport kërkon miratim në BD. Unë e kam kërkuar raportin dhe shumë shpejt do të iu vjen. Arsyeja pse është iniciuar kjo procedura e shfuqizimit të vendimit, ka të bëjë me një vendim të mëhershëm, mbi bazën e të cilit është lidhur marrëveshja, në një nen e lënë të drejtën e ndërprerjes së marrëveshjes me një paralajmërim. Kjo është marrëdhënie kontraktuese e shfrytëzon të drejtën e vet secili deri me periudhën e caktuar dhe kërkon me ia mundësuar me liru. Janë këto procedura, ndërkaq nuk mundem me mbajtur me obliguar kompaninë me i kryer shërbimeve. Raporti financiar ka me iu ardhur brenda muajit si njoftim i protokolluar dhe i nënshkruar nga zyrtarët financiar të kompanisë. Ata e vlerësojnë se nuk mund të vazhdojnë t’i menaxhojnë parkingjet, ajo është në kundërvlerë me mirëmbajtjen e hapësirave publike. Ne

nuk kemi kërkuar asgjë financiarisht siç ka qenë me herët marrëveshja me kompaninë private, ku në kundërvlerë është paguar mirëmbajtja, të kjo në kundërvlerë ka qenë menaxhimi i parkingjeve, mirëmbajtja e hapësirave publike. Tani ne për mirëmbajtje të hapësirave publike duhet me pasur një të hyrë, pasi nuk i mirëmbajnë më, ne duhet gjetur formën për mirëmbajtjen e tyre.

Kryesuesi i Kuvendit: Arsyeja është se ata munden me i pasur kontratat e kufizuara të punëtorëve, të cilët edhe ashtu nuk janë duke qëndruar, kështu shfuqizimi i vendimit i hap rrugë komunës me i udhëhequr procedurat për menaxhimin e parkingjeve dhe mirëmbajtje të hapësirave publike, pasi që jemi në sezonin e verës, ku pritet fluksi i mërgimtareve dhe mund të mbesin pa mirëmbajtje dhe pa mbikëqyrje. Kjo është arsyeja që është në rend pune kjo pikë, me diskutuar e vendosur bashkërisht. Raporte financiare dhe raporte të punës ne mund t'i kërkojmë kompanisë çdo herë, sepse ata e kanë obligim me i raportuar KK me raport të punës dhe atë financiar. Arsyeja që e kemi futur në rend pune, është të përshpejtojmë si procedurë, sepse ata nuk kanë me pasur mundësi me mbajtur, kështu të hapet rrugë për mirëmbajtjen e hapësirave dhe menaxhim të parkingjeve. Llogari kemi të drejtë me kërkuar çdo herë, jo vetëm sot, dhe vendimin duhet me shfuqizuar, sepse kompania nuk po mundet me mirëmbajtur dhe menaxhuar, kjo ka qenë arsyeja që mos me ngecë si proces, ndërkaq koha është e vërtetë se ka qenë e shkurtër për raport financiar apo të menaxhimit.

znj. Ardita Rrahmani: I vetmi arsyetim është ajo që e kemi diskutuar në KPF, me pasur një raport për punën 1 vjeçare të menaxhimit të parkingjeve publike dhe ju në KPF na keni premtuar se nëse na vjen raporti e shqyrtojmë këtë pikë. Këtë çështje e dinë edhe nënkryetari në mbledhje. Besoj se edhe drejtori është i informuar për kërkesën tonë. Nuk jemi kundër shkëputjes së kontratës, por lëndës t'i bashkëngjitet raporti. Kërkesa e kompanisë është e datës 11 maj, besoj se edhe drejtori është i informuar që njëherë me u sjellë raporti financiar, pastaj kërkesa për shkëputje të kontratës. Mundet me qenë diçka shumë e vogël, por po na bëhet shprehi për hera tjera. Ju mundeni me shtruar në votim, e keni shumicën dhe kalon, por mos të jetë kjo një praktikë, se sot është çështja e kompanisë "Pastërtia", nesër një kompani private. Besoj se këtë herë keni me pasur parasysh kërkesën e opozitës.

z. Agim Mani: Ne në mbledhjen e KPF në mënyrë unanime kemi qenë për atë që, nëse nuk vjen raporti financiar në KK, me e tërhequr këtë pikë. Kjo duhet me i shërbyer edhe ekzekutivit, se raporti financiar është një pasqyrë me të cilën mundesh me arritur marrëveshjen. Nëse nuk e keni një pasqyrë dhe lidhni një marrëveshje, përsëri keni me dështuar, se marrëveshjen të cilën e keni bërë me herët, është bërë pa një analizë dhe ka dështuar.

Kryesuesi i Kuvendit: Rendin e punës e shtroj në votim për aprovim dhe i njëjti u aprovua me shumicën e votave Për, Kundër ishin 8 anëtarë, Abstenoj 1- Raif Kasa. Prezentë 26. Në sajë të kësaj del konstatimi së Kuvendi i Komunës,

APROVOJ

Rendin e punës në përbërje prej 11 pikave.

U kalua në shqyrtimin e pikëve sipas renditjes:

Kryesuesi i Kuvendit: Procesverbalin e mbledhjes së kaluar të KK u aprovua njëzëri pa vërejtje. Në sajë të kësaj del konstatimi së Kuvendi i Komunës,

APROVOJ

Procesverbalin e mbledhjes së IV (katërt) të Rregullt të Kuvendit të Komunës Kaçanik, të datës 28.04.2023 / Lënda: 01Nr.60/01-9199/23.

Kryesuesi i Kuvendit: Kalojmë në pozicionin e Pyetjeve dhe Kërkesave:

Pyetje dhe Kërkesa

z. Adnan Reka: 1. Kam një pyetje lidhur me shkollën fillore "Emin Duraku" në Kaçanik. Për kundër faktin se kjo shkollë është në gjendje të keqe, dhe për kundër renovimeve që janë bërë në vitin e kaluar në atë shkollë, tualetet në gjendje të keqe dhe primitive mbesin shqetësim i madh për fëmijët dhe prindërit e tyre, e aq me tepër për fëmijët me nevoja të veçanta të cilët i ndjekin mësimet në atë shkollë. Si rezultat i gjendjes së tualeteve, shumë fëmijë nuk dëgjojnë qysh në fillim të jenë nxënës të asaj shkolle dhe refuzojnë t'i shfrytëzojnë tualetet e tilla të papërshtatshme për moshën e tyre. Kërkojmë të keni konsideratë këtë çështje, të merrni veprime të nevojshme në këtë drejtim, që mos ti cenohet askujt e drejta për shkollim fillor, përfshirë edhe kategoritë e fëmijëve me nevoja të veçanta.

2. Pyetja e dytë ka të bëjë me një rrugë publike: Çfarë po ndodhë në rrugën "Diaspora" që nuk është asfaltuar ende. A ka gjasë që kjo rrugë të asfaltohet, sepse kemi të bëjmë me një rrugë që i përket zonës së I-r tatimore.

znj. Kadrije Lika -Troni: 1. Në shkurt të vitit 2022, në fillim të mandatit, na pati kërkuar nga një foto për ID zyrtare për të gjithë anëtarët e KK. Nuk e kam të qartë, a iu kanë dashur për me na pajisur neve me to, apo për me i vendosur në dosje ?

2. Të Çerdhja e fëmijëve, muret jashtë çerdhes që po plasariten për një kohë kaq të shkurtër, duhet me i rinovuar dhe me vendosur muri pas murit. Për këtë kualitet kaq të dobët, a është kërkuar llogari nga kompania punuese, sepse dikush duhet me u përgjigjur për këtë, sepse nuk është në rregull me vendosur muri pas muri me taksat e qytetarëve? Muri i dytë që është vendosur, e ka dëmtuar atë hapësirë të vogël gjelbëruese. Desha me ditur, a është shndërruar në parking ajo pjesë e vogël gjelbëruese, sepse ajo punë është lënë në gjysmë ose gjelbërim ose parking, kur e shohim që sa muaj janë përfunduar punimet në urë?

z. Agim Çaka: 1. Rruga që është duke u punuar të hekurudha -rruga që na dërgon të ETC, muri mbrojtës e kam pa se është përfunduar. A e kanë marrë obligim hekurudha me punuar, apo është obligim i komunës. Rruga duhet me u shtruar, nëse jo me asfalt, me zhavorr deri të ETC që me qarkulluar qytetarët me makina në dy drejtimet, se vetëm njëri drejtim qarkullon aty.

2. Një shenjë e komunikacionit në bulevardin "Ismail Raka", shpejtësia e lejuar 40 km në orë, mendoj se ajo shpejtësi nuk mund të zhvillohet, se është rrezik për qytetarët që kalojnë atypari.

3. A janë lejuar lejet e ndërtimit apo jo ? Pse nuk po epën leje të ndërtimit për ndërtime të larta, a është në pyetje PZHK apo çka është në pyetje?

znj. Ardita Rrahmani: Kam një pyetje lidhur me shtyllat e betonit në rrugën "Burim Rexha" dhe "Nazmi Osmani" - lagjia Ismajli, Kam biseduar me drejtorin e DSHPE, Ramadush Osmani, por nuk ka ndonjë rezultat. Shtyllat e energjisë elektrike janë nga viti 1968. Pse nuk merrni ndonjë veprim të nevojshëm drejtor, se keni të bëni me lagjen e juaj, se shtyllat rrezikojnë jetën e qytetarëve të atij lokaliteti ?

z. Ramadush Osmani: Unë nuk punoj në KEK, nuk ka të bëjë me përgjegjësitë e DSHPE.

Kryesuesi i Kuvendit: Pyetje dhe Kërkesa tjera nuk ka, kalojmë në pikat vijuese sipas renditjes:

2. Draft Plani komunal për Ri integrimin e qëndrueshëm të personave të riatdhesuar dhe integrimin e të huajve në komunën e Kaçanikut, 2023-2025;

Komuna jonë ka pasur një plan 3 vjeçar, të cilit i ka kaluar mandati, tani është bërë plani i ri. Zyrtari përgjegjës Fadil Guri është prezent. E hapi diskutimin:

z. Agim Mani: Draft plani është 3 vjeçar për periudhat kohore 2023-2025, ku janë paraqitur objektivat, aktivitetet dhe masat për arritjen e objektivave. Plani përcakton institucionet përgjegjëse dhe mbështetjen për arritjen e objektivave saktësisht kornizën kohore për secilin

aktivitetet. Natyrisht ky plan ka edhe kosto financiare. Kryetari i komunës e ka marrë një vendim për formimin e grupit punues i cili grup ka punuar në këtë plan. Ky vendim në përmbajtje nuk është hartuar mirë. Të pika 1. thuhet: Sipas pikës 1. të këtij vendimi, grupi punues obligohet që të merr të gjitha veprimet sipas pikës 1. Tjetër, pasi që ky grup punues e ka hartuar një draft plan, sa ka mandat ky grup dhe kush do të mbikëqyrë realizimin e këtij plani? Mendoj se kjo është dashur të shënohet në vendim. Si strategji do ta përkrahim, ndërkaq si vendim nuk është i formuluar mirë.

Kryesuesi i Kuvendit: Ky Draft është diskutuar edhe në KPF. Vendimi i kryetarit nuk vjen në kuvend. Si do që të jetë, ky është një vendim i kryetarit për formimin e grupin punues, gabimi teknik është evident. Grupi punues e ka sjellë draftin, për të cilin mund të diskutojmë këtu. Fjalën e ka Fadil Guri.

z. Fadil Guri- Koordinator i Zyrës për kthim dhe komunitete: Të vendimi për formimin e grupit punues, është e vërtetë se është bërë gabim të evidentimi i pikave. Plani tre vjeçar i mëhershëm ka qenë pa integrimin e të huajve, ndërkaq në këtë plan është edhe integrimi i të huajve si risi, ngase qeveria e Kosovës ka nxjerrë një rregullore 09/2019 për integrimin e të huajve. Departamenti për integrimin e të huajve dhe ri integrimin e personave të riatdhesuar, me vendimin e qeverisë ka autorizuar komunat për trajnime të vazhdueshme që të bëhet një plan veprimi për periudhë 3 vjeçare. Kostoja financiare është nga MPB –departamenti për ri integrim. Koston financiare e bartin ata, pasi është dallimi në mes integritetit të huajve dhe ri integritetit të personave të riatdhesuar, ngase ata do të vijnë në MPB dhe gjitha procedurat e integritetit dhe ri integritetit në Kosovë, do të barten nga MPB, ne do të jemi vetëm me përdorë sistemin e menaxhimit, me i futur të dhënat në sistem, me ua dhënë të dhënat dhe vërtetimet, ndërkaq ne nuk kemi përgjegjësi tjetër për integrimin e të huajve.

z. Agim Mani: Sa ka mandat grupi punues, a e ka kryer punën e tij ky grup dhe a do të menaxhoj zbatimin e planit të veprimit ?

Kryesuesi i Kuvendit: Diskutime tjera nuk ka, e shtroj në votim për aprovim këtë pikë dhe e njëjta u aprovua njëzëri. Prezentë 26. Në sajë të kësaj del konstatimi se Kuvendi i Komunës mori këtë:

VENDIM

Planit komunal për ri integrimin e qëndrueshëm të personave të riatdhesuar dhe integrimin e të huajve në komunën e Kaçanikut, 2023-2025/ Lënda: 01Nr. 104/02-11152/23.

3. Propozim Vendimi për Shfuqizimin e Vendimit 01Nr. 104/02-7676/22 për dhënien në menaxhim të përkohshëm parkingjet në pronësi të komunës, ndërmarrjes publike KRM “Pastërtia, Sh. A- Njësia në Kaçanik;

Kryesuesi i Kuvendit: Kjo pikë u konsumua me herët, megjithatë nëse ka kush diçka, e hapi diskutimin:

z. Agim Mani: Meqë u konsumua me herët kjo pikë, kjo kërkesë që ka ardhur nga KRM “Pastërtia” raporti financiar është dashur të na vjen sot nga DSHPE, se po të vinte me herët raporti financiar, kompanisë “Pastërtia” iu kishte marrë me herët menaxhimi i parkingut. Në vendimin paraprak të pika 7 thuhet: “Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset DSHPE”. D.m.th. në këtë rast drejtoria nuk është përkujdesur, se po të ishte kujdesur do të merrte me kohë raportin dhe vet drejtoria kishte kërkuar me ia marrë menaxhimin e parkingut kompanisë, sepse nuk po i sjellë të mira për komunën.

z. Naim Beça: Nga koha kur kam ardhur këtu anëtarë i KK, problemet me të mëdha i shoh prej kompanisë “Pastërtia” se na ka krijuar me së tepërmi probleme çdo herë, kështu që duhet me

ia ndërruar emrin nga “Pastërtia” në “Bërlloku”. E dyta: A ka pasur plan KRM ‘Pastërtia’ për menaxhimin e punës kur e ka marrë përsipër menaxhimin e parkingjeve? Nuk është në rregull kompania me provuar se a po mundet me menaxhuar, pa pasur kurrfarë plani. Kompania është dashur se pari me i siguruar punëtorët, para se me marrë në menaxhim parkingun. Për mua kjo është një tradhti ndaj qytetarëve. Kjo është një çështje djallëzore për me i shtrenjtuar çmimet e parkingjeve, se pas një muaj mundet me pasur kërkesë përsëri me i menaxhuar parkingjet, por me ngritje të çmimit. A ka mundësi me na treguar: A ka pasur plan KRM “Pastërtia” për menaxhimin e parkingjeve dhe krejt këtyre procedurave që është dashur me i pasur ?

z. Agim Çaka: Ku diskutua kjo çështje në një seancë të KK, u kërkuar me marrë në menaxhim parkingjet kompania “Pastërtia”, ndërkaq sot po kërkohet nga KK me e liruar prej obligimeve kompaninë. Krejt këto që i diskutuan parafolësit, është puna se: A mendon dikush se kur ia jep punën dikujt, duhet me punuar, me pasur kontratë, afat të kontratës, me pasur një rend dhe rregull, me sjellë raport, me sjellë një arsyetim, sepse njëherë u kërkuar me ia dhënë në menaxhim parkingjet, ndërsa pas një kohe të shkurtër kërkohet me liruar nga obligimet. Jo vetëm në këtë rast, por edhe në rastet tjera, çështja është se janë dyshimet se komuna, drejtoria nuk po i parashohin çështjet me kohë. Mundet të jetë edhe ajo që e tha Naimi, që dikush tjetër t’i merr në menaxhim me tender parkingjet me kontratë. Nuk mundesh me detyruar kompaninë me menaxhuar parkingjet, kundër vullnetit, por janë do obligime ligjore, kontrata, afatet ligjore etj. që para se me dorëzuar kontratën, me sjellë raport kompania, kështu që unë pajtohem me atë që u potencua. Komuna është dashur para se me dorëzuar kontratën kompania, me ia treguar rregullat, me sjellë raportin, se ne duhet me ditur pse po kërkon me liruar nga obligimet dhe si të veprojmë tutje.

z. Ramadush Osmani: Me shumë të drejtë po i parashtroni shqetësimet e juaja, pas një vendimi i cili është marrë në KK dhe pritet me u shfuqizuar. Vendimi është marrë me qëllim që kompania është aksionare me komunën, me ia krijuar edhe një të hyrë shtesë si veprimtari sekondare. Veprimtaria primare e saj është grumbullimi dhe deponimi i mbeturinave, të cilën e themi shumë qartë se operon shumë mirë, sado që anëtar i KK tha se ka probleme në menaxhim të mbeturinave, nuk ka problem në menaxhimin e tyre. Problemet janë në menaxhimin e parkingjeve. Mbi bazën e këtij vendimi janë caktuar çështjet me kontratë. Kryetari në bazë të nenit të vendimit ka lidhë marrëveshje kontraktuese. Marrëveshja është çështje e pajtimit. Arsyeja pse nuk ka raport financiar që u cek, unë si drejtori kam raport financiar, kam raporte të punës shumë të përgjithësuese, të cilat do t’ua sjellë shumë të specifikuara. Raportet nga kompania me vijnë çdo muaj, sa ka inkasuar, sa janë për paga sa kushton mirëmbajtja. Për me shfuqizuar një marrëveshje e cila nuk ka marrëveshje financiare, nuk e kam pa të arsyeshme me ia bashkëngjitur, për arsye se ne kemi thënë në KK si ndërmarrje publike “in house”, kontratat lejohen me i menaxhuar parkingjet, ceken në vendim, me ato mjete mundet me menaxhuar si kompani, ndërkaq kompensim të kësaj vlere, komunës ia ka kryer atë shërbim dhe atë shumë mirë. Komuna nuk po dëmtohet që po thoni, komuna ka përfituar, janë mirëmbajtur hapësirat publike shumë mirë, mbi vlerën të cilën ka qenë e kontraktuar. Menaxhimi ka qenë mbi 1600euro që iu ka dhënë “Pastërtisë”, në kompensim të parkingjeve që i kam vjel nga kompania e mëhershme. Por duke e pa se ajo kompani ka mundur me menaxhuar, ka siguruar të hyra dhe me i paguar komunës, ne për mos me hapur tender çdo vit për me i dhënë në shfrytëzim hapësirat publike, kemi shfrytëzuar ligjin që kompanisë t’ia mundësojmë t’i gjeneroj këto të hyra dhe ti mirëmbajë në vlerë të marrëveshjes dhe në rregullim, mua si drejtori dhe si komunë, është pjesë tjetër si kompani a je duke dalë në fitim apo jo. Marrëveshja të cakton 1 vit se a je mirë apo jo dhe 1 muaj përpara lajmëron. Në vitin e kaluar tre muaj nuk janë menaxhuar fare parkingjet, janë parkuar pa para, por hapësirat publike mi ka mirëmbajtur, se si drejtori i kam thënë se nuk me intereson, të kam dhënë asetin, gjenero të hyra, dhe neve na zbaton marrëveshjen. Tre muaj mi ka mirëmbajtur hapësirat publike në vlerë të kontratës, por nuk ka gjeneruar të hyra. Arsyeja kryesore që e ka potencuar, është mungesa e punëtorëve, nuk po ka mundësi me gjetur punëtorë me letra. Punëtorët të cilët po thoni se sillen këtu, marrin social, nuk donë me punuar me letra se iu ndalet sociali. Kompania

është publike, nuk merr punëtorë në të zezë, për atë punë merren inspektorët, ndërkaq deri sot mua me ka zbatuar marrëveshjen në përpikëri dhe jam shumë i kënaqur me mirëmbajtje të hapësirave publike që i ka pasur në detyrim si kompani, por tani ka ardhur me kërkesë me kohë në zbatim të nenit të marrëveshjes për ndërprerje të njëanshme të kontratës 30 ditë para kohe. Raportet do të ia kërkoj kompanisë jo të përgjithësuara, të specifikuara sesa ka inkasuar nga parkingjet, sa i ka kushtuar mirëmbajtja, paga neto dhe bruto. Duke e pa se vitin e kaluar ka pasur mungesë të menaxhimit, mungesë të punëtorëve, pas tre muajve kam biseduar me menaxherin e “Pastërtisë” në Ferizaj, paga 300€ që iu ka ofruar në fillim, nuk reflektoj me interesim të punëtorëve. Tre punëtorë i ka pasur, edhe pse është dashur 8, me 2 ndërrime, nuk ka mundur me gjeneruar të hyra në dy ndërrime. I kemi sugjeruar për pagë 400€ të punëtorëve, ka ra në dakord, por me humbjet e veta, ka startuar në muajin mars të këtij viti me pagën 400€ me 8 punëtorë dhe ka gjeneruar të hyra me tepër se herëve tjera. Kjo kompani krahas punëtorëve i ka angazhuar edhe dy kontrollorë të këtyre punëtorëve, dhe ka dalë që nuk janë lajmëruar buletat apo shitur 2 herë që është në damë të kompanisë. Punëtorët kanë bërë shkelje, por si me i larguar kur nuk mundesh me i zëvendësuar. Unë si drejtori duhet me zbatuar marrëveshjen dhe kam kërkuar mirëmbajtjen e hapësirave publike. Kompania ka lajmëruar se nuk po mundet me ia dal, njoftimin e ka bërë me kohë, unë si drejtori ia kam bërë njoftimin se kryetari nuk mundet me ndërpresë marrëveshjen njëanshëm, pa e shfuqizuar vendimin e KK. Shfuqizimi i vendimit më mundëson me u kthyer në pikën e mëparshme, me shpallë ankand publik, me ardhur ofertat e kompanive, që me ato gjenerim të hyrave përsëri të kontraktojmë mirëmbajtjen. Si komunë, si drejtori na ka konvenuar me vazhduar mirëmbajtur hapësirat publike, por nuk po i konvenon “Pastërtisë”, kjo i ka cekur arsyet në kërkesë, si mungesë e vazhdueshme e punëtorëve, çmim i ulët i parkingut, mos pagesa e parkingjeve të banesa P+8 dhe të stacioni i autobusëve, klientë të papërgjegjshëm që nuk i kanë paguar tiketat.

z. Naim Beça: Probleme në menaxhim të mbeturinave ka, sepse vetëm të lagja e spitalit janë mbi 20 qenë të ngordhur. Ato janë mbeturina dhe është çështje e juaj menaxhimi. Këto sqarime të cilat na i potencuat tani, është dashur me i sqaruar, se në kërkesë nuk janë dhënë sqarime për çështjen e financave.

z. Ramadush Osmani: Unë ua sjellë si material shtesë sqarimet se bashku me raportin financiar të detajuar. Kompania është detyruar me iu dhënë punë shtesë punëtorëve. Si komunë kemi ra në dakord, kemi kërkuar me i marrë kompania si aset, me gjeneruar të hyra, me ato të hyra me i mirëmbajtur hapësirat publike. Nëse nuk mundeni, atëherë e kontraktojmë për një vit operatorin, me ato mjete i mirëmbajmë hapësirat publike.

znj. Ardita Rrahmani: Për atë kjo pikë është dashur me hequr nga rendi i ditës, pasi që nuk kemi raport financiar. E ndiej për obligim me shprehur respekt për punën e jashtëzakonshme që bëjnë ata punëtorë dhe në kushtet të mjerueshme të cilat punojnë. Ne mundem në internet me gjetur sesi punojnë punëtorët e kompanive në Evropë dhe me krahasuar me punëtorët e kompanive që punojnë këtu të ne, dhe prapë ne kritikojmë. Edhe pse ka vend për kritikë, ky nuk është faji i punëtorëve, por është faji i mos hartimit të politikave nga kompania për me i mbajtur ata punëtorë. Drejtori tha i kanë paguar nga 300€ punëtorët, që sot fatkeqësisht asnjë student nuk të vjen për 300€. Me mirë është me i paguar 5 punëtorë nga 500€ sesa 8 punëtorë nga 300€ -400€, e mos të hedhim gurin tek punëtorët.

z. Adnan Reka: Drejtor, faleminderit për tentativën për sqarime, por kryesoren nuk e potencove. Nuk e potencove se kompania a operon me fitime apo me humbje që sa kohë. Të gjithë e dimë se kjo kompani operon me humbje, për fajin e juaj, pasi që asetet me të mira për të cilat kjo kompani është përgjegjëse dhe e thirrur për këtë punë, ia keni dhënë kompanisë private, ndërkaq asetet me të këqija të kësaj kompanie siç janë: Gjurgjedelli, Strazha vende këto të cilat nuk kanë shumë banorë, që duhet me shkua me i pastrua ato vende, ia keni lënë kësaj kompanie. Për atë, kompania “Pastërtia” nuk mundet me operuar me sukses. Kësaj kompanie ia keni dhënë parkingjet, kjo kompani nuk është e thirrur për parkingje. Nuk është

çka të teproje diçka që nuk mundeni me menaxhuar, me ia dhënë kësaj kompanie dhe me kërkuar me operuar me fitim, sepse nuk mundet. Ju duhet me thënë troç se, ne interesin e kemi me operatorin privat e jo operatorin publik. Publikun e kemi me e shfrytëzuar që asetet e saj me ia dhënë privatit. Kjo është e vërteta, por ju nuk po e thoni.

z. Naim Beça: Ju po thoni se jemi të kënaqur me menaxhimin e parkingjeve nga “Pastërtia” dhe mirëmbajtjen e hapësirave publike. Ju ndoshta jeni të kënaqur, por ta dini se populli jo, kjo është e sigurt. E para, të banesa P+8, ka shumë pengesa, u bë aty si cirk, për sy të qytetarëve nuk është mirë. E dyta: Rreth banesës, aty gjithmonë ka pasur gjelbërim e lule, ndërkaq tani nuk ka. Është një gropë aty, kamionë kalojnë atypari, nuk është kositur bari, tarabat janë shkatërruar. Edhe në mbledhjen e kaluar e kemi potencuar që vendi me i pa pastër janë parkingjet, kurrë nuk janë pastruar me cisterna, d.m.th. mirëmbajtjen e kanë pasur zero, ndërkaq nëse punëtorët kanë keqpërdorë buletat që u potencia, janë ligjet e Republikës së Kosovës, që duhet me u përgjigjur sipas tyre edhe në gjykatë. Arsyetimin që përmende drejtor, ne e kemi këtu zyrtarisht vetëm një kërkesë, ku kërkohet të kthehen parkingjet publike në menaxhim qysh kanë qenë para marrëveshjes, sepse është e pamundur të menaxhohet nga kompania. Kjo neve nuk na intereson, se i ka dalë zot kësaj pune, a shkon me humbje apo jo ne nuk kemi çka t’i bëjmë. Në Kërkesë është theksuar: “Nuk jemi të gatshëm të vazhdojmë me tutje për arsye të lartcekura”, e ka bërë në shumës, këtu është dashur me thënë “për arsye të lartcekur”, se vetëm një arsye është cekur. Prandaj, mua kjo me duket shumë e paarsyeshme, për atë kjo duhet me u hequr nga rendi i ditës, me na i dërguar zyrtarisht edhe arsyet tjera. Për tiketat, kur i kanë dorëzuar, nëse ka pasur keqpërdorime, ka pasur formë tjetër, e parkon me mobil, se tani jemi duke shkuar në botën kibernetike të kompjuterëve, se krejt Prishtina veprojnë kështu. Është e thjeshtë kjo punë, njësi mobil qarkullon aty, e kanë aplikacionin, ne po duam me hyrë në Evropë, ky problem në Evropë është zgjidhur para 30-40 vjetëve, duhet një investim 2000-3000€ dhe me 2 persona e mban krejt bulevardin dhe nuk kishim pas problem as ne për parking e as kompania për menaxhim.

znj. Kadrije Lika-Troni: Pyetje për drejtorin: Të parkingjet të banesa P+8, aty dihet se parkingjet kanë faturë vjetore. Në rast se keni marrë informatën prej “Pastërtisë” se disa po i paguajnë parkingjet e disa jo, cilat kanë qenë rekomandimet e juaja në këtë rast ? Se atëherë po del se kanë kaluar shumë kohë pa paguar dhe kjo është diskriminim mes qytetarëve. A keni mundur me vendosur disa ndalesa ju si drejtor së bashku me komisionin, nëse keni dalë në vendngjarje ?

z. Ramadush Osmani: Adnani e potencoj që territoret me të mira i ka marrë në menaxhim kompania private. Kompania nuk e ka problemin që nuk është duke e mbuluar terrenin me punëtorët që ka. Nëse e merr dhe ka kapacitete me marrë edhe pjesën tjetër, shton punëtorë, flasim për veprimtarinë primare që e ka. Në zonat ku shërben, nuk ka telashe as financiare as operative, është në rregull, ndërkaq është çështje tjetër nëse ne si drejtori si komunë ia japim territorin %% a mundet me mbuluar apo duhet të ketë makineri shtesë. Ne këto politika i analizojmë, për këtë arsye e kemi edhe operatorin tjetër, se neve na intereson si drejtori dhe si komunë, menaxhimi i mbeturinave komunale, se ligji i mbeturinave na i lejon mënyrën e menaxhimit edhe me kompani private. Mua me intereson me pasur mbulesë të territorit të menaxhimit të mbeturinave, ndërsa aspekti tjetër, kujt i krijohet mundësia, është çështje operimit a ka mundësi apo jo. Të banesa P+8, me bërë në marrëveshje me banorët të cilët donë me pas një pjesë të caktuar të parkingut. Kjo lidhet edhe me diskutimin e Naimit. Në momentin që paguan 6€ muajin, është përgjegjës për vendin e vet me i vendosur piramidat ndalese apo me çfarë e ruan parkingun e vet. Ai e ka vendimin prej komunës- DSHPE që ka paguar 6 muaj apo 1 vit parking. Nëse ia nxënë dikush apo ia demolon, me atë vendim shkon në polici, janë organet që merren me atë punë. Nëse nuk ka paguar të “Pastërtia”, atëherë e ka të drejtën dikush tjetër të merr atë parking, se ai e humb të drejtën e parkingut.

znj. Kadrije Lika-Troni: Qysh me ditur se cili parking është i lirë që nuk është paguar, se personi që ka banuar aty e ka shfrytëzuar atë parking dhe ka parkuar veturën ? Ju duhet me na informua se cili parking është i lirë.

z. Ramadush Osmani: Si kërkues për parking, duhet me u interesuar vet të “Pastërtia” se cili parking është i lirë. Me herët janë interesuar të DSHPE, tash e tutje të kompania, nëse shfuqizohet vendimi, interesoheni të DSHPE se cili parking është i lirë, pastaj me atë çështje merret inspektorati dhe policia, nëse është nxënë parkingun.

z. Naim Beça: A janë të paguara parkingjet të banesa P+8 apo jo?

z. Ramadush Osmani: Të marrëveshja këto janë detaje shumë të thjeshta, mua nuk me ka interesuar ai detaj, mua me ka interesuar detajet e mirëmbajtjes në pajtim me marrëveshjen. KRM “Pastërtia” SH.A -Njësia në Kaçanik ka llogari mos me marrë fare aty në menaxhim atë parking, por sa e di unë, shfrytëzuesit e parkingut kanë bërë pagesa. Çdo palë ka pasur me herët marrëveshje me komunën e kam njoftuar me shkrim që tani e tutje nëse doni me ruajtur parkingun, shkoni e bëni pagesën të “Pastërtia”.

z. Adnan Reka: Të çështja e hapësirave tona publike, janë se paku 20 deponi ilegale. Interesi i juaj shihet se është me kontraktuar ndonjë kompani, por jo me pastruar këtë vend, se po të ishte e kundërta, hapësirat publike, asetet me të mira ku është rrafsh dhe ku ka shumë banorë ia keni dhënë kompanisë private. Për mua dhe për secilin është e qartë se, interesi ka qenë me ia dhënë asetet e mira ku fitohet kompanisë private, ndërkaq asetet e këqija ku operohet me humbje, me ia dhënë kompanisë “Pastërtia”. Me vjen keq, por atëherë e kam thënë edhe tani themi se kjo është gabim.

z. Agim Çaka: Ne kur e kemi marrë vendimin në KK, është cekë se do të jetë një menaxhim i përkohshëm. Kur e kemi diskutuar atëherë kam qenë skeptik, kam pasur pikëpyetje pse ky menaxhim i përkohshëm. Fjala e përkohshëm, d.m.th. se nuk kanë qenë të sigurt as kompania e as komuna që marrëveshja ka me qenë e suksesshme dhe puna ka me shkuar mirë. Me vjen keq që kompania po duhet me ndërprerë kontratën dhe ata janë në gjendje të keqe, por ai është problem i kompanisë, ne duhet me u marrë me punët dhe veprimet tona, sepse kemi përgjegjësi për vendimet të cilat i marrim. U tha se ne nuk mundemi me detyruar me zor kompaninë me i menaxhuar parkingjet. Sipas diskutimeve këtu, por nga fjalët e drejtorit, po i bien se ata janë mashtruar nga komuna, se nuk e kanë ditur faktikisht çfarë përgjegjësie janë duke marrë. Këtu interesi ka qenë me tepër i komunës sesa i kompanisë. Ju vet i potencuat se disa parkingje janë private, ndërkaq ata mund të mos kenë të ditur kur e kanë nënshkruar marrëveshjen që disa parkingje janë private. Kjo pjesa tjetër, kanë paguar nuk kanë paguar, nuk është njëfarë arsytimi, se kompania e ka përgjegjësinë qysh e menaxhon parkingun. Unë jam i mendimit se nuk mundem me zor me detyruar kompaninë me menaxhuar parkingun. Ne duhet me shkuar me procedura të rregullta dhe kjo të jetë mësim që mos me vepruar njëjtë në të ardhmen, se edhe ne po dalim jo serioz këtu, duke marrë e shfuqizuar vendime. Anëtarë i KK provohet me vota, ndërsa drejtori që vjen ka njëfarë eksperience e bagazhi, kështu që mos të dalin me këto çështje të papërgatitur dhe pa plan, jo vetëm për këtë çështje, por edhe për çështje tjera, që ne me marrë vendime, ndërkaq me na i kthyer ministria.

Kryesuesi i Kuvendit: Po ndërlidhem këtu me këtë çështje. Esenca e këtij vendimi, është me i hap rrugë procedurës së mëtutjeshme dhe mos me i lënë hapësirat publike pa mirëmbajtje. Vendimi pas një muaji ka me u diskutuar, kështu mos të zgjasim më diskutimin pa e pa raportin dhe pa i ditur arsyet.

z. Naim Beça: Kaçaniku nuk e ka problem vetëm çështjen e parkingut, ka edhe shumë probleme tjera të cilat çështje nuk na vijnë asnjëherë në KK. Kompania e ka marrë kontratën, ndërkaq çka bënë nëse ne nuk e aprovojmë shfuqizimin e vendimit. Ky diskutim po bëhet për me tërhequr vëmendjen e anëtarëve të KK që mos me i ngritur çështjet tjera që janë shumë të

rëndësishme me u diskutuar, si çështja e qenve endacak. Për hera tjera, kërkoj që kur të propozohet një vendim me u shfuqizuar, me qenë lënda e kompletuar që ne me pasur bazë të mjaftueshme për shfuqizimin e tij.

znj. Kadrije Lika-Troni: Mua me interesoj me pyet drejtorin, nëse banorët e banesës e kanë vendimin dhe nuk e paguajnë parkingun, çka bëhet tutje, sepse edhe pse nuk e paguan, e shfrytëzon parkingun, ashtu që veturën e parkon në atë vend parking ?

Kryesuesi i Kuvendit: Shfuqizohet vendimi, ndërkaq vendimin për parking të veturës e merr dikush tjetër, janë organet kompetente që merren me atë punë.

z. Rustem Zenuni: Unë desha me cekur që raporti financiar i menaxhimit të parkingjeve mos t'na vjen në rend pune, por i njëjti t'na dërgohet me email, secili nga ne i japim vërejtjet tona, drejtori na jep sqarime. Nëse në një mbledhje të KK e kemi në rend dite raportin financiar, na marrë kohë edhe 1 orë me diskutuar për të.

znj. Ardita Rrahmani: Kjo ishte arsyeja që ne kërkuam që kjo pikë mos të jetë në rend pune në këtë mbledhje.

Kryesuesi i Kuvendit: Në momentin që vjen një raport në KK, ai duhet me u debatua, në të kundërtën cila është arsyeja me ardhur në KK. Ne këtu jemi me debatua, ndërkaq në email raportin secili e vlerëson në mënyrën e vet, ndërsa në KK çështjen e debatojmë së bashku.

z. Selajdin Troni: Edhe unë pajtohem me opozitën se raporti është dashur me na ardhur në këtë mbledhje, mirëpo për me nxjerrë me të mirën prej të keqes, se nëse ne presim edhe 1 muaj shqyrtimin e raportit, pastaj procedurën e tenderit, po shkon shumë kohë 2-3 muaj. Kështu që ne po e shfuqizojmë sot vendimin, drejtorit i hapim rrugë për procedurë të mëtutjeshme dhe raportin t'na e sjellë në ndërkohë dhe e diskutojmë këtu në KK.

Kryesuesi i Kuvendit: Diskutime të tjera nuk ka, kështu këtë pikë e shtroj në votim për aprovim dhe e njëjta u aprovua me 15 votë Për, 3 votë Kundër (Naimi Beça, Ardita Rrahmani, Besnik Salihu), Abstenuan 7 (6 nga LVV dhe Agim Çaka nga NISMA). Prezentë 25. Për momentin në sallë nuk ishte Raif Kasa nga LVV. Në sajë të kësaj del konstatimi se Kuvendi i Komunës mori këtë,

VENDIM

Për Shfuqizimin e Vendimit 01Nr. 104/02-7676/22 për dhënien në menaxhim të përkohshëm parkingjet në pronësi të komunës, ndërmarrjes publike KRM “ Pastërtia, Sh. A- Njësia në Kaçanik / Lënda: 01Nr. 104/02-11552/23.

4. Propozim Vendimi për Emërimin e komisionit përzgjedhës për Drejtor të institucioneve arsimore;

Kryesuesi i Kuvendit: Ky komision është me Udhëzim administrativ i caktuar me u formua. E hapi diskutimin:

z. Adnan Reka: Kërkesa për t'ia vazhduar edhe për 3 vite mandatin komisionit të njëjtë përzgjedhës për drejtor të institucioneve arsimore, është vërtetë shenjë e keqe për depolitizim të institucioneve arsimore të komunës.

z. Agim Mani: Ky propozim vendim që është sjellë për formim të komisionit përzgjedhës për zgjedhjen e drejtorëve në institucione arsimore, siç e tha edhe Adnani me herët, besoj se më mirë do të ishte, vazhdim i mandatit apo riemërim i komisionit, sesa të quajmë emërim të komisionit. Ky komision edhe me herët ka bërë diferencim në përzgjedhjen e drejtorëve dhe kryesisht ka qenë politik. Ne e dimë sesi janë zgjedhur drejtorët e institucioneve arsimore deri me sot. Ju vazhdoni me të njëjtin njerëz dhe me të njëjtën mendësi me i përzgjedhur drejtorët

e shkollave. Unë mendoj se komisioni duhet të jetë apolitik dhe profesional në përzgjedhjen e drejtorëve të institucioneve arsimore.

znj. Arlinda Raka- Rakoci: Të ky komision prapë po vazhdohet me avazin e vjetër, ku një anëtare e komisionit është militante e partisë.

z. Zahir Doda: Ky komision mund të emërohet vetëm për një konkurs e më së shumti për 1 vit. Lexoni Udhëzimin administrativ (UA) e shihni, tre vjet ende nuk i ka bërë UA që është në fuqi. Mandati i ka kaluar komisionit që 5 muaj, nga ajo kohë nuk ka pasur përzgjedhje të ndonjë drejtori. Në UA thuhet: Një anëtar duhet të jetë nga DA, unë i kam dy zyrtarë arsimor, Hajrush Dullovi dhe Gafurr Guri. Vetëm këta dy janë legjitim me qenë anëtarë të komisionit, Hajrush është me përvojë me të madhe. E dyta, e citoj UA: Anëtari i dytë duhet të jetë ekspert i pavarur i arsimit. Unë nuk mundem me gjetur ekspert, as në komunë as jashtë komune, ose duhet të jetë drejtor i institucionit arsimor me performancë të lartë ose nga këshilli i prindërve me përvojë dhe ekspertizë në fushën e edukimit dhe nuk kemi të kësaj fushe, besoj se as në Kosovë nuk ka. Nuk kam alternativë tjetër, se MASHT me thotë, duhet me respektuar gjininë pasi i ke 2 vetë, por nuk kam asnjë alternativë. Unë kam ardhur para një akti të kryer, se nuk është duke me interesuar absolut mua, se nuk është as përzgjedhje politike as ndonjë tendencë tjetër. Kjo është e vërteta.

z. Adnan Reka: Atëherë pikërisht bie faji që nuk keni ngritur kuadrat që 20 vjet, jo personalisht por si politikë, si qeverisje lokale, keni mbetur dhe e mbështetni krejt komunën me një person. Qysh nuk keni arritur që komuna me pasur me shumë femra drejtoresha të institucioneve arsimore, krejt komuna po varët prej një drejtoreshë.

z. Zahir Doda: Halli me i madh është se nuk ka me pasur interesim të kandidatëve për drejtor shkolle. Ky shqetësim është në krejt Kosovën e jo vetëm të ne. Me shumë se 50% e drejtorëve në nivel Kosove janë u.d. të drejtorit, në bazë të informatave zyrtarëve që i kam nga drejtorët në nivel të arsimit të Kosovës.

z. Adnan Reka: Derisa ka politizim, mundet të mos ketë edhe drejtor. Pse të tjerët kanë e ne jo, sepse i kemi futur duart në arsim, duhet duart me i larguar prej arsimit, për me lënë arsimin me frymua qysh duhet, atëherë do të kemi kuadro, do të kemi drejtor.

Kryesuesi i Kuvendit: Kjo çështje donë një analizë me të thellë, por është çështja e pagës, ngarkesës, përgjegjësisë, ka kush bënë analiza në këtë drejtim. Diskutime të tjera nuk ka, atëherë e shtroj në votim për aprovim këtë pikë dhe e njëjta u miratua me 14 votë Për, 10 Kundër, Abstenuan 2 (Agim Çaka dhe Raif Kasa). Prezentë 26. Në saje të kësaj del konstatimi se Kuvendi i Komunës mori këtë:

VENDIM

Për Emërimin e komisionit përzgjedhës për Drejtor të institucioneve arsimore;

- 1. Hajrush Dullovi, kryetar i komisionit, zyrtar i lartë i arsimit;**
- 2. Florije Berisha, anëtare, drejtoreshë në SHFMU “ Idriz Seferi” në Bob; dhe**
- 3. Një(1) përfaqësues i MASH-it, anëtar/ Lënda: 01Nr. 104/02-11739/23.**

5. Propozim Vendimi për shpallje me interes publik pjesën e PK 00382-2 ZK Bajnicë, në emër të Xhemal Fazli, për këmbim me pjesët e parcelave 00379-0; 00384-0, pronë shoqërore rrugë publike;

Kryesuesi i Kuvendit: Materialin e keni marrë, kushtet teknike që janë kërkuar, ende nuk janë krijuar, besoj se shpejt do të kryhen procedurat e prokurimit për 2 monitorë. E hapi diskutimin:

z. Naim Beça: Për këto pika që përmendni teknologjinë, pse nuk po bëni një kopje me na dërguar në email skicat për vendin e parcelës, për me ditur ne se ku janë këto prona?

z. Agim Mani: Të kjo pikë e rendit të punës për këmbim pronave, po e shoh një diskrepancë të madhe në mes të kërimit të personit privat që kërkon me këmbyer pronën 243m me 516m. Cila është arsyeja që po e merr pronën në rrugë publike, po e privatizon pronën, ku në rrugë publike ka me shumë mundësi me pasur qasje, ndërkaq po ia jep privatit rrugën publike, dhe mos me pasur të drejtë me u qasur të tjerët, përpos privatit? Kjo nuk është në interes të publikut, por është me interes personal. Rrugën që e merr 243m, në bazë të skicave, rrugën nuk e pengon se e merr vetëm një pjesë të trotuarit. A ka mundësi me ia marrë vetëm një pjesë të trotuarit e mos me ia dhënë pronën publike, se prona publike është dyfish me e madhe, me e vlefshme dhe me e shfrytëzueshme për banorët e atij rrethi?

z. Adnan Reka: Mënyra sesi po shkëmben pronat publike me ato private, duke dhënë rrugë publike, ndonëse të pa qarkulluara për një periudhë kohore, është shqetësuese dhe kriminale, sepse ju me vetëdije po dëmtoni rëndë pronën publike në favor të interesit privat. Ju sigurisht e dini se, dëmtimi me dashje i pronës publike në favor të interesit privat, është vepër penale e dënueshme me ligjet në fuqi. Këtu në këtë rast nuk ka asnjë interes publik. Midis malit shkon e dëmton pronën publike me qëllim për interes privat, besoj se jeni të vetëdijshëm për atë punë, ajo mbetet çështje e juaja, votat i keni dhe mund t'i kaloni. Kjo pronë, nuk i duhet fare rrugës, se rruga është plotësisht e barabartë, dhe çfarë kuptimi ka që një rrugë disa km, midis km. e zgjeron pak, prapë se prapë edhe në fillim dhe në mbarim është e njëjta rrugë. Vërtetë për mua kjo është shqetësuese dhe tmerruese.

Kryesuesi i Kuvendit: Kjo rrugë është rrugë e asfaltuar në Bajnicë. Parcelat që janë kërkuar me u këmbyer, ka qenë një projekt prej 3 komunave, financuar nga ministria kur është shtruar rruga prej Ferizajt deri në vendin e ashtuquajtur Bazhdarhane. Arsye me ardhur ky këmbim, është ajo pjesa e rrugës së asfaltuar, se është asfaltuar qysh kur është shtruar asfalti në pjesën e Bajnicës. Rruga ku kërkohet këmbimi, është rrugë malore, e cila sot nuk është e kalueshme.

z. Qamil Stagova: Pjesën të cilën e jep personi privat, është në rrugën “10 Gushti”, në rrugën Bajnicë deri në vendin e ashtuquajtur Bazhdarhane, ndërsa pjesën që e merr personi private është komplet në rrugën e asfaltuar e jo vetëm në një pjesë. Personi privat i jep 243m, ndërsa po i merr 515m. Nuk kam ndonjë analizë për vlerën, por vlera me e madhe është të rruga e asfaltuar, atje në rrash në fund të parcelës. Në e kemi pasur parasysh këmbimin se aty janë dy rrugë, njëra mbyllet në një pjesë, por tjetra nuk ka largësi të madhe, që e kryen atë funksion dhe këto rrugë nuk janë në përdorim për momentin.

z. Adnan Reka: Ajo që po thuhet, kolegët kanë keqkuptime, nuk e dinë saktë. Është dashur me i shikuar në gjeoportale, që me i kuptuar saktësisht se a është rrugë e asfaltuar, me kuptuar me qartë se për çka bëhet fjalë, e jo vetëm me fjalë. E vërteta është se, në vend se me hapur rrugët që janë, ani pse nuk janë të qarkullueshme, ju po i mbyllni ato, për interes privat.

Kryesuesi i Kuvendit: Diskutime të tjera nuk ka, atëherë e shtroj në votim për aprovim këtë pikë dhe e njëjta u miratua me 17 votë Për, Kundër 7 nga LVV, Abstenim 2 (Raif Kasa dhe Agim Çaka), Prezentë 26. Në sajë të kësaj del konstatimi se Kuvendi i Komunës mori këtë:

VENDIM

Për shpallje me interes publik pjesën e PK 00382-2 ZK Bajnicë, në emër të Xhemal Fazli, për këmbim me pjesët e parcelave 00379-0; 00384-0, pronë shoqërore rrugë publike/ Lënda: 01Nr. 941/01-11794/23.

6. Propozim Vendimi për shpallje me interes publik pjesën e PK 00439-1, ZK Duraj, në emër të Adem Salihaj, për këmbim me pjesën e parcelës 00452-0, pronë shoqërore rrugë publike;

Kryesuesi i Kuvendit: Materialin e keni marrë, i keni pa skicat, edhe kjo është një rrugë që është asfaltuar nga ministria e Infrastrukturës. E hapi diskutimin:

z. Adnan Reka: A nuk ishte personi i njëjtë ky, që në vitin e kaluar ia drejtuam pronën. Është i njëjti person që ai drejtuam pronën pa asnjë interes publik. Personit të njëjtë duhet me ia bërë pronën me një vend që nuk i duhet askujt, se rruga është me dimensione të barabarta, me ia dhënë në një vend tjetër afër rrugës rajonale ku lidhet me asfalt. I di saktë këto prona, dhe e di terrenin, kam shkuar e i kam parë këto dy prona. E para është të rruga “Avdyl Dura”, e dyta në rrugën “Hetem Hasaj”, por distancat e rrugës janë të njëjta edhe para pronës edhe pas pronës, nuk ka asnjë interes publik, ndërkaq nuk është në rregull me ia dhënë dikujt pronën me i bërë favore, në damë të pronës publike.

z. Rustem Zenuni: Ky këmbim ka të bëjë me drejtimin e rrugës. Nëse ne jemi të interesuar me i pasur rrugët me shumë kthesa, i lejojmë por ne jemi duke dashur me e drejtuar rrugën dhe shiriti me dalë në mes. Nuk jemi duke e dhënë pronë as prapa e as anash, por pronë përballë rrugës në 40m². Nuk është këtu kurrfarë favor. Nëse nuk iu beson fjalëve të mia, lirisht shkojmë e shikojmë tani me veturën time, se jam duke e parë që vazhdimisht jeni duke i keqkuptuar çështjet, sikurse dikush është duke përfituar qoftë politikisht apo në ndonjë formë tjetër, e që kjo totalisht është gabim.

z. Adnan Reka: Faleminderit për tentativën për me na sqaruar. Unë besoj se ju me tepër me këto fjalë po mundoheni të mashtroni KK, sepse ajo parcelë që mendohet me iu dhënë palës është e gjatë. Nuk është me rëndësi raporti i këmbimit, por strategjia ku e merr pronën dhe ku e jep. Edhe unë e kam të shtëpia ime njëfarë skaji të pronës që nuk i duhet askujt, me këmbyer atë pronë me pronë publike me dalë në rrugë.

z. Agim Çaka: Unë nuk e di saktë se ku i bien këto pjesë të këmbimit të pronave, por në bazë të diskutimeve të kolegëve, janë dy diskutime krejtësisht të ndryshme, pa e ditur se cila është e saktë. Për këtë arsye, ne kemi kërkuar me pasur monitor, me i parë saktë çështjen e këmbimit të pronave. Realisht ne ndoshta e kemi përgjegjësinë si anëtarë të KK me dalë në vendngjarje me shikuar pronat, me kërkuar dokumentacion, por çështja është, pse mos me na lehtësuar këtë këto punë me i pa me monitor. Kjo mënyrë është me e lehtë për juve, për neve anëtarët e KK edhe për drejtorin, që të dimë qartë se çka jemi duke votuar, kështu që mos të biem në pozita të këqija sesi me votuar. Unë, nëse votojmë kundër ose abstenoj, unë votoj për shkak të bindjeve që i krijoj aty për aty. Unë dua me marrë vendime të sakta dhe të qëndrueshme dhe ma dalë para qytetarëve me arsyetimin e drejtë pse kam vendosur me votuar në atë formë. Jo vetëm për këtë rast, por ka edhe raste tjera, kështu që mirë është me marrë një hap konkret për pajisje të nevojshme të KK me monitor, që t’i shohim qartë çështjet. Tjetër, ne jemi duke pasur probleme me disa nga drejtorët e drejtorive të cilët nuk po na kthejnë përgjigje në pyetjet të cilat po i ngritëm në bazë të kërkesave të qytetarëve. Drejtorët kanë kohë me u përgatitur në përgjigje një muaj ditë deri në seancën tjetër e mos me ardhur në këtë pozicion, sepse drejtorët janë përgjegjës për pyetjet që ngritën sipas fushave të caktuara.

z. Qamil Stagova: Të rruga ‘Hetem Hasaj’ nuk është gjendja si në rrugën “Avdyl Duraj”, se të kjo e fundit ka hapësirë jashtë rrugës me shumë, ndërkaq të kjo e para nuk ka hapësirë. Gjendja momentale e asfaltit me kufirin në me pronës së rrugës dhe pronës se Sadik Salihu, se veç ka mbetur në emër të vëllait të vet, se nuk është e tij, është zigzage, në një vend del prona të vija e kufirit në asfalt, në një vend del jashtë asfaltit, me këtë ndryshim bëhet drejtimi me asfaltin dhe në këtë pjesë e cila nuk është trotuar vetëm bankinë, si pronë e rrugës bëhet me gjerësi 80cm. deri në 1.20m, e merr drejtimin e njëtrajtshëm për gjatë krejt kësaj parcele.

z. Adnan Reka: Nëse është ashtu, pse krejt anëtarëve të KK nuk na i ke dërguar materialin me ngjyra për pronën që merret dhe ajo që epët, që ne me i pa saktë këto këmbime të pronave, por e ke dërguar një skicë që për shumicën e anëtarëve është e paqartë ? Neve na i ke dërguar materialin bardh e zi, ku shihet vetëm një vijë, që për ne është e paqartë. Nuk është çështja vetëm të kjo pronë, por edhe të pronat tjera të cilat na i keni dërguar për këmbim, se kanë qenë

të njëjta. Pasi qenka kështu, unë nuk e diskutoj fare, se është dashur paraprakisht me na i dërguar me ngjyra materialin për pronat të cilat këmbehen.

Kryesuesi i Kuvendit: Diskutime të tjera nuk ka, atëherë e shtroj në votim për aprovim këtë pikë dhe e njëjta u miratua me 16 votë Për, 7 votë Kundër nga LVV, Abstenuan 2 (Raif Kasa dhe Agim Çaka). Prezentë 25. Në sajë të kësaj del konstatimi se Kuvendi i Komunës mori këtë:

VENDIM

Për shpallje me interes publik pjesën e PK 00439-1, ZK Duraj, në emër të Adem Salihaj, për këmbim me pjesën e parcelës 00452-0, pronë shoqërore rrugë publike/ Lënda: 01Nr. 941/01-11793/23.

7. Propozim Vendimi për shpallje me interes publik pjesën e PK 00905-2, ZK Nikaj, në emër të Fatmir Gula, për këmbim me pjesën e parcelës 00920-1, pronë shoqërore rrugë publike;

Kryesuesi i Kuvendit: E hapi diskutimin: Për diskutim nuk u paraqit kush, atëherë e shtroj në votim dhe e njëjta u aprovua me 15 votë Për, 6 votë Kundër Abstenuan 3 (Agim Çaka, Raif Kasa dhe Naim Beça). Prezent 24, nuk ishte në sallë për momentin Bashkim Krasniqi. Në sajë të kësaj del konstatimi se Kuvendi i Komunës mori këtë:

VENDIM

Për shpallje me interes publik pjesën e PK 00905-2, ZK Nikaj, në emër të Fatmir Gula, për këmbim me pjesën e parcelës 00920-1, pronë shoqërore rrugë publike/ Lënda: 01Nr. 01Nr. 941/01-11795/23.

8. Propozim Vendimi për shpallje me interes publik pjesët e PK 00980-0; 00982-0, ZK Kaçanik në emër të Naser Dema, për këmbim me PK 00979-0, pronë komunale;

Kryesuesi i Kuvendit: E hapi diskutimin

z. Naim Beça: Unë i kam afër këto prona, por skicat i kemi bardh e zi, e nuk po mundem të gjejë as shtëpinë time me këto skica.

Kryesuesi i Kuvendit: Nga sektori i KK, po thonë se e kanë dërguar me ngjyra skicat për këto prona.

z. Adnan Reka: I kemi në foto në gjeoportali, por pa ngjyra. Unë të përcjellë me ngjyra në gjeoportali Naim, e sheh edhe shtëpinë tënde, është të Halil Selmani, me marrë rrugën aty që ka qenë e pa qarkulluar dhe me ia dhënë një pjesë pas shtëpie, që nuk është rrugë publike që nuk ka dalje. Rruga që ka pasur qasje, për një kohë nuk ka qarkulluar dhe është mbyllur, tani duhet me ia dhënë një pjesë tjetër në këmbim.

z. Selajdin Troni: Unë do të votoj për, pasi që Naimi i paska afër, edhe pse ai nuk po i voton tonat.

z. Qamil Stagova: E vërteta është se një pronë publike që ka figuruar në zyrat kadastrale, në realitet nuk ka ekzistuar, por përpara para 50 vjetëve është përdorur dhe ka mbetur ashtu, rrugë tjetër nuk ka pasur. Tani personi e lëshon në anën tjetër, dhe e marr atë, kështu dy familjeve iu mundësohet me dalë në rrugën “Nexhmush Elezi”.

z. Adnan Reka: Drejtor aty nuk ka tjetër rrugë.

z. Qamil Stagova: Është e shënuar se parcelat 970-0 dhe 966-0, fitojnë kyçje në rrugën “Nexhmush Elezi” se kyçet ekzistuese nuk i kanë pasur bash si duhet, njëra në rrugën “Ismail Qemali”, tjetra në rrugën “Avdyrrahim Shehu”, kështu që personi është duke dhënë ma tepër sesa është duke marrë pronë. Ne mundemi me bërë një rrugë publike- shteg për këmbësor që këmbësoret mundën me i ra atypari me shkurt sesa me u sjellë rrotull.

z. Adnan Reka: Nëse e kuptojmë qartë Naim, drejtor, kjo ka qenë rrugë publike dhe ka pasur mundësi të gjithë shehlerët me u lidhur në atë rrugë, vetëm me ua hapur si opsion me iu treguar

se kjo është rrugë publike, se pavarësisht se është blerë prona, rruga publike nuk ka mundur me u blerë. Tani ju po doni me i bërë favor, me ia dhënë pronën, me i këmbyer pronën dhe me ia dhënë rrugën publike dhe ai me ua dhënë një pronë kinse publike, e cila pronë nuk ka dalje në rrugë. Rruga publike ka pasur dalje, por është bërë e pa qarkullueshme.

z. Qamil Stagova: Dalje ka, në anën e poshtme, nuk i kemi TV, ato dy parcelat që i përmende edhe kjo rrugë që lëshohet, iu krijohet kyçja, ndërkaq në anën e epërme veç e ka kyçje.

z. Adnan Reka: Cilat familje janë, se ne i njohim familjet aty?

z. Qamil Stagova: Janë familjet e Adnan Shehut dhe Skender Kuka.

z. Adnan Reka: Shtëpia e Adnanit po shihet me sera e me krejt kah rruga publike që ka qenë, e ju po donë me ia dhënë në anën tjetër. Rruga është e kalueshme vetëm e pa qarkullueshme, rrugë kjo në të cilët kyçemi edhe ne, sepse ajo rrugë është publike.

z. Qamil Stagova: Unë nuk e kam shtëpinë larg nga aty, ka 50 vjet që ajo pronë publike nuk shfrytëzohet.

Kryesuesi i Kuvendit: Diskutime të tjera nuk ka, atëherë e shtroj në votim për aprovim këtë pikë dhe e njëjta u miratua me 17 votë Për, Kundër 6 votë nga LVV, Abstenuan 2 (Raif Kasa dhe Agim Çaka) Prezentë 25. Në sajë të kësaj del konstatimi se Kuvendi i Komunës mori këtë:

VENDIM

për shpallje me interes publik pjesët e PK 00980-0; 00982-0, ZK Kaçanik në emër të Naser Dema, për këmbim me PK 00979-0, pronë komunale/ Lënda: 01Nr. 941/01-11792/23.

9. Propozim Vendim për caktimin e lokacionit për nevoja të HANDIKOS;

Kryesuesi i Kuvendit: E hapi diskutimin:

z. Agim Mani: Është dashur të kalojnë mbi 14 muaj që të shqyrtohet kërkesa e deputetit Milazim Salijaj, për gjetjen e lokacionit për ndërtimin e objektit për zhvillimin e aktiviteteve të ndryshme për nevoja të OJQ-HANDIKOS. Po të ishte shqyrtuar me kohë kjo kërkesë dhe të ishte caktuar lokacioni, kjo çështje kishte hyrë në plan buxhetor të vitit 2023 dhe kishin filluar punët e objektit. Kjo është neglizhencë e komunës e cila nuk i ka përshpejtuar procedurat dhe pas 14 muajve të kërkesës së deputetit, sot është caktuar lokacioni i propozuar, të cilit nuk iu ka ndryshuar vendi e as pozita.

Kryesuesi i Kuvendit: Diskutime të tjera nuk ka, atëherë e shtroj në votim për aprovim këtë pikë dhe e njëjta u miratua njëzëri. Prezentë 25. Në sajë të kësaj del konstatimi se Kuvendi i Komunës mori këtë:

VENDIM

Për caktimin e Lokacionit për ndërtimin e objektit për zhvillimin e aktiviteteve të ndryshme për nevojat e organizatës HANDIKOS (Shoqata e Paraplegjikëve dhe Paralizës së Fëmijëve të Kosovës) / Lënda: 01Nr. 104/02-11896/23.

10. Raporti i punës i Komitetit për Komunitete për vitin 2022;

Kryesuesi i Kuvendit: Ky komitet është trupë punuese e KK dhe i njëjti sjellë raportin e tij të punës për miratim në KK. E hapi diskutimin:

z. Agim Mani: Unë e kam një pyetje lidhur me këtë raport; Pse Komiteti për Komunitete nuk e ka sjellë me herët këtë raport, në muajin shkurt, eventualisht në muajin mars, por e ka lënë deri me tani?

Kryesuesi i Kuvendit: Besoj se me mirë është të debatuar për aktivitetin e zhvilluar të këtij komiteti sesa çështjen e vonesës së raportit për një muaj ditë.

z. Ekrem Livoreka: Është e vërtetë se raporti është vonuar pak, por tani raportin ua kemi sjellë këtu. Unë kam vërejtje të disa drejtorë të drejtorive të cilët nuk po i përgjigjen ftesës tonë për me marrë pjesë në mbledhje të Komitetit për Komunitete. Nëse nuk kanë mundësi me marrë pjesë, se paku me autorizuar dikën nga drejtoria që me na njoftuar për punën e atij dikasteri për çështjen që është në rend pune.

Kryesuesi i Kuvendit: Diskutime të tjera nuk ka, atëherë e shtroj në votim për aprovim këtë pikë dhe e njëjta u miratua njëzëri. Prezentë 25. Në sajë të kësaj del konstatimi se Kuvendi i Komunës mori këtë: Në sajë të kësaj del konstatimi se Kuvendi i Komunës mori këtë:

VENDIM

Për Aprovimin e Raportit të punës së Komitetit për Komunitete për vitin 2022/ Lënda: 01 Nr. 60/01-11954/23.

11. Propozim për organizimin e një punëtorie me anëtarët e KK, për çështjen e PZHK:

Kryesuesi i Kuvendit: Të kjo pikë, do të organizohet një punëtori nga DUKMM në bashkëpunim me grupin punues që kanë qenë përgjegjës për hartimin e PZHK- dokument ky i cili është vonuar bukur shumë dhe është kërkuar shpesh herë edhe në KK. Tani e kemi një draft plan për me debatuar, dhe unë dua që në bashkëpunim me personat përgjegjës të organizojmë një punëtori që të japim kontributin tonë, t'i japim mendimet tona, e që ndonjë mendim i arsyeshme mund të përfshihet në draft plan. Unë kërkoja nga drejtori që të debatojmë dhe të shohim mundësinë e organizimit të një punëtorie dy ditore, sepse koha e shkurtër nuk jep seriozitet në PZHK atë mënyrën sesi e organizuam ne këtu, ndërkaq në një punëtori dy ditore kontributi i secilit nga ne do të jetë me i madh dhe me i rëndësishëm. Unë e lash me qëllim këtë çështje të debatojmë në KK, sepse mund të ketë ndonjë mendim sesi të trajtojmë këtë në mënyrën me të mirë të mundshme draftin fillestar, pastaj janë procedurat tjera të trajtimit, ajo e debatit publik me qytetarë dhe në KK në procedurën e miratimit. Këtë çështje duhet trajtuar me kujdes, sepse kemi të bëjmë me një PZHK 10 vjeçar dhe me një perspektivë me të gjatë diku edhe për 5 vjet. Kjo çështje e kam cekur edhe në KPF, dhe u pajtuam me disa mospajtime për formën sesi do të organizohet. E hapi diskutimin:

z. Rustem Zenuni: Ne jemi për miratimin e këtij propozimi, në parim jam që kjo punëtori të mbahet brenda territorit të Kosovës, ku janë mundësitë me u mbajtur.

Kryesuesi i Kuvendit: Neve na intereson çështja se ku do të kemi kushte për organizimin e një punëtorie të tillë, sigurisht duhet të jetë salla e konferencave dhe të ofrojnë kushte për zhvillimin e kësaj punëtorie.

z. Agim Mani: Është e rëndësishme është lokacioni, por me e rëndësishme është që drafti i PZHK t 'na dërgohet me kohë, që të kemi mundësi me u konsultuar me ekspertë të ndryshëm, në mënyrë që t'i japim mendimet dhe vërejtjet tona.

znj. Ardita Rrahmani: Po flas fillimisht në cilësi të shefit të GP të LDK, propozojmë që të mbahet në vikend, për arsye të obligimeve rreth planifikimit të orarit, dhe tjetra, po flas në cilësinë e Grupit të grave asambleiste. Unë kam biseduar me koleget anëtare të KK, kërkojmë që punëtorja të mbahet diku në Kosovë, për shkak se shumica jemi nëna të reja dhe kemi obligime ndaj fëmijëve, në të kundërtën mund të mos marrin pjesë në atë punëtori.

z. Agim Çaka: Edhe unë pajtohem që të organizohet kjo punëtori, pajtohem që ne duhet me pasur draftin e PZHK paraprakisht, në mënyrë që me ardhur të përgatitur. Qëllimi është se aty në punëtori mund të kenë ndonjë propozim apo ide të reja, dhe për me i trajtuar këto, ne

duhet me pasur paraprakisht dokumentin. Sa i përket kohës, duhet me gjetur një kohë dhe vend të përshtatshëm, sepse diskutimi i secilit nga ne, kishte me qenë kontribut i mjaftueshëm dhe i domosdoshëm në këtë punëtori, kështu që unë jam për me u mbajtur punëtorja.

z. Ekrem Livoreka: Edhe ne AAK jemi për mbajtjen e punëtorisë për trajtimin e PZHK.

Nënkryetari i Komunës-Sabedin Vishi: Ne jemi pajtuar që të mbahet një punëtori, ka qenë kërkesa që punëtorja të mbahet brenda territorit të Kosovës. Grupi parlamentar i LVV e kanë kërkuar me pasur paraprakisht edhe draftin e PZHK. Unë kam kontaktuar me kryesuesin e grupit punues për hartimin e PZHK, Samiun, ai me ka thënë se në këtë fazë nuk mundeni me pasur draftin, sepse drafti nuk është final dhe drafti mundet me u bërë publik. Për këtë arsye do të jenë në gjendje me trajtuar 1-2 ditë, me elaborua hollësisht çdo kërkesë të juaj që e parashihni ju, që e rëndësishme për komunë, në mënyrë që secili prej juve me dhënë kontributin në formën me të mirë të mundshme. Sigurisht se nuk ka me u miratuar çdo kërkesë e jona dhe e juaja, mirëpo neve mos të na mbetet merak për neglizhencë asnjë që mos t'na ikë diçka që me qenë në një PZHK që është për 8 vite. Kushdo që është në pushtet, ka me punuar në këtë dokument, kështu që është mirë ndoshta me konfirmuar pjesëmarrjen edhe në formë individuale. Interpretimin do të bëjë hollësisht Samiu, për çdo çështje që ka të bëjë me PZHK nga zona e parë e tutje, qoftë për pikat turistike, etazhi-tetin, për gjithçka që parashihet në PZHK.

z. Adnan Reka: Unë mendoj se PZHK duhet me iu nënshtuar grupeve të ekspertëve para se me iu ardhur neve anëtarëve të KK. Ne si anëtarë të KK, unë me së pari e konsideroj vetën inferior në raport me këtë plan. Ky plan është jashtëzakonisht i rëndësishëm, shumë dimenzional, shumë dikasterial që nëse nuk keni ekspertë të një çështje, nëse nuk keni përvojë të mjaftueshme, është vështirë vetëm me fol. Pas diskutimit të ekspertëve të cilët mundën me dhënë kontributin real, atëherë krijohet një draft plan i cili na dërgohet neve, ne e shqyrtojmë se në fund ne kemi me marrë vendimin final sipas ligjit për miratimin e PZHK, por pasi të merr formën finale, por jo në këtë formë.

Kryesuesi i Kuvendit: Grupi punues që e ka hartuar planin, është grup ekspertësh të cilët janë të thirrur me punuar në atë plan. PZHK sigurisht se ka me dalë edhe në diskutim publik, ku ka me pasur mundësi të involvohen edhe ekspertë të jashtëm me dhënë kontributin e tyre. Çështja e organizimit të punëtorisë për PZHK, është një pikë fillestare, ku ne të jemi në hap me informacionet rreth asaj se çka do të përmbajë PZHK. Ne mund edhe të mos mbajmë punëtori, se për ne kjo është edhe një ngarkesë shtesë, por çështja është se trajtimi i jonë kishte me qenë debati publik dhe mbledhja e KK. Mbledhja e KK nuk është e mjaftueshme se është faza e miratimit të PZHK. Nuk mendoj që secili anëtarë ka me pasur mundësi me dhënë kontributin e mjaftueshëm në mbledhje të KK. Unë po dua që secili të kenë mundësinë që të jep sadopak kontribut në PZHK edhe në këtë fazë, që kur të vijmë në mbledhje të KK të jemi edhe me të informuar dhe kompletuar për PZHK.

z. Adnan Reka: Nëse e shohim prej perspektivës së Kuvendit të Kosovës, çdo ligj i sa do i rëndësishëm, nuk i nënshtrohet të gjithë anëtarëve të kuvendit për me diskutuar, por iu nënshtrohet komisioneve profesionale, deri sa të arrijë drafti në kuvend. Pastaj, kur të arrijë në kuvend, anëtarët e kuvendit e kanë të drejtën e diskutimit në konsultim me ekspertët e vet të cilët ata i konsiderojnë, atëherë secili nga pozicioni i vet jep mendim për miratim apo kundërshtimin e draftit, qysh ata e mendojnë. Ndërkaq, në fazën fillestare që është dokumenti, me u thirrur ne me fol për një plan shumë të rëndësishëm, nuk mendojë se mundemi me dhënë kontributin tonë.

Kryesuesi i Kuvendit: Nuk jemi ne që kemi me jep në atë punëtori me dhënë vulën për PZHK. Ne kemi me u informuar rreth përmbajtjes së PZHK, kemi me debatuar, për atë po

dua që punëtorja të jetë me e gjallë dhe me interaktive, ku kemi me qenë me të informuar dhe me pasur mundësi me konsultuar edhe njerëz për pjesë të caktuara ku jemi të interesuar. PZHK ka me iu nënshtruar debatit publik, ku kanë me marrë pjesë edhe qytetarët, por në fund draftin final kemi me miratuar si KK. Qëllimi është që ne të jemi sa me të kyçur në PZHK, sepse herën e parë PZHK na ka ardhur në KK dhe e kemi miratuar dhe është punuar me atë PZHK, por kemi pasur shumë ndërhyrje në vazhdimësi. Ideja ka qenë kjo, për mua nuk asnjë problem mos me u mbajtur fare, ideja ka qenë që ju me qenë sa me të kyçur dhe sa me të informuar në këtë proces, se drafti në fund vjen për miratim në KK. Nëse keni ndonjë ide tjetër, lirisht mund të jepni, se nuk jam bash insistuar për punëtori, por ideja ime e tregova pse është. Lirisht mundem me organizuar cilado formë që ju e propozoni, apo mundem të mos e trajtojmë fare, ju vendosi a po e trajtojmë apo jo, nëse po, në cilën formë po e trajtojmë.

z. Adnan Reka: Drafti i PZHK duhet me qenë transparent. Me qenë publik, që kushdo mundet me iu qasur draftit e jo vetëm ne si anëtarë të KK, para se me ardhur në KK.

z. Seladin Troni: Nëse ka mundësi, PZHK të trajtohet në një seancë të veçantë, dhe aty ne ku mundemi me dhënë kontributin tonë e japim, megjithatë edhe unë jam skeptik në këtë drejtim, sepse nuk jam i fushës së caktuar.

Kryesuesi i Kuvendit: Nuk e di a po e kuptoni, jeni duke e keqkuptuar këtë çështje, se ne nuk kemi me vendosur në punëtori për miratimin e PZHK.

z. Agim Çaka: Ne, në punëtori kemi me diskutuar PZHK, nuk marrim vendim për miratimin e planit. Kjo është një diçka që e kemi kërkuar secili nga ne, sepse mungesa e PZHK na ka paraqitur probleme në marrje të vendimeve në KK. Organizimi i këtyre punëtorive, mendoj se është jo i domosdoshëm, por është një diçka e mirë, që na nevojitet neve në të ardhmen, se mundemi me qenë më të informuar paraprakisht. E dyta, është mundësia me e dhënë kontributin tonë si anëtarë të KK, me dalë me propozime të cilat mund të hyn në PZHK. Ne e dimë që PZHK e kanë hartuar ekspertët, ndërkaq në kohë të sotme ne po shohim se ka edhe ekspertë të cilët munden me devijuar, për këtë arsye jemi ne, sepse në fund të fundit vullën dhe përgjegjësinë e kemi ne kur të merret vendimi në KK. Kështu që, nuk ka asgjë të keqe nëse ne jemi të informuar paraprakisht për një çështje të cilën kemi me votuar në KK. Çështja është, sa do të jemi të organizuar, mundësia me marrë pjesë sa me tepër, se nuk kemi me vendosur aty, por vetëm me u informuar dhe me dhënë kontributin tonë para se drafti me na ardhur në KK.

znj. Ardita Rrahmani: Pajtohem edhe me Agimin, me sa po e kuptoj, po kërkon me mbajtur një takim që me shfaqur draft PZHK, që me lënë hapësirë debateve publike, që me pasur një kohë që atë draft plan me trajtuar edhe me ekspertë të fushave të caktuara.

Kryesuesi i Kuvendit: Unë e potencova edhe me herët që, e para pikë është që ne me marrë informacion me të zgjeruar për një dokument që është duke u përgatitur. Në atë punëtori kemi me pasur mundësi me diskutuar dhe me i dhënë vërejtjet e propozimet tona, pastaj ata të grupit punues e trajtojnë, se ne mundemi me dhënë edhe mendime të gabuara, apo nëse e kemi ndonjë mendim të mirë, e marrin parasysh dhe e fusin në plan. PZHK ka me u diskutuar në diskutim publik dhe në KK, por pasi është një dokument i rëndësishëm e kemi pa të arsyeshme të diskutojmë paraprakisht, ta shohim se çka jemi duke bërë. Punëtorja është si ide, mundem me mbajtur, apo mos me mbajtur, duke menduar se kjo i shërben KK edhe si relaksim dhe me dhënë kontribut për çështjen e caktuar. Punëtorja do të jetë dy ditore me një bujtje, numri i GP është bukur i madh, besoj se disa me kryesorët do të marrin pjesë, si kryesuesi i GP Sami Stagnova që është përgjegjës i projektit dhe ndonjë nga bashkëpunëtorët e tij.

Nënkryetari i Komunës: Jam me tepër në ngjarje lidhur me PZHK, Drafti është përgatitur dhe ka shkuar në ministri. Ata të ministrisë e shqyrtojnë dhe e kthejnë me disa komente për me i ndryshuar këtu, pastaj drafti i nënshtrohet procedurave të debatit publik me qytetarë një muaj dite. Pas korrigjimeve të vërejtjet dhe sugjerimet, do të vjen për miratim në KK. Në saje të kësaj, kërkesave të kryesuesit dhe të pjesës dërmuese të juaj, çështja është që ju paraprakisht me pasur një skanim të gjendjes së draftit të PZHK aktualisht si është, që ju në bazë të kërkesave të qytetarëve që i keni, ku ka pasur ndërtim, ku ka me pasur zonë industriale, ekonomike, turistike, me pasur informacion dhe me mundur me kontribuar para se drafti me ardhur në KK për miratim. Në kuvend për ngritur dorën, më mirë është me pasur gjendjen e skanuar.

z. Naim Beça: Për sa kohë pas takimit, kemi me pasur PZHK në kuvend, se edhe ne duhet me biseduar me njerëz që i njohim që janë ekspertë se varët ju qysh e cilësoni një ekspertë, se dikush mundet me dhënë një propozim edhe pse nuk është ekspert. A kemi kohë ne biseduar me popull, se dikush mundet me dhënë ndonjë propozim?

z. Sabedin Vishi: Nëse ne vendosim, e marrim gjendjen e skanuar prej atyre ekspertëve se çka ka PZHK, dhe ju me ata ekspertët e juaj personal e elaboroni PZHK, para se me dal në diskutim publik me qytetarë. Problemi është që ne dhe ju me debatuar në një rreth të ngushtë, për me dhënë kontribut, ndërkaq procedurat nga DUKMM deri në KK, ndoshta i merr 2 javë, por sa me tepër të shtyjme është me keq për qytetarët e komunës.

z. Adnan Reka: Plani është vonuar, e kemi në konsideratë çështjen e kryetarit të grupit punues, por çështja është se nga viti 2018 është marrë vendimi, tani jemi në vitin 2023, nuk është e shkurtë kjo periudhë, kjo është neglizhencë totale.

Kryesuesi i Kuvendit: Mos të flasim për njerëz dhe për individ, PZHK është hartuar drafti dhe është mirë me dhënë kontribut.

z. Agim Mani: E potencova edhe me herët, qysh mundemi me marrë pjesë ne në punëtori, pa e pasur draft planin e PZHK. Të na dërgohet draft plani, e shqyrtojmë, i konsultojmë edhe ekspertë të ndryshëm, dhe e japim kontributin tonë.

Kryesuesi i Kuvendit: Me tregoni ju mua Agim, në cilën punëtori mundet me ju ardhur materiali paraprakisht. Jemi duke mbajtur punëtori, materiali shtjellohet aty në punëtori, nuk jemi duke marrë vendim aty, keni me pasur kohë kur keni me konsultuar dike për PZHK, kështu mos të keqkuptohet. Diskutime të tjera nuk ka, atëherë e shtroj në votim për aprovim këtë pikë dhe e njëjta u miratua me 20 votë Për, Kundër ishin 2, Abstenuan 3. Prezentë 25. Në saje të kësaj del konstatimi se Kuvendi i Komunës mori këtë:

VENDIM

Për organizimin e një punëtorie dyditore me anëtarët e kuvendit të komunës Kaçanik për Planin Zhvillimor Komunal/ Lënda: 01Nr. 104/02-13186/23.


Mbledhja i përfundoj punimet në ora 13:15. Deri në fund të mbledhjes ishin 25 anëtarë, një anëtar mungoj gjatë tërë mbledhjes, ndërkaq Lejla Muhaxheri-Çaka me leje të Kryesuesit të KK, shkoj gjatë shqyrtimit të pikës 6.

Procesmbajtëse
Makfire Malsiu

Kryesues i Kuvendit
Kemal Murseli



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Kaçanikut
Opština Kaçanik
Municipality of Kaçanik

LISTË DISTRIBUIMI/ CIRKULARNO PISMO/ ROUTING SLIP

REFERENCE:	09-106/02-14211/23				
PËR/ZA/TO:	Zyrën e Kuvendit komunal z. Kemal Murseli –Kryesues i Kuvendit				
CC:	z. Besim Ilazi –Kryetar i Komunës				
PËRMES/PREKO/THROUGH:					
NGA/OD/FROM:	Hafize Sallahi – Drejtoreshë e DKRS				
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Draft Rregullore për Mënyrën dhe Kushtet e Shfrytëzimit të Shtëpisë së Kulturës “Xheladin Kurtaj” në Komunën e Kaçanikut				
Nr. i zyrës:	1	Lokacioni:	Palestra e Qytetit	Data:	14.06.2023
Br. kancelarije:		Kucni:		Datum:	
Room No.:		Extension:		Date:	

I nderuar ,

Bashkë me këtë shkresë ju dërgoj kopjen e **Draft Rregullorës për Mënyrën dhe Kushtet e Shfrytëzimit të Shtëpisë së Kulturës “Xheladin Kurtaj” në Komunën e Kaçanikut**, për procedim të mëtutjeshëm si pikë e rendit të ditës në mbledhjen e radhës së Kuvendit Komunal .

Me respekt !



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO
Komuna e Kaçanikut
Opština Kačanik/Municipality of Kačanik



DRAFT RREGULLORE _____



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E KAÇANIKUT
OPŠTINA KAÇANIK



I	Data	14.06.23	Vendi	KAÇANIK
Nj. org.	Numri	Shtojcë		
09	104/02	14211 /		

**PËR MËNYRËN DHE KUSHTET E SHFRYTËZIMIT TË SHTËPISË SË
KULTURËS “XHELADIN KURTAJ “NË KOMUNËN E KAÇANIKUT**

Kaçanik, Maj 2023

Në mbështetje të nenin 11 dhe nenit 12 paragrafi 2, pika (c), si dhe nenit 58 pika (h) të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale 03/L-040; nenit 34 paragrafi 5, si dhe nenit 73 të Statutit të Komunës së Kaçanikut (Teksti i spastruar sipas Statutit 01.Nr.60/01-12895/20-për Ndryshimin dhe Plotësimin e Statutit të Komunës së Kaçanikut 01.Nr.3588/2008 të datës 25/08/2008), Kuvendi i Komunës së Kaçanikut, në mbledhjen e mbajtur më: _____, Miratoj këtë:

RREGULLORE

PËR MËNYRËN DHE KUSHTET E SHFRYTËZIMIT TË SHTËPISË SË KULTURËS “XHELADIN KURTAJ “ NË KOMUNËN E KAÇANIKUT

DISPOZITAT E PËRGJITHSHME

Neni 1

Qëllimi

Me këtë Rregullore përcaktohen mënyrat dhe kushtet e shfrytëzimit të Shtëpisë së Kulturës “Xheladin Kurtaj” për aktivitete kulturore, manifestimeve të ndryshme të kulturës dhe aktiviteteve të tjera, tubimeve partiake, revistave, si dhe grupeve të tjera formale dhe joformale.

Neni 2

Përkufizimet

1. DKRS —Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport
2. Objekt Kulturor -nënkupton objektin ku ndodhen salla e madhe dhe e vogël, hapësirat e Muzeut të Qytetit të Kaçanikut (të cilat do të shfrytëzohen sipas rregullores së veçantë të Muzeut) ,salla e bibliotekës, zhveshtoret, hapësirat teknike dhe logjistike dhe hapësirat tjera mbështetëse.
3. Menaxher - personi zyrtar që kujdeset për planifikim dhe organizim të punëve, koordinim me OJQ-të,SHKA-të, komunikim me strukturat e Komunës, kontrollin e stafit, raportimin e punës, etj.

Neni 3

Funksionimi i Shtëpisë së Kulturës “Xheladin Kurtaj”

1. Shtëpia e Kulturës “Xheladin Kurtaj” është pasuri publike e Komunës së Kaçanikut si objekt i kultures dhe është në funksion të kulturës.
2. Shtëpia e Kulturës “Xheladin Kurtaj” është një ndër institucionet e kulturës në komunë dhe ka për qëllim t’i shërbejë zhvillimit të kulturës nëpërmjet institucioneve të kulturës.
3. Selia e Shtëpisë së Kulturës “Xheladin Kurtaj” është në Kaçanik Bulevardi “Ismail Raka “ Nr.200
4. Shtëpia e Kulturës “Xheladin Kurtaj” është institucion kulturor , që nxit dhe mundëson zhvillimin e politikave kulturore dhe siguron qasje të lirë dhe ofron shërbim të barabartë për të gjithë qytetarët.
5. Shtëpia e Kulturës “Xheladin Kurtaj” ofron hapësira për shfrytëzim për aktivitete kulturore, dhe aktivitete tjera, varësisht nga veprimtaria dhe të mirat që sjell për qytetarët e Komunës së Kaçanikut.
6. Funksioni primar i Shtëpisë së Kulturës “Xheladin Kurtaj” është që të krijoj kushte për zhvillimin e aktiviteteve kulturore, rekreative, koncerte, tubime dhe ngjarje tjera të organizuara.
7. Në Shtëpinë e Kulturës “Xheladin Kurtaj” mund të zhvillohen aktivitete promovuese kulturore, ekonomike, tubimet nga fushat politike etj. .

Neni 4

Mirëmbajtja dhe Investimet Kapitale

1. Të hyrat që gjenerohen nga aktivitetet në Shtëpinë e Kulturës “Xheladin Kurtaj” do të derdhen në llogarinë bankare të Komunës së Kaçanikut.
2. Menaxhmenti i objektit obligohet të njoftoj DKRS-në për çdo prishje, demolim dhe për çdo intervenim tjetër me anë të kërkesës.
3. DKRS e shqyrton kërkesën e parashtruar për intervenim në mirëmbajtje, dhe e rekomandon te Kryetari i Komunës për aprovim.
4. Investimet kapitale të nevojshme në Shtëpinë e Kulturës “Xheladin Kurtaj” realizohen nga buxheti i Komunës së Kaçanikut dhe donatorët e ndryshëm.
5. Nevojat për investimet përcaktohen nga DKRS-ja dhe aprovohen nga Kryetari i Komunës.

Neni 5

E drejta për shfrytëzimin e Shtëpisë së Kulturës “Xheladin Kurtaj”

Të drejtën e shfrytëzimit të Shtëpisë së Kulturës “Xheladin Kurtaj” e kanë: OJQ-të, SHKA-të, Institucionet shtetërore, organizatat politike, bizneset, institucionet shkollore, universitetet, institucionet ndërkombëtare, grupe e tjera formale dhe joformale dhe gjitha organizatat kulturore.

Neni 6

Mënyra e shfrytëzimit të Shtëpisë së Kulturës “Xheladin Kurtaj”

Mënyra e shfrytëzimit të Shtëpisë së Kulturës rregullohet me anë të marrëveshjes së arritur të palës së interesuar me menaxherin e Shtëpisë së Kulturës “Xheladin Kurtaj, e cila nënshkruhet nga menaxheri dhe palës së interesuar.

Neni 7

Kërkesa për shfrytëzim

1. Pala e interesuar për shfrytëzim të shtëpisë së kulturës “Xheladin Kurtaj” duhet të paraqesë kërkesë së paku 3(tri)ditë pune para mbajtjes së aktivitetit, dhe me kohë të dorzoj edhe shkresën me të cilën dëshmon për njoftimin e aktivitetit në organet përgjegjëse të sigurisë (Polici, kompani të sigurimit etj...), varësisht nga natyra e aktivitetit.
2. Kërkesa i drejtohet me shkrim DKRS-së, i cili obligohet për të kthyer përgjigje me shkrim brenda 24 orëve.
3. Udhëheqësit e SHKA-ve, dhe frekuentuesit e tjerë sipas marrëveshjes obligohen që për çdo fillim të vitit në muajin Janar ti prezantojnë përgjegjësit orarin e aktiviteteve të veta.

Neni 8

Orari i shfrytëzimit të Shtëpisë së Kulturës “Xheladin Kurtaj”

1. Objekti kulturor është në funksion 7 ditë në javë duke filluar nga ora 8:00h-23:00h.
2. Orari i rregullt i punës është nga dita e hënë deri të premtën nga ora 8:00h -23:00h.
3. Oraret tjera që nuk përkojnë me pikën 2 të këtij neni duhet të rezervohen me kërkesa të posaçme siç është cekur në nenin 7 të kësaj Rregullore.
4. Për lokalet që janë në kuadër të Shtëpisë së Kulturës “Xheladin Kurtaj” do të zhvillohet procedurë për dhënien në shfrytëzim sipas Ligjit për dhënien në shfrytëzim dhe këmbim të pronës së paluajtshme të Komunës dhe Rregullorës Nr.03/2020 për përcaktimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim më pak se një (1) vit të pronës së paluajtshme të komunës së Kaçanikut në përputhje me rregulloren për taksat komunale 02/2020 në Komunën e Kaçanikut dhe pagesave ndaj shërbimeve komunale (uji,rryma,etj..)

Neni 9

Rregullat themelore për shfrytëzimin e Shtëpisë së Kulturës “Xheladin Kurtaj”

1. Për pakënaqësitë eventuale, shfrytëzuesi duhet të drejtohet me ankesë në DKRS.
2. Menaxheri i Shtëpisë së Kulturës “Xheladin Kurtaj” ka të drejtë të suspendoj përkohësisht shfrytëzuesit e hapsirave për mos respektimin e kritereve të përcaktuara në marrëveshje dhe rregullave sipas dispozitave të kësaj rregulloreje deri në vendimin tjetër të DKRS-së.
3. Shfrytëzuesi i Shtëpisë së Kulturës “Xheladin Kurtaj” duhet të identifikohet dhe të regjistrohet çdo herë para shfrytëzimit të hapësirave dhe të respektojë orarin e caktuar në marrëveshje me personat përgjegjës në objekt.
4. Ndalohet pirja e duhanit në të gjitha hapësirat brenda Shtëpisë së Kulturës “Xheladin Kurtaj”.
5. Pas shfrytëzimit të hapësirave në objektet dhe zhveshtore, kujdestarët kontrollojnë hapësirat për të verifikuar gjendjen.
6. OJQ-të, SHKA-të, individët etj. duhet vet të kujdesen për gjërat e tyre personale, ndërsa menaxhmenti i objektit nuk mban përgjegjësi për gjërat e humbura apo të dëmtuara.
7. Shfrytëzimi i hapësirave (sallave) bëhet me pagesë sipas tarifës së caktuar me këtë rregullore ndërsa përjashtim bëjnë vetëm subjektet e lira.
8. Ndalohet hyrja në objekt dhe binë me këpucë të papastrat që lënë gjurmë.
9. Shitja e rekuizitave, pijeve, ushqimeve dhe gjërave tjera në objektin kulturor është e ndaluar.
10. Shfrytëzuesit duhet të sjellin orarin e tyre për shfrytëzimin e hapsirave të Shtëpisë së Kulturës “Xheladin Kurtaj” tek menaxheri.
11. Fëmijët nën moshën 16 vjeçare duhet të jenë nën përcjellje të prindit apo kujdestarit të tyre (gjatë ushtrimeve por edhe gjatë përcjelljes së aktiviteteve kulturore, shfaqjeve etj..)
12. Ndalohet hyrja me kafshë në objekt, ndërsa përjashtohet rasti kur kafsha i ndihmon personit me aftësi të kufizuara, dhe personave zyrtar të sigurisë.
13. Në zhveshtore dhe hapësirat përreth nuk lejohet asnjë lloj i pijeve alkoolike, narkotikëve, pijeve me ambalazh qelqi, ndërsa lejohen vetëm pijet freskuese.
14. Ndalohet hyrja në objekt me bicikleta, skateboard apo çfarëdo mjeti tjetër transportues, përjashtimisht personat me aftësi të kufizuara.
15. Ndalohet hyrja me armë, përpos personave të autorizuar të sigurisë në detyrë.
16. Ndalohet vendosja e posterëve dhe njoftimeve tjera pa leje me shkrim nga ana e menaxherit të Shtëpisë së Kulturës “Xheladin Kurtaj”
17. Ndalohet hudhja dhe dhezja e fishekzjarrëve dhe mjeteve piroteknike mbrenda hapësirave të Shtëpisë së Kulturës “Xheladin Kurtaj”.

Neni 10

Përgjegjësi i Shtëpisë së Kulturës "Xheladin Kurtaj"

Udhëheq, organizon dhe mbikëqyrë funksionimin e Shtëpisë së Kulturës "Xheladin Kurtaj" në bazë të përshkrimit të detyrave të punës, Ligjit dhe kësaj rregullore:

- a) Kujdeset për rendin shtëpiak të këtij institucioni
- b) Harton oraret për shfrytëzimin e hapësirave nga OJQ-të e kulturës, dhe frekuentuesit e tjerë.
- c) Mbikëqyr mirëmbajtjen e objektit,
- d) I raporton eprorit të parë administrative për çdo mangësi, avari ose mos disiplin.

Në Shtëpinë e Kulturës "Xheladin Kurtaj" kanë qasje:

1. Stafi i DKRS-së
2. Të punësuarit në Bibliotekë
3. Anëtarët dhe lexuesit e bibliotekës,
4. Anëtarët e shoqërive, OJQ-ve që janë të vendosura në hapësirat e Shtëpisë së Kulturës "Xheladin Kurtaj"
5. Vizitorët e Galerive, ekspozitave etj.
6. Punëtorët kontraktues që kryejnë punë në objektin e kulturës, pjesëmarrës në intervista të gazetarëve dhe qytetar të tjerë që kanë arsye.
7. Në hyrje të Shtëpisë së Kulturës "Xheladin Kurtaj" është i vendosur recepsionisti (roje), i cili bënë identifikimin dhe evidentimin e zyrtarëve, shfrytëzuesve dhe vizitorëve tjerë.
8. Recepsionisti kontakton me zyrtarin dhe pas pëlqimit nga ai (zyrtari), vizitorit i ndalet dokumenti i identifikimit, i jepet kartela e vizitorit dhe i hapet dera e hyrjes.
9. Recepsionisti evidenton lëvizjen e hyrjes dhe të daljes së vizitorit.
10. Përfaqësuesit politik, ushtarak dhe diplomatik përjashtohen nga këto procedura, vetëm evidentohen.
11. Lexuesit e bibliotekës identifikohen me librat e anëtarësisë, ndërkaq shfrytëzuesit tjerë identifikohen me kartelën e identifikimit (në bazë të orarit që është prezantuar paraprakisht)
12. Fletoren e recepsionistit, çdo 24 orë e kontrollon dhe e nënshkruan menaxheri i Shtëpisë së Kulturës "Xheladin Kurtaj".
13. Hyrjet dhe daljet e zyrtarëve dhe të gjithë shfrytëzuesve të Shtëpisë së Kulturës "Xheladin Kurtaj" do të jenë nën vëzhgimin e kamerave.
14. Sigurimin e Shtëpisë së Kulturës "Xheladin Kurtaj" e bëjnë pjesëtarët e kompanisë, të autorizuar në bazë të procedurave të prokurimit.
15. Sigurimi fizik i hapësirave të Shtëpisë së Kulturës "Xheladin Kurtaj", oborrit dhe parkingut bëhet dhe monitorohet 24 orë në ditë dhe 7 ditë në javë nga personat kompetent për siguri.

Neni 11

Dokumentacioni i nevojshëm për shfrytëzim të Shtëpisë së Kulturës

1. OJQ-të, SHKA-të, etj. për zhvillimin e aktiviteteve të tyre të rregullta kulturore duhet të sjellin tek DKRS-së këto dokumente:
 - 1.1 Certifikatën e regjistrimit;
 - 1.2 Certifikatën fiskale;
 - 1.3 Vertetimin e regjistrimit të lëshuar nga DKRS
 - 1.4 Lejen e njoftimit të personit përgjegjës të organizatës;
 - 1.5 Listën e anëtarëve të organizatës;
2. Organizatat dhe OJQ-të e regjistruara dhe menaxheri i SHK "Xheladin Kurtaj" pas shqyrtimit të kërkesës, lidhin marrëveshje për shfrytëzimin e hapësirave të objektit .
3. Subjektet tjera që nuk kanë marrëveshje duhet të paraqesin kërkesën për shfrytëzim.

Neni 12

Pagesat për shfrytëzimin e hapësirave në Shtëpinë e Kulturës

1. Të gjitha organizatat që kanë marrëveshje dhe të regjistruara në DKRS, e që janë nga Komuna e Kaçanikut mund të shfrytëzojnë hapësirat e objektit në bazë të një orari të rregulluar nga përgjegjësi i SHK "Xheladin Kurtaj" në bashkëveprim me udhëheqësit e këtyre subjekteve dhe të vërtetuara nga DKRS, sipas këtyre pagesave, kriterëve:
 - 1.1 Shtëpia e Kulturës ka sallën e madhe e cila është e dedikuar për mbajtjen dhe organizimin e koncerteve, dramave, orëve letrare, tubimeve, mbledhjeve solemne, mbledhjeve komemorative etj.
 - 1.2 Salla posedon 506 ulëse dhe për shfrytëzimin e saj për tubime, mbledhjeve, etj..caktohet vlera prej 50 Euro në orë të shfrytëzuar, ndërsa për vazhdimin e saj për çdo orë shtohet vlera e çmimit dhe ate 15 Euro deri në orën e pestë të shfrytëzimit.
 - 1.3 Për koncerte caktohet vlera 30% e shitjes së biletave të çmimit të cilin e përcakton organizatori.
 - 1.4 Për drama vlera e sallës është 20% të biletave të shitura.
 - 1.5 Shtëpia e Kulturës ka edhe Sallën e vogël (salla e Kushtetutës së Kaçanikut)e cila është e përshtatëshme për organizimin e mbledhjeve, tubimeve, simpoziumeve orëve letrare si dhe aktiviteteve tjera .
 - 1.6 Organizimet e programeve të dedikuara për qëllime humanitare, si dhe mbledhjet e ndryshme – përvjetoret e ndryshme, mbledhjet komemorative, orët letrare, nuk kanë pagese.
 - 1.7 Orët letrare të cilat i organozon DKRS dhe institucionet komunale poashtu do ta shfrytëzojnë objektin falas.

- 1.8 Të gjitha aktivitetet kulturore të cilat organizohen nga shoqëritë, grupet dramatike dhe klubet e ndryshme kulturore komunale bëjnë pagesën 10% të biletave të shitura.,
2. Shtëpia e Kulturës mund të shfrytëzohet edhe për manifestime dhe ngjarje të ndryshme:
- 2.1 Për ngjarje komerciale (panaie, revy, ekspozita dhe të ngjashme) 200 euro tërë ditor;
- 2.2 Për ngjarje humanitare pa pagesë;
- 2.3 Për koncerte të ndryshme 30 % nga inkasimi i njeteve prej biletave derdhen në llogarinë bankare të Komunës së Kaçanikut; biletat sigurohen nga DKRS, bileta të cilat do të përmbajë numrin serik, llogon e Komunës së Kaçanikut dhe llogon/vulën e organizatorit të aktivitetit
- 2.4 Për organizimin e tubimeve elektorale të subjekteve të ndryshme politike 150 € për një orë.
- 2.5 Nga obligimet financiare lirohen të gjitha aktivitetet që organizohen nga komuna për nder të festave shtetërore, kombëtare, qofshin ato me karakter edukativ, kulturor, etj.
- 2.6 Nga obligimet financiare lirohen subjektet : Shoqatat e dalura nga lufta, FSK, njësitë policore , KFOR, shoqatat dhe klubet e personave me aftësi të veçanta të aprovuara nga DKRS , Kryqi i Kuq ,vullnetarët e aprovuar nga DKRS.,
- 2.7 Parkingu mund të shfrytëzohet falas nga anëtarët e subjekteve frekuentuese, Shoqatat e dalura nga lufta, FSK, njësitë policor , KFOR, Kryqi i Kuq, personat me aftësi të veçanta të aprovuara nga DKRS.

Neni 13

Masat ndëshkuese

1. Ndaj palëve të cilat nuk e respektojnë rendin shtëpiak dhe nuk i binden menaxhmentit të objektit kulturor do të merren masa ndëshkuese, suspendim i përkohshëm nga e drejta e shfrytëzimit të SHK "Xheladin Kurtaj" me kohëzgjatje të lirë për tu përcaktuar nga përgjegjësi i objektit dhe nëse përsëritet më shumë se dy herë i njëjti veprim atëherë i merret e drejta për shfrytëzim derisa organizata në fjalë është i përbërë nga të njëjtit akterë.
2. Për dëmet eventuale të shkaktuara nga frekuentuesit apo subjektet tjera përkatëse përgjegjësia bie te shfrytëzuesi i cili e ka shkaktuar dëmin, andaj kompensimet duhet bërë në afat prej pesë (5) ditëve në xhirollogarinë e komunës së Kaçanikut
3. Dëmet e shkaktuara vlerësohen nga komisioni ad-hoc prej tre anëtarëve të emëruar nga DKRS-ja. i cili duhet të përgatis procesverbal të posaçëm për dëmet e regjistruara
4. Në rast të moskompensimit të dëmeve në afatin e paraparë sipas paragrafit 2 të këtij neni, inicohet procedura gjyqësore përmes përmbaruesit privat duke përfshirë edhe kamatën ligjore si dhe ndalesën për mos shfrytëzim deri në zgjidhjen e kontekstit.

Neni 14

Rregullimi dhe ndryshimi i mjedisit

1. Ndryshimet në SHK "Xheladin Kurtaj" bëhen vetëm me lejen e Komunës - DKRS-së.
2. Projektet për investime kapitale në Shtëpinë e Kulturës "Xheladin Kurtaj" bëhen duke u bazuar në udhëzimet e akteve ligjore dhe nënligjore që e rregullojnë veprimtarinë përkatëse.

II. DISPOZITAT KALIMTARE DHE PËRFUNDIMTARE

Neni 15

Shfuqizimi

Me hyrjen në fuqi të kësaj Rregullore, shfuqizohen Rregulloret dhe Vendimet e miratuara nga Kuvendi i Komunës së Kaçanikut të cilat bien ndesh me dispozitat e kësaj Rregullore.

Neni 16

Konflikti me ligjin

Në rast të konfliktit dhe mos përputhje të dispozitave të kësaj Rregullore dhe dispozitave të ligjeve dhe akteve tjera nënligjore, do të aplikohen dispozitat e Ligjit dhe akteve tjera nënligjore që janë të aplikueshme në Republikën e Kosovës.

Neni 17

Zbatimi i Rregullores

Për zbatimin e kësaj rregullore do të kujdeset kryetari i Komunës dhe Drejtoria për Kulturë Rini dhe Sport në Komunën e Kaçanikut, dhe menaxhmenti i Shtëpisë së Kulturës "Xheladin Kurtaj".

Neni 18

Hyrja në fuqi

Kjo Rregullore hyn në fuqi 7 ditë pas shpalljes në web Faqen e Komunës së Kaçanikut.

Kryetari i Komunes
Beshir Ilazi





Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Kaçanikut
Opština Kaçanik
Municipal Kaçanik

Departamenti i Financave dhe Buxhetit
Departament za Finansije
Department of Finance and Budget

01Nr. 100/1-14264/23
Kaçanik; 14.06.2023

PËR/ZA/TO:	KEMAJL MËRSELI – KRYESUES I KUVENDIT KOMUNAL KAÇANIK
CC:	
PËRMES/PREKO/THROUGH:	Bahri Selimi – Drejtor për Buxhet dhe Financa Valdrin Dogani – Zyrtar Kryesor Financiar (ZKF)
NGA/OD/FROM:	Besim Ilazi – Kryetar i Komunës
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Dorëzimi i Kornizës Afatmesme Buxhetore Komunale (KABK) 2024-2026

Të nderuar,

Përmesë kësaj shkrese, ju dorëzojmë Kornizën Afatmesme Buxhetore Komunale (KABK) për periudhën e viteve 2024 -2026, sipas kufijëve fillestarë të përcaktuar me Qarkoren Buxhetore të MFPT 2024/01.

KABK si dokument shumë i rëndësishëm për planifikimin afatmesëm dhe strategjik, është hartuar në bazë të kufijëve fillestar të përcaktuara me Qarkoren e parë buxhetore 2024/01 të lëshuar nga MFPT.

Bashkangjitur shkresës:

- 1) Korniza Afatmesme Buxhetore Komunale 2024-2026.

Me respekt,



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosova

**DRAFT K O R N I Z A
A F A T M E S M E
B U X H E T O R E (KAB) E
KOMUNËS SË KAÇANIKUT
2024-2026**

Drejtoria për Buxhet dhe Financa

Qershor, 2023

Përmbajtja

I. Hyrje

II. Deklarata e Komunës në lidhje me prioritetet strategjike zhvillimore

- 2.1. Përshkrimi i komunës dhe profili ekonomik
- 2.2. Vizioni i Komunës
- 2.3. Objektivat dhe Prioritetet Afatmesme

III. Korniza Fiskale Komunale

- 3.1 Burimet e Financimit Komunal për vitet 2024 – 2026
- 3.2 Tendenca e shpenzimeve komunale dhe parashikimet 2024-2026

I. Hyrje

Mbështetur në Ligjin Nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, Qeveria e Republikës së Kosovës gjatë muajit prill të këtij vitit, ka aprovuar Kornizën Afatmesme të Shpenzimeve Qeveritare (KASH) për periudhën 2024 – 2026.

Korniza Afatmesme e Shpenzimeve (KASH 2024-2026) paraqet dokumentin kryesor mbi bazën e të cilit do të hartohet Buxheti Vjetor për vitin 2024. Qëllimi kryesor i KASH-it është që të ofrojë një analizë, e cila reflekton mjedisin makroekonomik në vend, për të vendosur kështu bazën për planifikimet buxhetore për vitet që vijnë në përputhje me prioritetet strategjike të Qeverisë. Në përgjithësi, ky dokument strategjik përmban dhe shtjellon katër kapituj kryesorë si vijon:

- Deklaraten e prioriteteve afatmesme 2024-2026,
- Kornizën Makrofiskale,
- Korniza e shpenzimeve sektoriale 2024-2026 – QEVERIA QENDRORE
- **Niveli komunal - Burimet e Financimit Komunal për vitet 2024-2026**

Pas hartimit nga Ministria e Financave të Kornizës Afatmesme të Shpenzimeve (KASH 2024 – 2026), pason edhe Qarkorja Buxhetore për gjitha Organizatat Buxhetore mbi bazën e së cilës të gjitha OB-të njoftohen mbi instruksionet e hartimit të buxheteve të tyre për periudhën 2024 – 2026.

Qarkorja Buxhetore 2024/01 ofron udhëzimet e para të përgatitjes së buxhetit komunal, përfshirë këtu kalendarin kohor indikativ si dhe kufijtë fillestarë të financimit për komunat për periudhën 2024 – 2026. Bazuar në kufijtë fillestarë të percaktuara nga Qarkorja Buxhetore, autoritetet komunale janë angazhuar në përgatitjen e KAB 2024-2026 të Organizatës Buxhetore ‘652’ Komuna e Kaçanikut.

Korniza Afatmesme Buxhetore Komunale - KABK, siguron një analizë të hollësishme të shpenzimeve publike dhe përcakton parametrat dhe prioritetet kryesore për zhvillimin e vazhdueshëm të buxhetit vjetor. Gjithashtu, KABK siguron mekanizmat e nevojshme, përmes të cilave, objektivat prioritare, të identikuara në dokumentet strategjike të komunës, aty ku ekzistojnë, të integrohen sa më mirë në procesin buxhetor.

Hartimi i Kornizës Afatmesme Buxhetore Komunale përbën një detyrim për institucionet buxhetore komunale të kërkuar nga Qarkorja Buxhetore Komunale 2024/01 të pranuar nga Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve.

Korniza Afatmesme Buxhetore Komunale do të jetë baza për përcaktimin e sektorëve prioritarë të zhvillimit dhe identifikimin e prioriteteve të shpërndarjes së burimeve komunale për periudhën 2024-2026.

KAB Komunal, është dokumenti i parë që i prinë procesit të hartimit të Buxhetit pas pranimi të Qarkores së parë Buxhetore që lansohet nga Ministria e Financave Punës dhe Transfereve për çdo vit. Kalendarin kohor të procesit buxhetor sipas udhëzimeve të Qarkores Buxhetore 2024/01 po e paraqesim si vijon:

- Shkresa përcjellëse bazuar në aprovimin e propozim-buxhetit nga Kuvendi Komunal (nënshkruar nga Kryetari i Komunës).

- Vendimi i Kuvendit Komunal mbi aprovimin e propozim-Buxhetit komunal për vitin 2024-2026, përfshirë projektet kapitale shumëvjeçare.
- Tabelat e buxhetit komunal (BDMS dhe PIP):
- Tabela 4.1 - plani i ndarjeve buxhetore të shpenzimeve totale të komunës për vitin 2024-2026 (kopje e shtypur prej BDMS, vulosur si dhe nënshkruar nga Kryetari i Komunës dhe ZKF).
- Tabela 4.2 - financimi i projekteve kapitale për vitin 2024 dhe projekteve kapitale shumëvjeçare për vitet 2024-2026 (shtypur nga sistemi PIP, vulosur si dhe nënshkruar nga Kryetari i Komunës dhe ZKF).
- Tabela 4.3 - plani afatmesëm i të hyrave totale të buxhetit komunal nga grantet qeveritare dhe të hyrat vetanake (shtypur nga BDMS, vulosur si dhe nënshkruar nga Kryetari i Komunës dhe ZKF).
- Tabelat e Buxhetimit të Përgjegjshëm Gjnor.

Më në detaje kemi paraqitur më poshtë fazat e procesit buxhetor komunal 2024:

1. Përgatitja e Kornizës Afatmesme Buxhetore Komunale 2024-2026:

- Dokument bazik i nivelit të lartë strategjik komunal, i cili pasqyron caqet e përgjithshme të të hyrave dhe shpenzimeve buxhetore si dhe strukturën përkatese sipas kategorive ekonomike.

2. Shqyrtimi i prioriteteve për programet komunale:

- Kryetari i Komunës, Drejtori i Buxhetit dhe Financave si dhe drejtorët e drejtorive komunale bëjnë shqyrtimin e politikave dhe prioriteteve në fushat e tyre sektoriale.

3. Kufijtë fillestarë specifik për programet buxhetore:

- Rekomandohet se kufijtë fillestarë specifik të programeve duhet të percaktohen para datës 01 Korrik 2023 bazuar në projeksionet e vendosura të Qarkores 2024/01, MFPT.

4. Dorëzimi i propozim buxhetit komunal sipas programeve:

- Drejtorët e drejtorive bëjnë prezantimin e vlerësimeve të tyre buxhetore dhe propozimeve, përfshirë politikat e reja si dhe opsionet për kursime të mundshme.

5. Dëgjimet buxhetore:

- Seanca dëgjimore në secilën drejtori komunale me qëllim të shqyrtimit të buxheteve të propozuara si dhe dëgjime publike të hapura me publikun.

6. Shqyrtimi i buxhetit komunal nga Kuvendi Komunal:

- Kryetari i Komunës, përmes Drejtorisë së Buxhetit dhe Financave dorëzon propozim-buxhetin në Kuvendin Komunal për shqyrtim dhe aprovim, jo më vonë se 01 Shtator 2023.

7. Aprovimi i buxhetit të propozuar nga K.Komunal dhe dorëzimi në MFPT:

- Propozim buxheti komunal për vitin 2024, i aprovuar nga Kuvendi Komunal dorëzohet në MFPT deri më 30 Shtator 2023.

II. Deklarata e Komunës në lidhje me prioritetet strategjike zhvillimore

Komuna e Kaçanikut, bazuar në Strategjinë e saj Zhvillimore dhe dokumenteve tjera të rëndësishme si: Plani Zhvillimor Komunal dhe ai i Hartave Zonale, Plani Rregullativ Urban, etj, synon ti arrijë gjitha objektivat e paraqitura në një periudhë afatmesme.

Në veçanti Strategjia Zhvillimore Komunale, trajton potencialin real zhvillimor të Komunës krahas burimeve në dispozicion, ku të gjeturat pastaj janë adresuar me propozime konkrete:

- i. Identifikimin e potencialit real të Komunës së Kaçanikut;
- ii. Adresimin e mënyrave të rritjes ekonomike, si dhe krijimit të kapaciteteve të reja ekonomike;
- iii. Adresimin e mënyrave të krijimit të hapësirës dhe lehtësive ligjore në nivel lokal, për investime të reja, si dhe rritjen e konkurrencës në Kaçanik me qëllim përfundimtar thithjen e investimeve të huaja direkte;
- iv. Rritjen e konkurrencës së bizneseve lokale, zvogëlimin e papunësisë dhe rritjen standardit të jetesës.

Vizioni dhe qëllimet e paraqitura në këtë strategji synojnë që në tre vitet e ardhshme ta transformojnë Kaçanikun në një Komunë e cila i shfrytëzon dhe i materializon përparësitë e veta që vijnë nga:

- Pozicionimi gjeostrategjik, i cili i mundëson kyçje në arteriet shtetërore të transportit rrugor dhe hekurudhor të mallrave dhe njerëzve. Kaçaniku ka poashtu pozicion ideal sa i përket çasjes në kryeqytete dhe aeroporte;
 - > 55 km larg kryeqytetit të Kosovës, Prishtinës dhe Aeroportit Ndërkombëtar të Prishtinës, “Adem Jashari”.
 - > 34 km larg kryeqytetit të Maqedonisë, Shkupit dhe 55 km larg Aeroportit Ndërkombëtar të Shkupit.

Burimet e bollshme ujore që kanë potencial të madh për akumulim dhe shfrytëzim të ujrave sipërfaqësore për ujitje dhe përpunim të ujit për ujë të pijshëm. (dy lumenjë përshkojnë territorin e Komunës, lumi Lepenc dhe ai i Nerodimes).

Pasuritë e bollshme nëntokësore; Komuna e Kaçanikut karakterizohet me pasuri nëntokësore të cilat janë shfrytëzuar maksimalisht në të kaluarën, siç është gëlqerja;

Industria e drurit – prodhimi dhe përpunimi i drurit;

Industria ndërtimore - prodhim dhe përpunim;

Hapësirat dhe terreni karakteristik me potencial për zhvillim të turizmit rural (verë dhe dimër). Komuna karakterizohet me dy klima: ajo mesdhetare në pjesën jugore të Komunës si dhe ajo kontinentale, në pjesën veriore të saj;

Trashëgimia kulturore;

Aktivitetet artizanale; ku në politikën e sektorit të zhvillimit ekonomik në kuadër të Drejtorisë së re për Zhvillim Ekonomik dhe Turizëm, parashihet edhe perkrahja me grante e bizneseve në mënyrë që të mbahen gjallë aktivitetet e tilla artizanale.

II.1. Përshkrimi i komunës dhe profili ekonomik



Kaçaniku është njëra ndër komunat më të bukura në Kosovë që ka potencial të jashtëzakonshëm për zhvillimin e turizmit e sidomos turizmit malor. Kjo do të nënkuptonte edhe zhvillimin e bizneseve shërbyese hoteliere. Bujqësia gjithashtu është një ndër shtyllat më me influencë dhe paraqet potencial të rëndësishëm për zhvillimit ekonomik të komunës. Kaçaniku ka kushte mjaftë të mira edhe për zhvillimin e industrisë ekstraktuese, ndërtimit, industrisë së ushqimit dhe përpunimit, që do të mund të ishin shtysë e rëndësishme për zhvillimin ekonomik të komunës.

Potencialet për zhvillim ekonomik janë shfrytëzuar relativisht pak deri më tani, ndërsa Kaçaniku pas ndarjes së Hanit të Elezit i takon komunave me një zhvillim më të ulët industrial të Kosovës. Burimi kryesor i gjenerimit të hyrave të qytetarëve të komunës së Kaçanikut janë prodhimtaria e vogël, shërbimet, bujqësia (ekonomitë familjare) dhe tregtia. Në përgjithësi, mjedisi për zhvillimin e ndërmarrjeve ende mbetet i pafavorshëm dhe me mbështetje të pamjaftueshme.

Ndërmarrjet:

Në komunë janë të regjistruara gjithsej 1275 ndërmarrje. Nga bizneset e regjistruara afro 82% biznese janë individuale ndërsa 15% biznese Shoqëri me përgjegjësi të kufizuar dhe pjesa tjetër përfshin Shoqëritë aksionare Ortakëritë, Bizneset e huaja dega ne Kosovë, etj. Ndërmarrjet të cilat kanë pronar te gjinisë femërore janë 16% (tipi biznesit tek pronaret femra

fokusohet me shume ne biznese individuale) ndërsa pronaret meshkuj përfshin rreth 84% te bizneseve. Viteve te fundit ka rritje te bizneseve te tipit shoqëri me përgjegjësi te kufizuar.

Sektorët ekonomik dhe pronësia e ndërmarrjeve:

Sektorët ekonomik dominues janë kryesisht tregtia me shumicë dhe pakicë, aktivitetet shërbyese dhe ndërtimtaria. Tregtia përfshinë 31% të ndërmarrjeve, aktivitetet shërbyese 27%, ndërtimtaria 11%, ndërsa sektorët tjerë përfshinë pjesën tjetër prej 31%. Këta sektorë edhe janë shquar për rritje gjatë viteve të fundit, ndërsa rënie nuk është shënuar në asnjë sektor. Përkundër potencialeve të Kaçanikut për zhvillimin e bujqësisë, ky sektor mbetet fare pak i përfaqësuar, me vetëm 3%.

Të gjitha ndërmarrjet janë private. Dominimi i sektorit privat është një tregues i ndërmarrësisë në nivel komunal, i cili ka nevojë për përkrahje të mëtejme, duke i pasur parasysh edhe potencialet lokale.

Ndërmarrjet sipas vendbanimeve:

Numri më i madh i ndërmarrjeve është i përqendruar në Kaçanik, si qendër komunale dhe udhëkryq regjional. Qyteti i Kaçanikut përbën 49% të numrit të ndërmarrjeve në nivel komunal. Vendbanimi i dytë për kah numri i ndërmarrjeve është Doganaj 6%, e pasuar nga Kaçaniku Vjetër, Dubrava, etj. Gjatë viteve të fundit, përgjithësisht numri i ndërmarrjeve në të gjitha vendbanimet është rritur, përveç në disa fshatra të vogla ku numri ka mbetur konstant.

Duke i marrë për bazë sektorët në të cilat janë të orientuara ndërmarrjet, përqendrimi i tyre është në qendrën komunale, vendbanimet e mëdha si Doganaj dhe rrugët kryesore (nacionale, rajonale dhe kryesore lokale) si dhe në vendbanimet që shtrihen pranë rrugëve të rëndësishme në nivel rajonal. Ndërmarrjet me të mëdha si për nga kapitali dhe numri punëtorëve gjenden përgjatë rrugës nacionale N2 dhe në Doganaj.

Punësimi:

Sipas të dhënave zyrtare, numri i të punësuarve në ndërmarrjet e Komunës së Kaçanikut është 839. Nga ky numër 305(36%) janë të punësuar në sektorin e tregtisë, 134 (16%) në aktivitete shërbyese dhe 24% në bujqësi, transport dhe hoteleri. Sektorët tjerë përfshijnë 24% të punësuarve. Nëse krahasohet numri i të punësuarve me numrin e ndërmarrjeve, madhësia mesatare e ndërmarrjes del të jetë punëtorë 0.66, që është mjaftë e ulët.

Sot, Komuna e Kaçanikut përbëhet prej 28 vendbanimeve rurale dhe 1 vendbanimi urban, të shtrirë në një hapësirë prej rreth 211 km². Gjeografikisht, Komuna e Kaçanikut është e pozicionuar në pjesën juglindore të Kosovës, në koordinatat 42°14 48 V dhe 21°15 19 L, dhe kufizohet me Komunën e Vitisë, Ferizajit, Shtërpcës, Hanit të Elezit, si dhe me Republikën e Maqedonisë.

Në Komunën e Kaçanikut jetojnë 33,409 banorë, që sipas regjistrimit të fundit, të vitit 2011, prej tyre 10,393 banorë përbëjnë popullsi urbane, kurse 23,016 atë rurale.

Komuna e Kaçanikut ka disa predispozita që e bëjnë atë mjaft atraktive për investime dhe zhvillim ekonomik. Një nga predispozitat kryesore është pozicionimi gjeografik në arteriet e transportit rrugor ku tashmë edhe ka përfunduar projekti nacional i realizimit të autostradës “Arbën Xhaferi” që lidhë Kosovën me shtetet fqinje, poashtu edhe transporti hekurudhor ofron qasje të mirë qarkullimi si për levizjen e njerëzve, ashtu edhe të mallërave edhe pse tash e një kohë po zhvillohen punime në hekurudhë nga INFRAKOS.

Sa i përket funksionimit institucional të Komunës së Kaçanikut, sikur edhe në të gjitha komunat tjera në Kosovë, qeverisja lokale është e organizuar në dy shtylla, ekzekutivi, që përbëhet nga zyra e kryetarit, drejtorive dhe stafi tjetër, dhe legjislativi, që përbëhet nga Kuvendi i Komunës.

Kryetari i komunës është autoriteti më i lartë ekzekutiv në komunë dhe zgjidhet direkt nga qytetarët. Aktualisht, ekzekutivi kryesohet nga kryetari i komunës z.Besim Ilazi dhe nën kryetari, z.Sabedin Vishi. Së bashku me zyrën e kryetarit të komunës, janë nëntë drejtoritë të udhëhequra nga drejtorët e drejtorive:

Administratë e Përgjithshme;
Bujqësi, Zhvillim Rural dhe Pylltari;
Buxhet dhe Financa,
Zhvillim Ekonomik dhe Turizëm;
Arsim;
Kulturë, Rini dhe Sport;
Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale;
Shërbime Publike dhe Emergjencë;
Urbanizëm, Kadastër dhe Mbrojtje të Mjedisit;

Kuvendi Komunal ka 27 vende (anëtar të Kuvendit), të ndara në mes të 5 partive politike. Të 27 anëtarët janë shqiptarë të Kosovës dhe 10 prej tyre janë femra.

Buxheti i pamjaftueshëm komunal, poashtu ka qenë pengesë për nxitje të një zhvillimi më të hovshëm ekonomik të ekonomisë lokale. Deri më tani, qeverisjet komunale lokale të komunës kanë qenë të detyruar të angazhohen dhe të orientojnë mjetet financiare të dedikuara për projekte kapitale në drejtim të rregullimit, ndërtimit dhe asfaltimit të rrugëve të ndryshme në territorin e komunës, mirëmbajtjen e tyre, ndërtimin e shumë kanalizimeve fekalë e atmosferike, ndërtimin e objekteve arsimore, shëndetësore si dhe mirëmbajtjen e vazhdueshme të tyre.

Nga niveli Qëndror deri me tani është arritur mjaft thithja e investimeve kapitale për komunën e Kaçanikut, mirëpo ende mungon qasja e duhur nga niveli qendrorë për balancim socio – ekonomik në nivel rajonesh, jemi dëshmitarë të një zhvillimi të hovshëm të qendrave rajonale por jo edhe komunave më të vogla si pjesë e këtyre rajoneve. Kjo për arsye se janë angazhuar shumë projekte kapitale në drejtim të komunave me të mëdha si pasojë edhe e ndikimeve politike, si rezultat i një sistemi disfavorizues për komunat me numër më të vogël të banorëve, pra pamundësia e përfshirjes në vendimmarrje në aspektin ekzekutiv qeveritar dhe atë legjislativ në nivelin qendror.

II.2. Vizioni i Komunës


Vizioni i Komunës së Kaçanikut definohet me *“nivel të lartë të zhvillimit ekonomik, me një bujqësi, industri dhe turizëm të zhvilluar, me mjedis të qëndrueshëm dhe komunitet të shëndetshëm, mirë të arsimuar, me rini aktive në kulturë dhe sporte dhe me kushte të mira për punë dhe jetesë.”*

Vizioni i mëposhtëm për Komunën e Kaçanikut i definuar pas konsultimeve me akterët e rëndësishëm të jetës politike ekonomike e sociale në Komunë bazohet edhe në dokumentet afatmesme dhe afatgjata strategjike, që ka zhvilluar komuna sic janë:

- Korniza Afatmesme të Shpenzimeve (KASH) 2024-2026 e Qeverisë së Kosovës dhe prioriteteve bazë të saj, si dhe Qarkoret Buxhetore Komunale 2024 (I & II) dhe qarkoret e lëshuara nga Ministria e Financave të Qeverisë së Republikës së Kosovës,
- Strategjia Zhvillimore Komunale;
- Plani i Integruar Komunal;
- Plani zhvillimor i Komunës së Kaçanikut dhe Hartave zonale;
- Plani Rregullativ Urban,
- Plani për Mirëmbajtje Verore dhe Dimërore, etj.

Vizioni

"...Kaçaniku të arrijë nivel të lartë të zhvillimit ekonomik, me një bujqësi , industri dhe turizëm të zhvilluar, me mjedis të qëndrueshëm dhe komunitet të shëndetshëm, mire të arsimuar, me rini aktive në kulturë e sporte dhe me kushtet të mira për punë dhe jetesë."



Forcimi i ekonomisë lokale & Përmirësimi i infrastruktures publike

Objektivat e përgjithshme ekonomike dhe infrastrukturore për komunën janë:

- Përmirësimi i ambientit lokal afarist dhe sigurimi i zhvillimit të qëndrueshëm ekonomik ;
- Ndërtimi dhe përmirësimi i infrastrukturës publike.

Kaçaniku ka një numër të avantazheve për nga karakteri ekonomik. Kemi një lokacion tërheqës, me lidhje të mira rrugore dhe hekurudhore dhe një pikëkalim kufitar të madh në Gllloboçicë dhe tjetri në afërsi të komunës së Hanit të Elezit. Posedojmë furnizim të pasur me lëndë të parë për industrinë e ndërtimit, drurit dhe ujit. Ne kemi në dispozicion një forcë punëtore të arsimuar mirë, dhe një numër të bizneseve të vogla private që zhvillojnë aktivitetet me sukses.

Jemi duke punuar shumë dhe do të vazhdojmë në këtë drejtim për të forcuar rritjen tonë ekonomike, dhe për të bërë Kaçanikun një vend edhe më të përshtatshëm dhe më tërheqës për bizneset lokale – vendore, me theks të veçantë për investime të huaja, këtë qëllim do ta arrijmë përmes krijimit të politikave të mira (të lehta – pa burokraci) zhvillimore lokale.


Në kuadër të politikave tona ekonomike, ku si prioritet kemi rritjen e numrit të të punësuarëve, jemi duke identifikuar edhe disa hapsira të pershtatshme për krijimin e zonave të reja ekonomike si dhe jemi në proces të dhënjes së disa parcelave komunale në shfrytëzim me afatë të gjatë bizneseve, përmes këtij procesi presim shtim të numrit të vendeve të reja të punës si dhe rritje të prodhimit – përmirësimit të ambientit ekonomik lokal.

Në funksion të biznesit lokal ekziston Qendra Komunale për Regjistrimin e Bizneseve. Përmes kësaj qendre komuniteti i biznesit mund të regjistrojë apo themelojë veprimtarinë biznesore vetëm përbrenda 2-3 orëve. Poashtu përmes saj bëhet edhe ofrimi i informatave për investitorët potencial, gjithashtu ipen këshilla ndaj bizneseve fillestare dhe atyre ekzistuese në plotësimin e aplikacioneve të ndryshme si plan biznesi etj, me qëllim të qasjes më të lehtë në financa apo mjete fikse që mund të përfitohen nga donatorët e ndryshëm.

Për disa vite me radhë në kuadër të krijimit të raporteve të shëndosha me Organizatat Nderkombëtare (USAID, Fondacioni Kosovo Luxemburg, Help etj.) jemi perkushtuar në mbështetjen e bizneseve të cilat operojnë në komunën tonë. Kjo mbështetje ka ardhur si rezultat i arritjes së Marrëveshjeve për Bashkëfinancimin e projekteve të përbashkëta mes komunes Kaçanik dhe organizatave të përmenduar më lartë. Projektet e tilla të realizuara deri më tani kanë të bëjnë me krijimin e mundësive të reja për themelimin e biznesit – vetëpunësimi si dhe zgjerim të kapaciteteve për bizneset ekzistuese, të cilave i'u janë financuar paisje pune-makineri me qëllim të shtimit të shërbimeve apo prodhimeve të tyre dhe njëkohësisht angazhim i një numri shtesë të të punësuarëve.

Kaçaniku është njëra ndër komunat më të bukura në Kosovë. Ka potencial të jashtëzakonshëm për turizëm e sidomos turizëm malor. Qendra jonë e qytetit, shëtitorët në Bulevard, shëtitorët rreth lumit Nerodime, trotuaret në ndërtim e sipër pranë lumit Lepenc, dhe Gryka jonë, e bëjnë Kaçanikun një vend shumë atraktiv për ta vizituar.

Maja e Lubotenit është atraktivitet me potencial të lartë turistik me pozitë gjeografike në Malet e Sharrit, në një lartësi mbidetare prej 2498m. Nga maja, vizitorët mund të shohin dy shtete në të njëjtën kohë për shkak të vendndodhjes së saj në kufirin Kosovë – Maqedoni e Veriut.



Ne e pranojmë se ka ende shumë punë për t'u bërë. Në tre vitet e ardhshme ne do të vazhdojmë programin tonë gjithëpërfshirës të zgjerimit, asfaltimit dhe riparimit të rrugëve në të gjitha zonat e komunës sonë; ndërtimin e trotuareve dhe ndriqimit publik për të rritur sigurinë publike; ndërtimin e sipërfaqeve të gjelbra dhe vendosjen e shportave për mbeturina; dhe përmirësimin e furnizimit me ujë dhe të kapacitetit të rrjetit të ujit.

PRIORITETI 1 - Forcimi i ekonomisë lokale & Përmirësimi infrastrukturës publike:

Objektivi 1: Përmirësimi i ambientit lokal afarist dhe sigurimi i zhvillimit të qëndrueshëm ekonomik		
Veprimet:	Matësi ► Caku:	Programi – Drejtoria përgjegjëse:
1. <i>Funksionalizimi i zonave ekonomike dhe industriale.</i>	Plotësim i infrastrukturës së nevojshme si: qasje me te lehtë rrugore, paisja e zonave me trafo elektrike dhe hidro sistem. Zonat-pronat komunale në shfrytëzim të investitorëve (conform ligjit përkatës). Themelimi i bizneseve të reja. Hapja e vendeve të reja pune.	Drejtoria e Buxhetit dhe Financave. Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik dhe Turizmit. Drejtoria e Urbanizmit, Kadastrit dhe

		Mbrojtjes së Mjedisit. Komisionet përgjegjëse të themeluara nga Kuvendi Komunal.
2. Ofrimi i lehtësirave për themelimin dhe ushtrimin të aktivitetit afarist	Subvencionimi i bizneseve, promovimi i tyre. Shkurtimi i kohës për themelim biznesi per vetem 2 -3 orë. Rritja e numrit te bizneseve lokale	Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik dhe Turizmit.
3. Hartimi i strategjisë së re afatmesme 2021-2025 për Zhvillim Ekonomik Lokal	Analiza sektoriale: identifikimi i potencialeve/resurseve te reja dhe strategjike, gjetja e mundesive per investime te reja, bashkëveprim me organizatat e ndryshme. Promovimi i potencialeve tona, thithja e investimeve të reja. Arritja e zhvillimit te qendrueshem ekonomik lokal.	Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik dhe Turizmit.

4. Përmirësimi i infrastruktures tek zonat ekzistuese turistike, caktimi dhe funksionalizimi i zonave të reja turistike.	Rritje e zhvillimit ekonomik nga turizmi Restaurim i monumenteve historike. Hartimi i projekteve strategjike. Ekzistimi i hartës turistike në qytet për orientimin e vizitorëve. Rritja e numrit të vizitorëve.	Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik dhe Turizmit. Drejtoria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit.
Objektivi 2: Ndërtimi dhe përmirësimi i infrastrukturës publike		
Veprimet:	Matësi ► Caku:	Programi – Drejtoria përgjegjëse:
1. Ndërtimi, asfaltimi, riparimi dhe pastrimi i rrugëve.	Ngritja e standardit dhe kualitetit jetësor të qytetarëve nga numri i madhë i rrugëve të ndërtuara, asfaltuara dhe riparuar. Shtimi i ndërtimit të trotuareve.	Drejtoria e Urbanizmit, Kadastrit dhe Mbrojtjes së Mjedisit Drejtoria e Shërbimeve Publike dhe Emergjencave
2. Përmirësimi i rrjetit të furnizimit me ujë.	Sanimi, rikonstruimi dhe shtimi i kapaciteteve ujore në rrjetin e ujësjellësit në fshatra dhe qytet. Zgjerimi i rrjeteve të reja të ujësjellësit në zonën urbane dhe rurale.	Drejtoria e Shërbimeve Publike dhe Emergjencave
3. Ndërtimi i rrjeteve të ndriqimit publik	Zgjerimi i rrjetit në zonën urbane dhe rrugët e fshatrave.	Drejtoria e Shërbimeve Publike dhe Emergjencave
4. Ndërtimi i kolektoreve kryesor për largimin e ujrave	Ruajtja e shëndetit, pastrimi i lumenjëve, ambientit dhe krijimi i kushteve për të favorshme për turizëm rural.	Drejtoria e Shërbimeve Publike dhe Emergjencave

<i>e zeza përgjatë lumit Nerodime dhe Lepenc.</i>		
---	--	--

Objektivat e përgjithshme bujqësore dhe mjedisor për komunën janë:

- **Subvencionimi i vazhdueshëm i sektorëve të bujqësisë;**
- **Mbrojtja dhe përmirësimi i mjedisit.**

Kaçaniku disponon me resurse të mjaftueshme natyrore:

Disponon me 7,462.70ha. të tokës së punueshme që përdoret për të siguruar ushqim të mjaftueshëm për kafshë dhe për kultivimin e kulturave lavërtare - grurë, misër, perime dhe kultura pëmëtare si: mollë, dardhë, kumbull, mjedër, manaferra etj.

Prej sipërfaqes së përgjithshme të territorit të saj (21,126.00ha) 14,449.09ha. është tokë pyjore, prej tyre 8,963.26ha. janë me pronësi publike dhe 3,485.28ha. janë me pronësi private. Menaxhimi i pyjeve bëhet nga Agjensioni Pyjor i Kosovës (APK).

Ka burime natyrore të mjaftueshme të ujit nga Malet e Sharrit, për furnizim të qytetarëve me ujë të pijes, si dhe rrjedhje të mjaftueshme të përrojeve, përrockave si dhe dy lumenjëve të cilët kalojnë nëpër territorin e komunës sonë (Lumi Lepenc dhe Nerodime), te cilët shfrytëzohen për ujitjen e kulturave bujqësore gjë që favorizon edhe më shumë zhvillimin e bujqësisë.

Zhvillimi i sektorit të bujqësisë për ne ka rëndësi të veçantë, si në aspektin e përmirësimit të bilancit tregtar, uljes së papunësisë, sigurisë së produkteve ushqimore, mbrojtjes së ambientit dhe përmirësimit të jetës së qytetarëve në përgjithësi. Si rezultat i mbështetjes së këtij sektori të ardhurat neto në fermë janë rritur ndjeshëm. Sektori i Bujqësisë, përmes politikave dhe strategjive të zhvillimit do të jetë edhe në të ardhmen e orientuar në mbështetjen e faktorëve të prodhimit, në stimulimin e fermerëve dhe krijimin e një ambienti më të favorshëm zhvillimor.

Në territorin e Komunes sonë, kryesisht kultivohen kulturat lavërtare: grurë 480 ha, misër me fasule 120 ha, misër për kokërr 350 elb 5ha, tërshëra 15 ha, patate 40 ha si dhe kulturat perimore kultivohen vetëm për plotësimin e nevojave familjare, tepicën e [prodhimeve e qesin në treg (prodhimtari ekstensive). Sa i përket pemëtarisë kemi 53 ha. plantacione me pemë: molle, arrë, dardhë, lajthi si dhe pemë të imëta mjedër, krahasuar me vitet e para luftës kemi një rritje të sipërfaqeve. Blegtoria në komunën tonë, pas lufte ka një rënie të fondit blegtoral: deleve, lopëve qumështore e sidomos buallicave. Bletaria është dukshëm më e zhvilluar krahasuar me vitet e para luftës dhe kemi një rritje në fondin e shoqërive me bletë. Sa i përket shfrytëzimit të sipërfaqes së përgjithshme të tokës bujqësore, pjesa dërmuese shfrytëzohen livadhe dhe kullosa, e që paraqet një potencial të mirë për zhvillimin e blegtorisë dhe bletaris. Bazuar në madhësinë e parcelave që disponon, komuna jonë ka kushte për zhvillimin e pemëtarisë dhe perimekulturës.

Edhe pse Kaçaniku është komunë që ofron potencial për zhvillim të bujqësisë, numri i ndërmarrjeve bujqësore është tejet i ulët, numri total i ndërmarrjeve të regjistruara bujqësore përbën vetëm 4% të

ndërmarrjeve në komunë. Numri aktual i të punësuarve në ndërmarrje bujqësore është 90, që tregon përgjithësisht për kapacitete të vogla të ndërmarrjeve, dhe strukturim kryesisht familjar. Kjo tregohet edhe sipas regjistrimit të fundit të ekonomive familjare (2011) ku vetëm rreth 2.5% të punësuarve janë angazhuar në bujqësi, vlerë e cila është shumë e vogël krahasuar me potencialin.

Bujqësia sot zhvillohet vetëm në sektorin privat, kryesisht në bujqësi familjare, për krijimin e të ardhurave shtesë në familje, me parcela të vogla private bujqësore, me mekanizëm bujqësor të vjetruar (amortizuar). Sipërfaqet e tokës bujqësore ku kanë mundësi të ujitjes (ujitja e kulturave bujqësore- lavërtare bëhet përmes kanaleve të hapura të ujitjes të ndërtuara me mure prej betoni, me investime komunale) ndërsa te kulturat pemëtare dhe perimore ujitja bëhet përmes sistemit pikë-pikë të ujitjes. Viteve të fundit ka filluar përkrahja e fermerëve përmes subvencionimit, ndërsa nevojat për përkrahje janë ende më të mëdha se mundësitë buxhetore.

Toka bujqësore - Sipas të dhënave nga Drejtoria e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Pylltarisë, bazuar sipas regjistrimit të vitit 1958, sipërfaqja e përgjithshme e tokës bujqësore është 7642.70 ha, tokë lavërtare 3086.86 ha (41.37%), livadhe 2008.25ha.(26.91%) dhe kullosë 2367.53 (31.72%). Nga sipërfaqja e përgjithshme cekur më lartë, 5051.95 ha (67.70%) ha janë në pronësi private, ndërsa 2410.75 ha (32.30%) ha në pronësi shoqërore dhe komunale. Sa i përket shfrytëzimit, 773 ha (25%) e tokave lavërtare janë të kultivuara (kryesisht grurë dhe misër në përzierje me fasule), ndërsa shumica dërmuese e atyre sipërfaqeve janë shndërruar në livadhe dhe kullosa. Niveli i kultivimit të tokave bujqësore është edhe një tregues i shfrytëzimit të pamjaftueshëm të potencialit bujqësor. Livadhet dhe kullosat përfshijnë 4375.78 ha, pa i llogaritur edhe pjesën e tokës lavërtare, që pas luftës së fundit një pjesë është shndërruar në tokë ndërtimore dhe në livadhe e kullosa.

Prodhimtaria bujqësore - Niveli i prodhimit të drithërave në Kaçanik ka treguar ndryshime viteve të fundit. Ky nivel ka lëvizur prej 3.5 t/ha deri në 4.5 t/ha te gruri, te misri prej 5t/ha deri në 6.5 t/ha, që shënon një rritje prej 1-1.5 t/ha, shprehur në % kemi një rritje prej 30%. Llojet që kultivohen më së shumti janë gruri me 52.63 % dhe misri me 38.78%, patate 4.15% dhe perime 4.43%

Kultivimi i foragjereve përfshinë vetëm jonxhën, që kultivohet në gjithsej 60 ha.

Sipërfaqet e kultivuara me perime përfshijnë vetëm 32 ha. Dominojnë sipërfaqet me spec me 40.62%, domate 37.5%, tranguj 3.75 %, qepë 12.5% dhe llojet tjera 5.63%. Vlen të theksohet se kultivimi i perimeve bëhet kryesisht për plotësimin e nevojave familjare, vetëm tepërcën e prodhimeve e shesin në tregun lokal, (prodhues komercial kemi në numër shumë të ulët).

Sipërfaqet e kultivuara me pemë përfshijnë 51ha. kryesisht (plantacione të reja të ngritura pas luftës së fundit), sipërfaqet e kultivuara me mollë përfshijnë 65.68%, (të sipërfaqes së përgjithshme prej 51 ha), me mjedër 15.68% , me arrë 8.43%, me dardhë 5.88% dhe llojet tjera 4.33 %. Vlen të theksohet se sipërfaqe me pemë ekzistojnë shumë më tepër, por janë në formë shkapërderdhura dhe nuk disponojmë me të dhëna të sakta lidhur me sipërfaqen për ha.

Prodhimtaria blegtorale - Sa i përket kapaciteteve blegtorale, komuna karakterizohet me dominim numerik të gjedheve. Numri i përgjithshëm i gjedheve është 4297, përkatësisht 3648 lopë dhe 649 mëshqerre; numri i deleve është 3432 krerë, ndërsa i dhive 245 krerë. Niveli mesatar i prodhimit të qumështit ka arritur në 12593.09 litra/dit. Numri i shpezëve (pula dhe gjela) është 31086 krerë.

Pyjet:

Sipas të dhënave nga komuna, tokat pyjore përfshijnë 12449.09 ha. E tërë sipërfaqja pyjore kategorizohet si e mbrojtur, pa destinim për ndonjë qëllim komercial. Shumica e sipërfaqeve publike pyjore janë të dëmtuara (të prera) ilegalisht për nevoja të industrisë së drurit në Ferizaj dhe për djegie nga banorët e rajonit të Ferizajt

ku përfshihet edhe Kaçaniku. Nuk ka ndonjë sipërfaqe e cila shfrytëzohet për qëllime komerciale. Sa i përket llojit të drurit, dominon ahu, lisi dhe shkoza por ka edhe pishë, frashër, etj.

PRIORITETI 2 - Zhvillimi i bujqësisë dhe blegtorisë dhe mbrojtja e mjedisit:

Objektivi 1: Krijimi i të ardhurave për fermeret dhe popullatën rurale:		
Veprimet:	Matësi ► Caku	Programi – Drejtoria përgjegjëse:
1. Subvencionimi i sektorëve të bujqësisë dhe blegtorisë	Diversifikimi i fermave gjysmëkomerciale dhe komerciale. Rritja e punimit të sipërfaqeve të tokës bujqësore me kultura lavertare. Rritja e prodhimtarisë bujqësore, prodhimtarisë blegtorale dhe përmirësimi i cilësisë së produkteve bujqësore me qëllim të përmbushjes së standardeve të BE-së. Rritja e prodhimtarisë së mjaltit. Zhvillim më i avancuar i bujqësisë.	Drejtoria e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Pylltarisë
2. Rregullimi i kanaleve të ujitjes.	Krijimi i lehtësirave për fermerët, për ujitjen e kulturave bujqësore. Ndikim në rritjen e rendimentit tek kulturat bujqësore.	Drejtoria e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Pylltarisë
Objektivi 2: Mbrojtja dhe përmirësimi i mjedisit		
1. Rritja e hapsirave gjelbëruese.	Gjelbrimi i qytetit, mbjellja e drunjëve, mirëmbajtja e tyre. Mjedis i shëndetshëm, përmirësim i kushteve për jetesë.	Drejtoria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural DUKMM, DSHPE.
2. Organizimi i aktiviteteve mjedisore	Ngritja e vetëdijesimit të qytetarëve për mbrojtjen e mjedisit.	Drejtoria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural dhe DUKMM.

3. Ndërtimi i shtratit të lumit Lepenc dhe Nerodime dhe shtretërve të përrockave	Mirëmbajtja – Pastrimi i lumenjëve. Ruajtja nga erozioni Shfrytëzimi i ujit të lumit për ujë të tokës.	Drejtoria e Urbanizmit, Kadastrit dhe Mbrojtjes së Mjedisit
4. Implementimi i Planit të ri komunal për Menaxhim të Mbeturinave për periudhën 2023-2027 dhe Hartim i Planit ndërkomunal për Menaxhimin e integruar të mbeturinave	Krijimi i infrastruktures komunale për menaxhimin e mbeturinave. Krijimi i kompanisë komunale për menaxhimin e Mbeturinave. Kompletimi i normave ligjore dhe teknike për inkasim të faturës së mbeturinave nga komuna. Reduktimi gradual i mbeturinave të rrezikshme Plotësimi-ndryshimi i Rregullores komunale për Menaxhimin e Mbeturinave Rritja graduale e përfshirjes së popullatës në sistemin e trajtimit të mbeturinave. Kompletimi i normave ligjore për menaxhimin e mbeturinave në bazë të direktivave të BE-së Shëndritimi i deponive ilegale në hapësira gjelbra.	Drejtoria e shërbimeve publike dhe emergjencave në koordinim me organizatën GIZ

Krijimi i komuniteteve të fuqishme, aktive

Objektivat e përgjithshme të sektorit të shëndetësisë dhe mirëqenies sociale për komunën janë:

- Përmirësimi i shëndetit dhe mirëqenies së qytetarëve;
- Ofrimi i asistencës sociale për familjet me gjendje të rëndë ekonomike.

Jemi në drejtim të plotësimit të numrit të mjaftueshëm të mjekëve dhe me ndihmën e donatorëve, kemi përmirësuar pajisjet tona laboratorike dhe kemi bërë ndertimin dhe renovimin e disa prej qendrave tona mjekësore. Kjo ka çuar në një përmirësim të përgjithshëm në cilësinë e shërbimeve që ne ofrojmë. Megjithatë, ne jemi të vendosur të zbatojmë lëvizjen tonë në drejtim të mjekësisë familjare. Për ta bërë këtë, ne do të duhet të caktojmë më shumë mjekë ashtu që të kemi nga një mjek në çdonjërin prej Qendrave tona të Mjekësisë Familjare, dhe do të punojmë shumë me qeverinë qendrore që të përmirësojmë prokurimin dhe furnizimin e barnave të miratuara në Komunë.



Në tre vitet e ardhshme ne do të shikojmë mundësitë për të siguruar një ekip mjekësor mobil që do të ofrojë këshilla mjekësore dhe trajtim për njerëzit në fshatrat tona më të largëta.

Ne tashmë kemi një ekip mobil që operon në gjithë vendin duke ofruar këshilla për gratë shtatzëna dhe kujdesin e tyre ndaj fëmijëve të posalindur.

Prej muajit qershor të vitit 2016 është në funksion objekti i ri i QKMF-së, këtë projekt komuna e ka konkretizuar me ndihmën e donatorëve të jashtëm dhe participimin vetanë nga buxheti i saj. Modernizimi i objekteve shëndetësore do të ndikojë drejtpërsëdrejti në ofrimin e shërbimeve më cilësore në shëndetësi. Pas ndërtimit të QMF-së në Kaçanik të vjetër, gjatë këtij viti poashtu kemi planifikuar fillimin e ndërtimit të QMF-së në fshatin Doganaj të Kaçanikut, ndërsa ne vazhdimësi mirëmbahen QMF-të në vendbanimet e tjera brenda territorit të komunës.

Janë mbi 800 njerëz që marrin ndihmë sociale. Masat që jemi duke marrë ne, Administrata si e tërë, për të tërhequr biznese dhe investime, të inkurajojmë zhvillimin dhe risitë në bujqësi, si dhe promovimin e turizmit, duhet të rrisin mundësitë e punësimit dhe të zvogëlojnë nevojën për ndihma sociale. Ndërsa për familjet me

nevojë për strehim të përhershëm jemi në përfundim të finalizimit të objektit për banim social me kapacitet për 24 familje ndërsa në listën e projekteve kapitale për tre vitet e ardhshme 2024-2026 janë planifikuar mjetet buxhetore për ndërtimin edhe të një objekti tjetër, në mënyrë që secilës familje me kushte të rënda ti sigurohet banim me kushte më të mira për një jetesë më të dinjitetshme.

Prioritetet e përgjithshme arsimore dhe kulturore për komunën janë:

- Rritja e standardeve në arsim dhe e nivelit të arritjeve;
- Gjithëpërfshirja dhe përkrahja e fëmijëve me nevoja të veçanta
- Siguria në shkolla
- Zgjerimi i hapsirave të reja dhe paisja e shkollave me teknologji të avancuar
- Përkrahja e studentëve të dalluar
- Përmirësimi i kushteve për mbarëvajtjen e aktiviteteve kulturore-sportive
- Subvencionimi i aktiviteteve sportive, kulturore dhe rinore


Niveli i mësimdhënies në Komunën e Kaçanikut çdo vit është duke u ngritur duke filluar nga niveli i Arsimit Parafillor, Fillor, i Mesëm i Ulët e deri te niveli i Mesëm i Lartë.

Në tri vitet e ardhshme prioritetet tona janë që të vazhdohet me përmirësimin e cilësisë në mësimdhënie, përmirësimin e kushteve të punës, zgjerimin e hapsirave shkollore, punësimin e psikologëve dhe pedagogëve në shkolla, përfshirjen e fëmijëve në kopshte dhe çerdhe nga fëmijëria e hershme dhe në veçanti do t'i kushtohet rëndësi sigurisë së fëmijëve në institucione shkollore. Rëndësi e veçantë do t'i kushtohet trajnimit të mësimdhënësve në fusha të ndryshme në mënyrë që të përdorin pa problem teknologjinë bashkëkohore për mësimdhënie dhe për të rritur profesionalizmin dhe kapacitetin e tyre.

DKRS, në bashkëpunim me stafin e Shtëpisë Kulturës “Xheladin Kurtaj” vazhdon të organizojë aktivitete të shumta kulturore për të rritur dhe fëmijë. Të gjitha eventet kulturore, rinore e sportive, klubet sportive, Shoqëritë Kulturo Artistike dhe OJQ-të e ndryshme që merren me aktivitete ndihmohen edhe me subvencione nga DKRS.

Nga muaji Prill 2022, tashmë e kemi funksionale edhe Palestrën e Sporteve, ku zhvillojnë përgaditjet dhe garat të gjitha klubet sportive lokale, përveç klubit të futbollit “Lepenci”, të cilët e shfrytëzojnë stadiumin “Besnik Begunca”.

Për të krijuar kushte sa më të mira për rininë janë planifikuar investime kapitale në ndërtimin e tereneve sportive, meremetimin e shtëpisë kulturës dhe monumenteve tjera kulturo-historike.



PRIORITETI 3 – Krijimi i komuniteteve të forta dhe aktive:

SHËNDETËSIA: Objektivi 1: Përmirësimi i shëndetit dhe mirëqenies së qytetarëve		
Veprimet:	Matësi ► Caku	Programi – Drejtoria përgjegjëse
1. <i>Sigurimi i numrit adekuat të mjekëve dhe paimëve në QKMF.</i> 2. <i>Blerja e një veture të re për bartjen e pacienteve me hemodializë dhe blerja e aparatit biokimik.</i>	Ofrimi i kujdesit shëndetësor nga stafi profesional në ndërtesa të standardeve të larta. Ulja e raportit pacient / doktor. Rritja e sigurisë së transportit të pacientëve-intervenim i shpejtë i autoambulancës.	Drejtoria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale.
3. <i>Renovimi dhe furnizimi me pajisje e objekteve të QMF-ve si dhe rindertimi i objektit të ri të QMF-së në</i>	Funksionalizimi i plotë dhe përmirësimi i shërbimeve shëndetësore nga QMF-të. Ofrimi i shërbimeve me afër qytetarëve.	Drejtoria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale.

Doganaj-Kaçanik. (Lokacion i ri).	Shkarkimi i nr. te pacientëve ne QKMF.	
SOCIALJA:		
Objektivi 2: Ofrimi i asistencës sociale për familjet me gjendje të rëndë ekonomike		
1. Zvogëlimi i numrit të njerëzve që marrin ndihma sociale	Ofrimi i trajnimeve të ndryshme për punësim dhe verifikimi i listave në vazhdimësi Ulja e shfrytëzuesëve të ndihmës sociale.	Drejtoria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale
2. Ndertimi i objekteve për banim social.	Krijimi dhe sigurimi i kushteve me te mira per jetesë i familjeve skamnore.	Drejtoria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale
ARSIMI:		
Objektivi 3: Rritja e Standardeve në arsim dhe e nivelit të arritjeve		
1. Rritja e standardeve në mësimdhënje dhe mësimnxënje	-Rritja e kualifikueshmërisë së mësimdhënësve. -Trajnimi i mësimdhënësve në fusha të ndryshme. -Trajnimi i drejtorëve në fushën e udhëheqjes arsimore. -Ngritja e rezultateve nga vlerësimet e jashtme. -Zvogëlimi i orëve të humbura nga nxënësit dhe mësimdhënësit. -Paisja e shkollave me mjete konkretizuese moderne. -Rritja e numrit te kabineteve të TI. -Ngritja e kapaciteteve të mësimdhënjes në fushën e TI.	Drejtoria e Arsimit
2. Gjithëpërfshirja dhe përkrahja e fëmijëve me nevoja të veçanta	Rritja e numrit të asistentëve për fëmijët me nevoja të veçanta Përkrahja dhe subvencionimi i shpenzimeve për fëmijët që shkollohen në qendrat burimore Trajnimi i mësimdhënësve mbështetës	Drejtoria e Arsimit


3. Siguria ne shkolla	Rritja e numrit të psikologëve dhe pedagogëve në shkolla Vendosja e kamerave të sigurisë në shkolla Në ShML angazhim të kompanive të sigurimit për siguri të ambienteve shkollore	Drejtoria e Arsimit
4. Renovimi i vazhdueshëm i objekteve shkollore dhe paisja me paimë dhe teknologji te avancuar.	Mirëmbajtja e hapsirave shkollore. Ndërtimi i hapsirave të reja shkollore dhe zgjerimi atyre agezistuese. Kompletimi i shkollave me salla të edukates fizike Paisja e shkollave me inventarë të nevojshëm.	Drejtoria e Arsimit
5. Përkrahja e studentëve të dalluar	Bursa për studentët e dalluar Përkrahje për praktikën profesionale dhe realizim të projekteve të ndryshme	Drejtoria e Arsimit
KULTURA, RINIA DHE SPORTI: Objektivi 4: Përmirësimi i kushteve për mbarëvajtjen e aktiviteteve kulturore-sportive.		
1. Përfundimi i ndërtimit të objekteve të reja si: "Ndërtimi i stadiumit të futbollit "Besnik Begunaca", Ndërtimi i Palestres sportive & përmirësimi i vazhdueshëm i objekteve tjera kulturore.	Ndërtimi dhe rregullimi i terreneve sportive. Shtimi i numrit të aktiviteteve sportive dhe kulturore. Përmirësimi i kushteve infrastrukturore për rinë, kulturë dhe sport. Shtimi i aktivizimit të rinisë në aktivitete kulturore-sportive dhe ulja e dukurive negative tek të rinjtë. Më shumë grupe të të rinjëve mund të ushtrorjnë aktivitetet e tyre në Shtëpinë e Kulturës	Drejtoria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit

	Shtim i numrit dhe aktivizim i klubeve sportive dhe shoqerive kulturore artistike .	
1. Subvencionimi i aktiviteteve sportive, kulturore dhe rinore	Rritja e interesimit të të rinjve për aktivitete kulturore dhe sportive	Drejtoria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit

Zhvillimi i një administrate më efikase, efektive dhe profesionale

Prioriteti i komunës së Kaçanikut është ngritja e cilësisë dhe shpejtësisë në shërbimet e ofruara nga administrata e komunës. Drejtoria e Administratës ofron shërbime të rëndësishme komunale si: gjendjen civile, arkivin, qendrën për shërbim me qytetarë (QSHQ), logjistikën, zyrën për barazi gjinore, zyrën e përkthimeve, etj.

Stafi ynë dhe ndërtesat tona janë të rëndësishme - ata krijojnë një përshtypje për Komunën tonë në sytë e publikut. Është e rëndësishme që publiku të ketë një mendim pozitiv për komunën. Ne presim që i gjithë stafi jonë të jetë i dobishëm, miqësor, efikas dhe profesional.



Prioritetet tona administrative janë ofrimi i shërbimeve efektive dhe efikase për të gjithë në të gjithë Komunën, si dhe zhvillimi i e-qeverisjes.

Ne kemi ofuar 5 Zyra të Regjistrimit Civil në komunë për të bërë qasjen për qytetarë më të lehtë dhe më të shpejtë; dhe një Regjistër digjital ofron shërbime online për njerëzit dhe bizneset. Të gjitha protokollet e stafit tonë janë online.

Ne planifikojmë të implementojmë përmirësime të mëtejshme në TIK për të lëvizur drejt një "zyrë pa letra", dhe të vazhdojmë me trajnimin e stafit.

PRIORITETI 4: Zhvillimi i një administrate më efikase, efektive, profesionale

Objektivi 1: Përmirësimi i shërbimeve të ofruara ndaj qytetarëve		
Veprimet:	Matësi ► Caku	Programi – Drejtoria përgjegjëse
1. <i>Rritja e përdorimit të TIK në kuadër të Administratës</i>	Implementimi i Planit të Veprimit për Përmirësimin e Shërbimeve në QSHQ	Drejtoria e Administratës së Përgjithshme
Objektivi 2: Infrastrukturë bashkëkohore për funksionimin e administratës		
2. <i>Përmirësimi i infrastrukturës së objekteve</i>	Renovimi i objektit të Administratës komunale, Ndërtimi i Parkingut Nëntokësor, Ndërtimi i Aneksit të Administratës komunale dhe krijimi i qasjes me të lehtë për të gjithë. Rritja e cilësisë gjatë zhvillimit të seancave. Shërbime të shpejta dhe cilësore sipas parimit "one-stop shop"	Drejtoria e Administratës së Përgjithshme

Një nga synimet e administratës komunale është arritja e efikasitetit në të gjitha nivelet. Institucionet publike janë përgjegjëse për të siguruar të mirat dhe shërbimet e nevojshme publike për qytetarët pa asnjë diskriminim. Prandaj, objektivat shumëdimensionale të administratës komunale kërkojnë që performanca jo

vetëm të jetë e kufizuar në ofrimin e shërbimeve, por gjithashtu të përfshijë elementin thelbësor të sigurimit të vlerave llogaridhëse për qytetarët.

Në kohën bashkëkohore, pikëpamjet e duhura se si duhet të funksionoj administrata komunale orientohen kryesisht në përparimin në teknologji që pritet të ketë ndikim të jashtëzakonshëm në evolucionin e ofrimit të shërbimeve si një fushë dinamike e së ardhmes.

Drejtoria e Administratës është tradicionalisht e angazhuar në arritjen e efikasitetit në punën e dikastereve të saj, me theks të veçantë në ofrimin e shërbimeve. Prandaj, efikasiteti gjen një vend të përhershëm në planin dhe programin qeverisjes lokale. Efikasiteti dhe efienca merr një vemendje të rëndësishme kur përpiqemi ta aplikojmë atë në një sistem që bazohet në shumë vlera, profesionalizëm e transparencë të zyrtarëve të angazhuar publik. Dimensioni i transparencës i jep një perspektivë unike efikasitetit në ofrimin e shërbimeve.

Për arritjen e këtij qëllimi, vazhdimisht duhet të vlerësojmë performancën. Matja e performancës gjithmonë ka të bëjë me misionin dhe aktivitetet e administratës, si dhe me mjedisin në të cilin ofron shërbime. Në fakt, matjet e këtij lloji shpiejnë gjithnjë në progres.

Siç u tha më lartë, Drejtoria e Administratës përkushtimin e saj e bazon në tri shtylla: efikasitet, performancë, transparencë. Këto mekanizma janë instaluar dhe vazhdojnë të përkrahen nëpërmjet investimeve kapitale në vazhdimësi. Investime këto kryesisht në teknologji, infrastrukturë të objektit dhe investime tjera të rëndësishme.

III. Korniza Fiskale Komunale

Korniza Afatmesme e Shpenzimeve (KASH) 2024-26) për nivelin komunal ofron udhëzimet për komunat për përgatitjet e buxhetit për 2024 dhe orientimet për 2025 dhe 2026, bazuar në prioritetet strategjike të Qeverisë në fushën e marrëdhënieve fiskale ndërqeveritare. Po ashtu, ky dokument përcakton shumat agregate të granteve qeveritare për financimin e komunave dhe nivelin e të hyrave vetanake të komunave për vitin fiskal 2024 si dhe parashikimin afatmesëm 2025-2026.

Parimet, kriteret dhe formulat të zbatuara për ndarjen e granteve qeveritare për financimin e komunave për vitin 2022 bazohen në Ligjin për Financat e Pushtetit Lokal (LFPL) dhe Tabelën 1 të projeksioneve makro-fiskale të përgatitur nga Ministria e Financave siç specifikohet në Ligjin për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (LMFPP).

Procesi i buxhetit komunal merr parasysh këto aspekte:

- Buxhetimi në nivel të programeve dhe nën-programeve, në përputhje me strukturën ekzistuese të planit kontabël,
- Përmirësimet në qasjen e buxhetimit të orientuar drejt rezultateve dhe performancës,
- Zbatimi i konceptit shumëvjeçar mbi planifikimin e projekteve kapitale si dhe,
- Prezantimi tabelar mbi burimet e financimit dhe strukturën e shpenzimeve sipas kategorive ekonomike për vitin e 2024 dhe projeksionet për vitet 2025 – 2026.

Buxheti i projekteve kapitale shumëvjeçare përfshinë integrimin e të dhënave të planifikuara nga komuna në sistemin e Projekteve të Investimeve publike (PIP) dhe buxhetimin në bazë të performancës.

Korniza Afatmesme Buxhetore e Komunës së Kaçanikut është hartuar në përputhje me kornizën makroekonomike të Kosovës dhe sipas dokumentit Korniza Afatmesme të Shpenzimeve (KASH-Qarkorja buxhetore) 2024-2026 të përpiluar nga Qeveria e Kosovës.

Komponentet e politikës makroekonomike sic janë Bruto Produkti Vendor, inflacioni dhe demografia duhet konsideruar dhe marrë parasyshë. Korniza Afatmesme e Shpenzimeve 2024-2026 e Qeverisë së Kosovës bazuar në të dhënat historike si dhe në zhvillimet e fundit ekonomike dhe sociale të vendit.

4.1. Burimet e Financimit Komunal për vitet 2024-2026

Buxheti i Komunës përbëhet nga dy burime kryesore:

- Grantet qeveritare (GP, GSA, GSH) dhe
- Të hyrat vetanake komunale .

3.1.1 GRANTI I PËRGJITHSHËM (GP):

- Mundëson një shkallë të arsyeshme të qëndrueshmërisë buxhetore komunale,
- Është mekanizëm për sigurimin e barazisë ndërmjet komunave si dhe
- Mundëson alokim adekuat të burimeve për komunitetet pakicë në komunat përkatëse.

Bazuar nga të dhënat e Departamentit të Politikave Ekonomike dhe Fiskale të Ministrisë së Financave Punes dhe Transfereve, në përputhje me LFPL, Granti i Përgjithshëm për komuna për vitin 2024 është aprovuar nga Komisioni i Granteve në shumë prej 284.68 milion euro. Kjo ndarje bazohet në formulën e përcaktuar në nenin 24 të LFPL, ku 10% e të hyrave totale të buxhetuara të Qeverisë qendrore iu ndahen komunave, duke përjashtuar të hyrat vetanake të nivelit qendror, mbështetjen buxhetore dhe grantet, të hyrat nga tatimi në pronë, të hyrat nga dividendat, grantet e përcaktuara të donatorëve si dhe taksat dhe ngarkesat dhe të tjera nga qeveria lokale.

Granti i përgjithshëm - me qëllim të nivelizimit të kapacitetit të ulët të të hyrave vetanake të komunave më të vogla, bazuar në LFPL, secila komunë do të pranojë për çdo vit një shumë të përgjithshme fikse (paushalle) prej 140,000 euro, duke zbritur nga 1 euro për kokë banori ose 0 euro për komunat me popullsi të barabartë ose më të madhe se 140,000 banorë. Pas kësaj, shpërndarja e bërë nëpër komuna bazohet në formulën për alokimin e grantit të përgjithshëm në komuna sipas LFPL: (i) numri i popullsisë llogaritet me tetëdhjetë e nëntë përqind (89%); (ii) përmasat gjeografike të komunës me gjashtë përqind (6%); (iii) numri i popullsisë pakicë në komunë (3%); (iv) komunat ku shumica e popullsisë së të cilave përbëhet nga pakicat kombëtare me dy përqind (2%);

Financimi i shërbimeve sociale si kompetencë e transferuar nga MPMS në komuna përfshihet në kuadër të grantit të përgjithshëm të komunës. Të punësuarit në administratën e Drejtorive Komunale për Arsim para universitar dhe Shëndetësi primare financohen nga granti i përgjithshëm në komuna. Po ashtu, nga granti i përgjithshëm do të plotësohen edhe grantet specifike për arsim dhe shëndetësi kur është e nevojshme.

- ☐ **Buxheti i përgjithshëm i planifikuar i Komunës së Kaçanikut për vitin fiskal 2024, i përcaktuar sipas Qarkores Buxhetore nr.2024/01 me kufijtë fillestarë buxhetor në shumë prej: 11,958,983.00€.**

▪ **Burimet e financimit të Buxhetit Komunal vijnë nga:**

- | | |
|------------------------------------|-------------------|
| 1. Granti i Përgjithshëm | 5,130,643,00€ |
| 2. Granti Specifik i Arsimit: | 4,395,331.00€ |
| 3. Granti Specifik për Shëndetësi: | 1,508,809.00€ dhe |
| 4. Të hyrat vetanake | 924,200.00€ |

- **Total Financimi Qeveritar: 11,034,783.00€ apo 92.27 % e përbërjes së buxhetit total dhe**
▪ **Të hyrat vetanake që për vitin 2024 planifikohen të jenë: 924,200.00€ apo 7.73% e total buxhetit.**

☐ **KRAHASIMI ME VITIN 2023:**

- Sipas burimeve të financimit Grantet Qeveritare kanë shënuar rritje nga 9,812,111.00€ sa ishte në v.2023 në 11,034,783.00€ për vitin 2024 apo në shumë totale prej 1,222,672.00 euro, vlera e rritjes së buxhetit apo 12.46%.

Granti specifik për Arsim parauniversitar për vitin 2024-2026

Granti Specifik për Arsim para universitar sipas LFPL, bazohet në sistem të hapur të financimit, duke marrë parasysh kriteret në formulën e arsimit para universitar të MASHTI për vitin 2024-2026.

Formula trajton nivelin e arsimit para fillor, fillor dhe të mesëm, duke marrë për bazë këto kriterë:

- Numri i nxënësve të regjistruar për vitin 2022/2023;
- Raporti nxënës-mësimdhënës për arsimin fillor dhe të mesëm për nxënësit shumicë 1:21.3 (bazuar në Udhëzimin administrativ nr. 22/2013 të MASHTI-it);
- Raporti nxënës-mësimdhënës për arsimin fillor dhe të mesëm për nxënësit pakicë 1:14.2;
- Raporti nxënës-mësimdhënës për arsimin parashkollor 1:12;
- Raporti nxënës-mësimdhënës për arsimin e mesëm profesional për nxënësit shumicë 1:17.2, dhe për nxënësit pakicë 1:11.5;
- Raporti nxënës-mësimdhënës për zonat malore 1:14.2;
- Kalkulimi për stafin mësimdhënës të gjuhës angleze për klasën I dhe II;
- Kalkulimi për stafin teknik administrativ për 630 nxënës 1 staf në arsimin para fillor dhe fillor;
- Kalkulimi për stafin teknik administrativ për 470 nxënës 1 staf në arsimin e mesëm

- j) Kalkulimi për stafin ndihmës për 170 nxënës 1 staf (pastrues) si dhe 1 staf për shkollë (roje);
k) Kalkulimi i pagave dhe shtesave është bazuar në Ligjin për Paga në sektorin Publik;
l) Shërbimi profesional Pedagogjik/Psikologjik;
m) Koordinatorët e cilësisë;
n) Mallrat dhe shërbimet janë kalkuluar sipas kriterit për nxënës (23 euro për nxënës shumicë dhe 25 euro për nxënës pakicë) dhe për shkollë (1,500 euro për shkollë parafillore dhe fillore dhe 3,250 euro për shkollë të mesme);
o) Kapitalet janë kalkuluar sipas kriterit 7 euro për nxënës;
p) Asistent për fëmijë me nevoja të veçanta;
q) Praktika profesionale;
r) Kosto e pagesës së procedurave për validim dhe akreditim për shkollat e mesme të larta profesionale (8 Shkolla);
s) Këshilltarë të karrierës me bazë në shkollë klasa 6 deri 9;
t) Specialist të IT-së.
Sipas MASHTI-të është raportuar numri për 9,859 nxënës më pak në arsim para universitar krahasuar me vitin paraprak.

GRANTI I SPECIFIK PËR SHËNDETËSI (GSSH):

Për Komunën e Kaçanikut gjithsej shuma e ndarë e grantit specifik për Shëndetësi është në lartësi prej 1,508,809.00€ per vitin 2024.

PROJEKSIONET BUXHETORE PËR VITIN 2024-2026:

Projeksionet e të hyrave vetanake komunale për vitin 2024, janë në shumë prej 924,200.00 euro. Në këto projeksione janë marrë parasyshë parashikimet e komunës mbi të hyrat në pronën e paluajtshme (tatimi ne prone dhe tatimi ne tokë) sipas faturimit te tatimit ne prone dhe trendit te realizimit të të hyrave jo tatimore gjate tri viteve te fundit, duke perjashtuar nga këto projeksione te hyrat nga gjobat n etrafik dhe te hyrat nga gjykatat.

FINANCIMI I BUXHETIT PER VITET 2024-2026						
BURIMET E FINANCIMIT	VITI: 2023	VITI: 2024	VITI: 2025	VITI: 2026	KRAHASIMI: 2024/2023	Rritja ne%
GRANTI I PËRGJITHSHËM	4,603,825.00	5,130,643.00	5,511,286.00	5,868,939.00	526,818.00	
GRANTI S. PËR ARSIM	3,734,102.00	4,395,331.00	4,527,191.28	4,663,007.00	661,229.00	
GRANTI S. PËR SHËNDETËSI	1,474,184.00	1,508,809.00	1,584,249.00	1,663,462.00	34,625.00	
TOTAL FINANCIMI QEVERITAR	9,812,111.00	11,034,783.00	11,622,726.28	12,195,408.00	1,222,672.00	12.46
H V K :	862,578.00	924,200.00	957,045.00	1,000,530.00	61,622.00	
TOTAL BUXHETI:	10,674,689.00	11,958,983.00	12,579,771.28	13,195,938.00	1,284,294.00	12.03

□ TË DALURAT BUXHETORE PËR VITET 2024 – 2026

Tendenca e shpenzimeve komunale dhe parashikimi i tyre afat-mesëm 2024-2026

Përmes Qarkores Buxhetore komunale 2024/01 komunat do të kenë edhe në të ardhmen fleksibilitet në shpërndarjen e të hyrave vetanake komunale në strukturën e shpenzimeve sipas kategorive ekonomike për vitin 2022, duke përfshirë kategorinë Paga dhe Mëdijet. Si rezultat Komuna e Kaçanikut prezanton këtë ndarje të shpenzimeve në mes të kategorive të lejuara buxhetore për periudhën afatmesme 2022-2024:

NDARJA E KUFIJVE BUXHETOR PËR VITIN 2024 SIPAS SEKTOREVE- DREJTORIVE KOMUNALE:						
SEKTORI - DREJTORIA:	PAGA DHE MEDITJE	MALLRA DHE SHERBIME	SHPENZIME KOMUNALE	SUBVENCIONE DHE TRANSFERE	INVESTIME KAPITALE	TOTALI
ZYRA E KRYETARIT	247,733.53	25,000.00	-	60,000.00	-	332,733.53
ADMINISTRATA E PERGJITHSHME & Q.Gjinore	160,985.73	85,000.00	15,000.00	-	412,000.00	672,985.73
KUVENDI KOMUNAL	221,755.26	5,000.00	-	-	-	226,755.26
ZHVILLIMI EKONOMIK	23,954.42	5,000.00	-	40,000.00	335,000.00	403,954.42
BUXHETIMI - FINANCAT	80,601.27	10,000.00	-	-	250,000.00	340,601.27
SH.PUBLIKE, MBROJTJA CIVILE DHE EMERGJENCA	245,600.91	310,000.00	80,000.00	60,000.00	496,313.00	1,191,913.91
ZYRA E KOMUNITETEVE	10,439.86	1,000.00	-	-	-	11,439.86
BUJQESIA, PYLLTARIA DHE ZHVILLIMI RURAL	104,111.60	10,000.00	-	100,000.00	50,000.00	264,111.60
URBANIZMI - PLANIFIKIMI	116,206.76	80,000.00	-	-	1,012,279.00	1,208,485.76
AD.SHEND. DHE SHERBIME I SOCIALE	82,196.43	5,000.00	5,000.00	10,000.00	5,000.00	107,196.43
SHERBIMET SHENDETESORE PRIMARE	1,138,296.07	270,513.00	50,000.00	-	50,000.00	1,508,809.07
KULTURA, RINIA, SPORTET	131,628.93	130,000.00	15,000.00	70,000.00	135,000.00	481,628.93
ARSIMI DHE SHKENCA	4,208,367.24	385,000.00	50,000.00	50,000.00	515,000.00	5,208,367.24
TOTAL BUXHETI:	6,771,878.00	1,321,513.00	215,000.00	390,000.00	3,260,592.00	11,958,983.00

NDARJA E KUFIJVE BUXHETOR PËR VITIN 2025 SIPAS SEKTOREVE- DREJTORIVE KOMUNALE:						
SEKTORI - DREJTORIA:	PAGA DHE MEDITJE	MALLRA DHE SHERBIME	SHPENZIME KOMUNALE	SUBVENCIONE DHE TRANSFERE	INVESTIME KAPITALE	TOTALI
ZYRA E KRYETARIT	252,733.88	25,000.00	-	60,000.00	-	337,733.88
ADMINISTRATA E PERGJITHSHME & Q.Gjinore	165,985.73	85,000.00	20,000.00	-	107,000.00	377,985.73
KUVENDI KOMUNAL	226,755.26	5,000.00	-	-	-	231,755.26
ZHVILLIMI EKONOMIK	23,954.42	5,000.00	-	40,000.00	100,000.00	168,954.42
BUXHETIMI - FINANCAT	85,601.27	10,000.00	-	-	500,000.00	595,601.27
SH.PUBLIKE, MBROJTJA CIVILE DHE EMERGJENCA	250,600.91	310,000.00	95,000.00	80,000.00	625,000.00	1,360,600.91
ZYRA E KOMUNITETEVE	10,439.86	1,000.00	-	-	-	11,439.86
BUJQESIA, PYLLTARIA DHE ZHVILLIMI RURAL	109,111.60	10,000.00	-	100,000.00	60,000.00	279,111.60
URBANIZMI - PLANIFIKIMI URBAN	116,206.76	80,000.00	-	-	1,193,940.00	1,390,146.76
AD.SHËND. DHE SHERBIMET SOCIALE	82,196.43	5,000.00	5,000.00	10,000.00	5,000.00	107,196.43
SHERBIMET SHENDETESORE PRIMARE	1,188,296.07	295,952.93	50,000.00	-	50,000.00	1,584,249.00
KULTURA, RINIA, SPORTET	131,628.93	130,000.00	15,000.00	80,000.00	85,000.00	441,628.93
ARSIMI DHE SHKENCA	4,358,367.24	485,000.00	50,000.00	100,000.00	700,000.00	5,693,367.24
TOTAL BUXHETI:	7,001,878.35	1,446,952.93	235,000.00	470,000.00	3,425,940.00	12,579,771.28

NDARJA E KUFIJVE BUXHETOR PËR VITIN 2026 SIPAS SEKTOREVE- DREJTORIVE KOMUNALE:						
SEKTORI - DREJTORIA:	PAGA DHE MEDITJE	MALLRA DHE SHERBIME	SHPENZIME KOMUNALE	SUBVENCIONE DHE TRANSFERE	INVESTIME KAPITALE	TOTALI
ZYRA E KRYETARIT	262,733.82	30,000.00	-	60,000.00	-	352,733.82
ADMINISTRATA E PERGJITHSHME & Q.Gjinore	180,985.73	90,000.00	20,000.00	-	202,000.00	492,985.73
KUVENDI KOMUNAL	231,755.26	10,000.00	-	-	-	241,755.26
ZHVILLIMI EKONOMIK	24,074.19	10,000.00	-	50,000.00	150,000.00	234,074.19
BUXHETIMI - FINANCAT	86,029.27	10,000.00	-	-	450,000.00	546,029.27
SH.PUBLIKE, MBROJTJA CIVILE DHE EMERGJENCA	265,600.91	360,000.00	100,000.00	80,000.00	730,000.00	1,535,600.91
ZYRA E KOMUNITETEVE	20,439.86	1,000.00	-	-	-	21,439.86
BUJQESIA, PYLLTARIA DHE ZHVILLIMI RURAL	134,111.60	10,000.00	-	120,000.00	50,000.00	314,111.60
URBANIZMI - PLANIFIKIMI URBAN	141,206.76	100,000.00	-	-	1,550,346.00	1,791,552.76
AD.SHËND. DHE SHERBIMET SOCIALE	92,196.43	10,000.00	10,000.00	10,000.00	-	122,196.43
SHERBIMET SHENDETESORE PRIMARE	1,238,296.07	325,165.93	50,000.00	-	50,000.00	1,663,462.00
KULTURA, RINIA, SPORTET	141,628.93	155,000.00	25,000.00	100,000.00	35,000.00	456,628.93
ARSIMI DHE SHKENCA	4,408,367.24	460,000.00	75,000.00	80,000.00	400,000.00	5,423,367.24
TOTAL BUXHETI:	7,227,426.07	1,571,165.93	280,000.00	500,000.00	3,617,346.00	13,195,938.00

Kategoria Ekonomike – Investimet Kapitale - e prezantuar në detaje më poshtë paraqet një komponentë të rëndësishme të buxhetit të komunës e cila ndonëse nuk përfaqëson pjesën më të madhe të shpenzimeve të përgjithshme buxhetore, mbetet me rëndësi të posaqme në aspektin e planifikimit, për Komunën e Kaçanikut. Kjo kategori e shpenzimeve në kuadër të shpenzimeve të rregullta buxhetore, ka potencialin më të madh për të nxitur rritjen ekonomike. Andaj, kjo kategori e shpenzimeve, edhe gjatë periudhës së ardhshme afatmesme, do të vazhdojë të jetë në funksion të krijimit të ambientit më të favorshëm për ngritje të pjesëmarrjes së sektorit privat, dhe qytetarëve përmes përmirësimit të vazhdueshëm të infrastrukturës. Përderisa ndikimi i këtyre investimeve në punësim dhe konsum është relativisht i shpejtë, ndikim i plotë i tyre në ekonomi do të mund të realizohet vetëm në periudhën afatmesme. Në këtë kontekst përmirësimi i infrastrukturës do të pozicionojë ekonominë e Komunës së Kaçanikut në një rrugë të rritjes më të shpejtë dhe të qëndrueshme ekonomike në një periudhë afatgjatë.

Tab.4.2. Propozim Projektet kapitale 2023 -2026						
Nr.	Emertimi i projekteve:	Kodi i Projektit	Buxheti 2024	Vlerësimi 2025	Vlerësimi 2026	Total 2024-2026
	TOTALI :		3,260,592	3,425,940	3,617,346	10,303,878
	ADMINISTRATA KOMUNALE		2,695,592	2,675,940	3,167,346	8,538,878
I	Administrata dhe Personeli		412,000	107,000	202,000	721,000
1	Ndërtimi i Aneksit të objektit të Administratës Komunale	50993	5,000	5,000	200,000	210,000
2	Furnizimi me Moblije dhe Pajime		2,000	2,000	2,000	6,000
3	Rregullimi i sistemit të ngrohjes qendrore të objektit të Administratës Komunale	52636	5,000	100,000	-	105,000
4	Ndërtimi i parkingut nentokësorë për Administratën komunale	50995	400,000	-	-	400,000
II.	Buxhet dhe Financa		250,000	500,000	450,000	1,200,000
5	Mjetet për shpronësim-të specifikuara		50,000	150,000	150,000	350,000
6	Mjetet për bashkëfinancim të projekteve	86245	200,000	350,000	300,000	850,000
III.	Shërbimet Publike, Mbrojtja Civile, Emergjencia		496,313	625,000	730,000	1,851,313
7	Ndërtimi i fabrikës për trajtimin e ujit të pijes në Sepetin	52699	6,313	-	-	6,313
8	Ndërtimi i trotuarit në rrugën regjionale Ahmet Kaçiku segmenti Restaurant Natyra-Fushë e Pajtit	52705	5,000	-	-	5,000
9	Ndërtimi dhe asfaltimi i rrugës së fshatrave Llanishtë - Nikoc - Kërbliq - Drenogllavë	43987	5,000	-	-	5,000
10	Rregullimi dhe asfaltimi i rrugëve ndërkomunale (segmenti rrugor Semajë-Gaçkë	48243	5,000	-	-	5,000
11	Asfaltimi i i trotuarit në rrugën Bob Doganaj	46564	5,000	-	-	5,000
12	Asfaltimi i rrugës Kaçanik i Vjeter - Beorace	52818	5,000	-	-	5,000
13	Rregullimi i rrugës Bob-Kulla Hasanit	46554	100,000	50,000	-	150,000
14	Ndërtimi dhe asfaltimi I pjesës së mbetur të rrugës Ismail Raka, segmenti prej Shtepisë së Kulturës deri te Xhamia e Dëshmorëve	51628	5,000	5,000	5,000	15,000
15	Ndërtimi i kanalizimeve fekale dhe atmosferike	52879	80,000	50,000	50,000	180,000
16	Ndërtimi dhe rregullimi i rrjeteve të ujësjellësve	52883	75,000	60,000	50,000	185,000
17	Rregullimi i ndriçimit publik	52809	50,000	40,000	40,000	130,000
18	Ndërtimi i impiantit për trajtimin e ujrave të zeza në dalje të pjesës jugore të zonës urbane të qytetit	48261	5,000	-	-	5,000
19	Ndërtimi dhe asfaltimi i rrugës Idriz Seferi	51631	100,000	-	-	100,000
20	Ndërtimi i objektit për Zjarrefikësit - Kaçanik	50170	5,000	-	-	5,000

21	Ndërtimi dhe rregullimi i hapësirave publike	52820	20,000	20,000	30,000	70,000
22	Ndërtimi i kolektorit kryesorë për trajtimin e ujërave të zeza-Nerodime	51045	5,000	5,000	5,000	15,000
23	Ndërtimi i stazës për këmbësorë dhe shtegut për biciklista përgjatë lumit Lepenc Kaçanik-H.Elezit	51013	5,000	-	-	5,000
24	Rehabilitimi i rrugës "Adem Jashari" Stagovë	I ri	5,000	-	-	5,000
25	Asfaltimi i rrugës "Hamëz Jashari" segmenti Silkapor - Rakaj	I ri	5,000	-	-	5,000
26	Projekte të ndryshme infrastrukturore	I ri	-	395,000	550,000	945,000
27	Ndërtimi i garazhës për kamiona për KRM "Pastertia" Kaçanik	I ri	5,000	-	-	5,000
IV.	Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillimi Rural		50,000	60,000	50,000	160,000
28	Ndërtimi i kanaleve të ujitjes në fshatrat Biqec,Kovaqec dhe Dubravë	52849	50,000	60,000	50,000	160,000
V.	Zhvillimi Ekonomik		335,000	100,000	150,000	585,000
29	Ndërtimi i shkalleve të Guri Shpuar	52893	150,000	-	-	150,000
30	Ndërtimi i parkut rekreativ në zonën turistike Shtrazë	52899	50,000	-	-	50,000
31	Ndërtimi i trotuarit, shtegut për çiklizëm dhe ndriqimit publik në rrugën Murat Lika Shtrazë	51648	85,000	-	-	85,000
32	Ndërtimi i objektit Kullë mbi Lumin Lepenc	I ri	5,000	-	-	5,000
33	Ndërtimi i rrugës në Luboten	I ri	5,000	-	-	5,000
34	Projektet zhvillimore të turizmit	I ri	-	100,000	150,000	250,000
35	Ndërtimi i shtegut të Lirisë	I ri	40,000	-	-	40,000
VI.	Planifikim Urban dhe Mjedis		1,012,279	1,193,940	1,550,346	3,756,565
36	Vazhdimi i punëve në hapsirën publike të Qarshia e Qytetit	51213	20,000	-	-	20,000
37	Ndërtimi i shtretërve të lumenjëve dhe përrockave	53133	150,000	150,000	250,000	550,000
38	Ndërtimi i urës mbi lumin Nerodime dhe mbi hekurudhë	53142	5,000	5,000	-	10,000
39	Rregullimi dhe asfaltimi i rrugëve në pjesën urbane-Kaçanik	53187	282,279	300,000	350,000	932,279
40	Rregullimi dhe asfaltimi i rrugëve në pjesën rurale-Kaçanik	53198	450,000	733,940	945,346	2,129,286
41	Rregullimi dhe asfaltimi i rrugës që lidhë vendbanimet:Gërlicë-K.Vjetër-Stagovë-Runjevë	48413	5,000	5,000	5,000	15,000
42	Ndërtimi i urave mbi lumin Lepenc	53279	100,000	-	-	100,000
VII.	MIRËQENJA SOCIALE		5,000	5,000	-	10,000
43	Ndërtimi i objektit të QPS-ës në Kaçanik	52979	5,000	5,000	-	10,000
VIII.	SHËNDETËSIA		50,000	50,000	50,000	150,000
44	Investime në Shëndetësi		50,000	50,000	50,000	150,000

XIX.	KULTURË, RINI DHE SPORT		135,000	85,000	35,000	255,000
46	Rregullimi i varrezave të Dëshmorëve dhe Veteranëve të Uçk-së	45087	30,000	30,000	30,000	90,000
46	Rregullimi i tereneve sportive	52208	100,000	50,000		150,000
47	Ndërtimi i stadiumit të qytetit "Besnik Begunca"	45064	5,000	5,000	5,000	15,000
X.	ARSIMI FILLORE		365,000	600,000	400,000	1,365,000
48	Ndërtimi i Qerdhes së fëmijëve në Kaçanik të Vjetër	52990	5,000	-	-	5,000
49	Ndërtimi i Qerdhes së fëmijëve në Fshatin Rekë	I ri	5,000	-	-	5,000
50	Ndërtimi i sallës së Edukatës Fizike në SHFMU "Jusuf Gërvalla"	53275	100,000	-	-	100,000
51	Ndërtimi i sallës së Edukatës Fizike në SHFMU "Idriz Seferi" në fshatin Bob	I ri	200,000	100,000	-	300,000
52	Ndërtimi i sallës së Edukatës Fizike në SHFMU "Kadri Zeka" Dubravë	I ri	-	200,000	100,000	300,000
53	Ndërtimi i SHFMU "Emin Duraku" Kaçanik	50211	5,000	250,000	250,000	505,000
54	Furnizim me tabela digjitale për shkollat fillore dhe të mesme	53229	20,000	20,000	20,000	60,000
55	Furnizimi me mobilje dhe pajime të shkollave	88649	30,000	30,000	30,000	90,000
	ARSIMI I MESE		150,000	100,000	-	250,000
56	Ndërtimi i aneksit të IAAP-Feriz Guri dhe Vëllezërit Çaka	I ri	150,000	100,000	-	250,000



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Kaçanikut
Opština Kacanik
Municipal Kacanik

Zyra e Kryetarit

01 Nr. *104/02-14135* /23
Kaçanik; 13.06.2023

PËR/ZA/TO:	ZYREN E KUVENDIT KOMUNAL – KRYESUESIT Z. KEMAJL MËRSELI
NGA/OD/FROM:	Besim Ilazi – Kryetar Komune-ZKA
PËRMES:	
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Dorëzimi i Raportit të Auditimit për Pasqyrat Vjetore Financiare të Komunës së Kaçanikut për vitin e përfunduar 2022


I Nderuar Kryesues i Kuvendit,

Bashkëngjitur me këtë shkresë po iu dergojmë Raportin e Auditimit të Pasqyrave Vjetore Financiare 'PVF' Komunës së Kaçanikut për vitin 2022 për shqyrtim dhe diskutim në seancën e ardhshme e cila do të zhvillohet nga Asambleja Komunale.

Me respekt;



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Zyra Kombëtare e Auditimit
Nacionalna Kancelarija Revizije
National Audit Office

RAPORTI I AUDITIMIT PËR PASQYRAT FINANCIARE VJETORE TË KOMUNËS SË KAÇANIKUT PËR VITIN 2022

Raporti i nënshkruar nga
Vlora Spanca,
Auditore e Përgjithshme

Prishtinë, maj 2023

PËRMBAJTJA E RAPORTIT

- 1 Opinioni i Auditimit
- 2 Gjetjet dhe rekomandimet
- 3 Informacion i përmbledhur për planifikimin dhe realizimin e buxhetit
- 4 Progresi në zbatimin e rekomandimeve

Shtojca I: Letër konfirmimi

Shtojca II: Shpjegim lidhur me llojet e të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA dhe pjesëve të tjera të Raportit të Auditimit

1 Opinioni i Auditimit

Ne kemi përfunduar auditimin e pasqyrave financiare të Komunës së Kaçanikut për vitin e përfunduar më 31 Dhjetor 2022, në përputhje me Ligjin për Zyrën Kombëtare të Auditimit të Republikës së Kosovës dhe Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Auditimi është kryer për të na mundësuar të shprehim opinionin për pasqyrat financiare dhe konkluzionin për pajtueshmërinë me autoritetet.¹

Opinion i pamodifikuar për pasqyrat financiare vjetore

Ne i kemi audituar pasqyrat financiare vjetore të Komunës së Kaçanikut (KK), të cilat përmbajnë pasqyrën e pranimeve dhe pagesave në para të gatshme, raportin e ekzekutimit të buxhetit si dhe shënimet shpjeguese për pasqyrat financiare, përfshirë përmbledhjen e politikave të rëndësishme të kontabilitetit dhe raportet tjera², për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2022.

Sipas opinionit tonë, Pasqyrat Financiare Vjetore të Komunës së Kaçanikut, prezantojnë një pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit për Sektorin Publik, sipas kontabilitetit të bazuar në para të gatshme.

Baza për opinion

Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa e raportit 'Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare'. Në përputhje me ONISA-P-10, SNISA 130, Kodin e Etikës së ZKA-së, si dhe kërkesat tjera relevante për auditimin e PFV-ve të organizatave buxhetore, ZKA është e pavarur nga subjekti i auditimit. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për opinion.

Konkluzion për pajtueshmërinë

Ne kemi audituar nëse proceset dhe transaksionet përcjellëse janë në pajtueshmëri me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm për subjektin e audituar në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare.

Sipas mendimit tonë, përveç ndikimeve të çështjeve të përshkruara në seksionin Baza për Konkluzion të pajtueshmërisë, transaksionet e kryera në procesin e ekzekutimit të buxhetit Komunës së Kaçanikut kanë qenë, në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm për subjektin e audituar në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare.

Baza për konkluzion

- A1 Lejimi i pagesës si paradhënie prej 40,676€, edhe pse nuk ishte paraparë me kontratë dhe në dosjen e tenderit tek kushtet e veçanta të kontratës.
- A2 Tejkallim i sasive në pozicionet e kontraktuara te kontrata " Ndërtimi i kanalizimeve fekale dhe atmosferike".
- A3 Vonesa në deponimin e mjeteve monetare të mbledhura në llogarinë bankare.
- B1 Komuna kishte lëshuar dokumentacionin e tenderit pa hartuar projektin ekzekutues.
- A4 Komuna nuk i kishte ngarkuar dokumentet që ndërlidhen me kërkesat e përshtatshmërisë në platformën elektronike të prokurimit publik.
- A5 Çertifikimi i pagesës është bërë në mungesë të raportit të menaxherit të projektit.
- A6 Komuna në vitin 2022, menaxhimin e kontratave nuk e kishte përgatitur dhe mbajtur përmes sistemit elektronik të prokurimit.
- A7 Llogaritë e arkëtueshme të prezantuar në Raportin Vjetor Financiar (RVF) ishin mbivlerësuar për 22,631€.
- B2 Vetura në vlerë 24,850€, ishte regjistruar në klasën e gabuar.

Më gjerësisht shih nënkapitullin 2.1 Çështjet që ndikojnë në konkluzionin e pajtueshmërisë

Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa 'Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare'. Në përputhje me ONISA-P-10, SNISA 130, Kodin e Etikës së ZKA-së, si dhe kërkesat e tjera relevante për auditimin e PFV-ve të organizatave buxhetore, ZKA-ja është e pavarur nga subjekti i auditimit. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për konkluzion.

Përgjegjësitë e Menaxhmentit dhe të organeve drejtuese/qeverisëse për pasqyrat financiare vjetore

Kryetari i Komunës është përgjegjës për përgatitjen dhe prezantimin e drejtë të Pasqyrave Financiare sipas Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit në Sektorin Publik - Raportimi Financiar bazuar në Kontabilitetin e Parasë së Gatshme. Po ashtu, Kryetari i Komunës është përgjegjës edhe për vendosjen e kontroleve të brendshme, të cilat i përcakton si të nevojshme për të mundësuar përgatitjen e Pasqyrave Financiare, pa keq deklarime materiale të shkaktuara, qoftë nga mashtrimi apo gabimi. Kjo përfshinë përmbyshjen e kërkesave që burojnë nga Ligji nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë dhe Rregullorja nr. 01/2017 për Raportim Vjetor Financiar nga Organizata Buxhetore.

Kryetari i Komunës është përgjegjës për të siguruar mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Komunës së Kaçanikut.

Përgjegjësia e Menaxhmentit për Pajtueshmërinë

Menaxhmenti i Komunës së Kaçanikut është gjithashtu përgjegjës për përdorimin e burimeve financiare të Komunës së Kaçanikut në përputhje me Ligjin për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësinë dhe të gjitha rregullat dhe rregulloret e tjera të zbatueshme.³

Përgjegjësia e Auditorit të Përgjithshëm për auditimin e PFV-ve

Objektivat tona janë të ofrojmë siguri të arsyeshme nëse pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit dhe të hartojmë një raport të auditimit që përfshin opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është siguri e nivelit të lartë, por nuk është një garanci se një auditim i kryer në përputhje me SNISA-t do të zbulojë çdo keq-deklarim material që mund të ekzistojë. Keq-deklarimet mund të vijnë nga mashtrimi ose gabimi dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose si tërësi, në mënyrë të arsyeshme pritet të ndikojnë në vendimet ekonomike të përdoruesve të marra në bazë të këtyre pasqyrave financiare.

Objekti ynë është gjithashtu të shprehim një konkluzion të auditimit për pajtueshmërinë e autoriteteve përkatëse të Komunës së Kaçanikut me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare, lidhur me subjektin e audituar.

Si pjesë e auditimit në përputhje me Ligjin për ZKA dhe SNISA-të, ne ushtrojmë gjykim dhe skepticizëm profesional gjatë gjithë auditimit. Ne gjithashtu:

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e keq-deklarimit material të pasqyrave financiare, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, hartojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit që i përgjigjen atyre rreziqeve, dhe marrim dëshmi të auditimit që janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazën për opinion. Rreziku i mos zbulimit të një keq-deklarimi material që rezulton nga mashtrimi është më i lartë sesa për atë që rezulton nga gabimi, pasi mashtrimi mund të përfshijë manipulim, falsifikim, lëshime të qëllimshme, keq përfaqësime ose anashkalim të kontrolleve të brendshme.
- Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e mos-pajtueshmërisë me autoritetet, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, hartojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit që janë përgjegjëse ndaj atyre rreziqeve, dhe marrim dëshmi të auditimit që janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazën për konkluzionin tonë për pajtueshmërinë me autoritetet. Rreziku i mos zbulimit të një rasti të mos pajtueshmërisë me autoritetet që vjen nga mashtrimi është më i lartë sesa për atë që rezulton nga gabimi, pasi mashtrimi mund të përfshijë manipulim, falsifikim, lëshime të qëllimshme, keq përfaqësime ose anashkalim të kontrollit të brendshëm.
- Sigurohemi ta kuptojmë kontrollin e brendshëm relevant për auditimin, për t'i hartuar procedurat e auditimit që janë të përshtatshme, por jo me qëllim të shprehjes së një opinionimi mbi efektivitetin e kontrollit të brendshëm të Komunës së Kaçanikut.
- Vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave të kontabilitetit të përdorura dhe arsyeshmërinë e vlerësimeve të kontabilitetit dhe shpalosjet e ndërlidhura të bëra nga menaxhmenti.
- Vlerësojmë prezantimin e përgjithshëm, strukturën dhe përmbajtjen e pasqyrave financiare, përfshirë shpalosjet, për t'u siguruar se pasqyrat financiare paraqesin transaksionet dhe ngjarjet themelore në mënyrë të drejtë dhe të saktë.

Ndër të tjera, ne komunikojmë me menaxhmentin dhe ata që janë përgjegjës për qeverisjen edhe në lidhje me fushëveprimin dhe kohën e planifikuar të auditimit dhe gjetjet e rëndësishme të auditimit, përfshirë ndonjë mangësi domethënëse në kontrollin e brendshëm që ne e identifikojmë gjatë auditimit.

Nga çështjet e komunikuara me menaxhmentin, ne përcaktojmë ato çështje që ishin më të rëndësishme në auditimin e Pasqyrave Financiare të periudhës aktuale dhe që cilësohen si çështje kyçe të auditimit. Raporti i auditimit publikohet në ueb faqen e ZKA-së, me përjashtim të informacioneve që klasifikohen si senzitive apo për shkak të ndalesave të tjera ligjore e administrative, në pajtim me legjislacionin në fuqi.

2 Gjetjet dhe rekomandimet⁴

Gjatë auditimit, ne kemi vërejtur fusha ku nevojiten përmirësime të mundshme, rreth menaxhimit financiar dhe kontrollit. Dobësi evidente janë vërejtur në fusha të rëndësishme financiare si: mungesë e projektit ekzekutiv, mosdeponim me kohë i mjeteve monetare të mbledhura nën 10€, mosraportim nga menaxherët e kontratave, mangës në lidhje me përdorimin e e-platfomës së prokurimit publik, dobësi në regjistrimin e pasurive, vonesa në inkasmin e llogarive të arkëtueshmëve.

Gjetjet dhe rekomandime kanë për qëllim të përmirësojnë informacionin financiar të paraqitur në Raportin Vjetor Financiar, duke përfshirë shpalosjet në formë të shënimeve shpjeguese dhe të përmirësojnë kontrollet e brendshme lidhur me raportimin financiar dhe pajtueshmërinë me autoritetet në lidhje me menaxhimin e fondeve të sektorit publik.

Ne do t'i përcjellim (shqyrtojmë) këto rekomandime gjatë auditimit të vitit të ardhshëm.

Ky raport ka rezultuar me 10 rekomandime, prej tyre tetë (8) janë rekomandime të reja dhe dy (2) të përsëritura.

Derisa për statusin e rekomandimeve të vitit paraprak dhe nivelin e zbatimit të tyre, shih kapitullin 4.

2.1 Çështjet që ndikojnë në konkluzionin e pajtueshmërisë

Çështja A1 - Pagesa e avansit prej 10% të vlerës së kontratës për investime kapitale pa u paraparë në kontratë dhe me kushte të veçanta

Gjetja Neni 13 i Ligjit nr. 08/I-066 mbi Ndarjet Buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2022 parasheh se "Organizatrat buxhetore mund të iu paguajnë paradhëniesve për projektet kapitale dhe për mallra dhe shërbime deri në 15% të vlerës së kontratës. Pagesa e tillë e paradhënies mund të bëhet vetëm në bazë të kontratës së lidhur në mënyrë ligjore, me vlerë më të lartë se dhjetë mijë euro (10,000 €), e cila është arritur në përputhje me Ligjin e Prokurimit Publik. Për pagesën e paradhënies për projektet kapitale, kontrata duhet të përmbajë garancionin e performancës dhe orarin qartazi të përcaktuar të pagesave, e cila njëkohësisht parasheh punën që duhet kryer para se të bëhet secila pagesë. Në muajin nëntor pagesa e paradhënies është e kufizuar deri në dhjetë përqind (10%) dhe në muajin dhjetor të vitit 2022 deri në pesë përqind (5%) të vlerës së kontratës".

Te projekti "Ndërtimi i objektit për banim social" në vlerë 406,747€, e lidhur më 19.10.2022, zyra e prokurimit në dosjen e tenderit të kushtet e veçanta të kontratës si dhe te kontrata e lidhur me operatorin ekonomik nuk e kishte paraparë pagesën në paradhënie. Menaxheri i projektit dhe operatorit ekonomik në muajin nëntor të vitit 2022 kishin kërkuar lejm të paradhënies prej 10% të vlerës së kontratës, me q'rast Kryetari me 15.11.2022 lejon që pagesa të bëhet në paradhënie në vlerë 40,676€, edhe pse ajo nuk ishte e paraparë.

Kjo ka ndodh me arsyen e operatorit ekonomik lidhur me rritjen e çmimeve në tregun e materialit të ndërtimit.

Ndikimi Pagesa e paradhënies e cila nuk ishte paraparë me dosjen e tenderit dhe kontratën e lidhur mes palëve mund të ndikojë që komuna të mos jetë një trajtim të barabartë dhe transparente me operatorët tjerë.

Rekomandimi A1 Kryetari duhet të sigurojë se nuk do të lejojë pagesë në paradhënie nëse një gjë e tillë nuk është e paraparë me kushte të veçanta të dosjes së tenderit dhe me kontratë të lidhur mes komunës dhe operatorit ekonomik.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja A2 - Tejkallim i sasive në pozicionet e kontraktuara

Gjetja Komuna kishte hartuar paramasën dhe parallogarinë për projektin "Ndërtimi i kanalizimeve fekale dhe atmosferike". Në këtë paramasë ishin paraparë sasitë që duhet të kryhen për secilin pozicion që priten të realizohen.

Te kontrata "Ndërtimi i kanalizimeve fekale dhe atmosferike" e lidhur me datën 22.10.2021 në vlerë 92,414€, kemi vërejtur tejkallim të sasive në pozicionet e kontraktuara. Tejkallimet ishin tek pozicioni i punëve paraprake, vlera e kontraktuar ishte 900€, ndërsa e realizuar 1,453€, pozicioni punët e gërmimit vlera e kontraktuar 16,969€ e realizuar 27,368€, pozicioni punët

latuese të kontraktuar 200€ të realizuara 1,036€, punët montuese të kontraktuar 43,665€ të realizuara 45,462€. Ndërsa pozicionet të cilat nuk ishin realizuar sipas kontratës ishin: punët e kanalizimit atmosferik të kontraktuar 17,834€ të realizuar 4,409€, punët e betonit të kontraktuar 10,635€, të realizuara 8,800€. Edhe pse kishte ndryshime materiale në kontratë. Komuna nuk e kishte ndryshuar a po ndërpre kontratën. Vlen të theksohet se kontrata në total nuk është tejkaluar.

Ndryshimi i pozicioneve të kontraktuar ka ndodhur si rezultat hartimit të paramasës dhe parallogarisë në mungesë të projektit ekzekutiv.

Ndikimi Tejkalmi i pozicioneve të kontraktuara në njërën anë dhe mosrealizimi i pozicioneve nga ana tjetër, ndikon që kontrata mos të realizohet dhe mos ta arrij qëllimin e paraparë.

Rekomandimi A2 Kryetari duhet të sigurojë se në rastet kur ka ndryshime materiale të pozicioneve të realizuara krahas të pozicioneve kontraktuara kontratat e tilla të ndërpriten.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja A3 - Vonesa në deponimin e mjeteve në llogari bankare

Gjetja Neni 11 paragrafi 2 i Rregullës Financiare 03/2010 për të hyrat parasheh se "Në fund të ditës paratë e grumbulluara në arkat e OB-ve duhet të depozitohen në total për çdo lloj të të hyre përmes agjencive mbledhëse me faturë përmbledhëse të përcaktuara me numrin identifikues UNIREF".

Mjetet monetare në vlerë 4,080€, të grumbulluara gjatë muajit janar (05-28.01.2022) nga taksa për regjistrimin e automjeteve ishin deponuar po thuajse një muaj me vonesë në bankë (data e deponimit 31.01.2022), po ashtu, mjetet monetare në vlerë 839€, të grumbulluara nga taksa për çertifikata tjera gjatë muajit nëntor (01-25.11.2022) ishin deponuar një muaj me vonesë në bankë (data e deponimit 30.11.2022).

Kjo ka ndodh nga pakujdesia e zyrtarit përgjegjës për t'i deponuar mjetet monetare në llogarinë bankare të komunës.

Ndikimi Mbajtja e mjeteve në arkën e komunës për pa i deponuar në llogari bankare për një periudhë një mujore, mund të ndikoj në humbjen a po tjetërsimin e mjeteve të mbledhura.

Rekomandimi A3 Kryetari duhet të sigurojë se mjetet monetare të grumbullara nga taksa për regjistrimin e automjeteve dhe çertifikatave do të deponohen në fund të ditës.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja B1 - Mungesa e projekteve ekzekutuese

Gjetja Rregullat dhe Udhëzuesi Operativ për Prokurimin Publik respektivisht pika 20.13 ndër tjerash parasheh se "Autoriteti Kontraktues është përgjegjës për hartimin e projektit ekzekutues dhe i cili në mënyrë mandatore duhet t'i bashkëngjitet (gjithashtu në pajisje elektronike) Specifikave Teknike, të cilat janë pjesë të dosjes së tenderit. Asnjë Autoriteti Kontraktues nuk i lejohej që të lëshojë dokumentacionin e tenderit pa bashkëngjitur përshkrimin e hollësishëm të projektit".

Në dy (2) raste, kemi vërejtur se Komuna ka lëshuar dokumentacionin e tenderit pa hartuar projekte ekzekutuese. Rastet ishin tek kontratat: "Ndërtimi i sallës së edukatës fizike SHFMU Nazim Osmani" në vlerë 315,916€ dhe "Rregullimi dhe asfaltimi i rrugëve urbane dhe rurale" në vlerë 275,843€.

Kjo ka ndodhur nga pakujdesia e Komunës për të hartuar projekte ekzekutuese ashtu siç kërkohet me kërkesat ligjore.

Ndikimi Mungesa e projektit ekzekutues mund të shkaktoj vështirësi në realizimin e projekteve gjatë fazës së ekzekutimit, dhe rritë rrezikun që gjatë procesit të ekzekutimit të projekteve të paraqiten pengesa të ndryshme si në aspektin profesional, ashtu edhe në vonesat e punimeve apo edhe në rritjen e kostove të projekteve.

Rekomandimi B1 Kryetari të sigurojë kontrolle dhe monitoroj zbatimin e kërkesave ligjore, që me rastin e inicimit të procedurave të prokurimit për kontraktimin e punëve të sigurohet paraprakisht hartimi i projekteve në përputhje me nevojat dhe kërkesat e parashikuara.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)**Çështja A4 - Mungesa e dokumenteve që ndërlidhen me kërkesat e përshtatshmërisë në platformën elektronike të prokurimit publik**

Gjetja Pika 49.18 e Rregullës dhe Udhëzuesit Operativ për Prokurimin Publik parasheh se "Verifikimi i përshtatshmërisë, dhe kualifikimeve të ofertuesve, bëhet përmes Letrës standarde B47 Kërkese për sqarimin e tenderit/aplikacionit përmes platformës elektronike".

Kemi vërejt se dokumentet e kërkuara sipas kërkesave të përshtatshmërisë për fituesin e kontratës siç janë vërtetimi nga gjykata kompetente, vërtetimi i ATK-së, nuk ishin vendosur në platformën elektronike të e-prokurimit. Rastet e vërejtura janë te kontrata "Renovim i ndërtesës të pallatit i kulturës" vlera e kontratës 28,577€, "Shërbimet e zërit" vlera e kontratës 22,590€ dhe "Furnizim me lëndë djegëse pelet" vlera e kontratës 78,090€.

Sipas shpjegimeve të zyrtarit të prokurimit kjo ka ndodh me arsyetim se dokumentet në fjalë janë kërkuar origjinal.

Ndikimi Mungesa e dokumenteve të përshtatshmërisë në platformën elektronike ndikon në mosrespektimin e kërkesës ligjore, dhe në mos marrjen e informatave në mënyrë elektronike nga përdoruesit e lejuar.

Rekomandimi A4 Kryetari duhet të shtoj kontrollet tek zyra e prokurimit për të siguruar se të gjitha dokumentet e kërkuar ngarkohen në platformën elektronike të prokurimit publik.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja A5 - Çertifikim i pagesës në mungesë të raportit të menaxherit të projektit

Gjetja Pika 61.20 a dhe k e Rregullës dhe Udhëzuesit Operativ për Prokurimin Publik parasheh se një ndër funksionet e menaxherit të projektit është dhe "Të sigurojë që Operatori ekonomik i përmbush të gjitha obligimet e performancës apo dërgesës në përputhje me termat dhe kushtet e kontratës dhe t'i dorëzojë raportet mbi progresin ose kompletimin e një kontrate siç kërkohet nga Departamenti i Prokurimit ose nga ZKA". Po ashtu vendimi i nxjerr nga Kryetari i Komunës për emërimin e menaxherit të kontratës parasheh " Menaxheri i projektit do të jetë përgjegjës për menaxhimin e projektit dhe do t'i raportoj me shkrim zyrës së prokurimit dhe zyrës së Kryetarit të Komunës për realizimin e punëve". Më tutje, neni 25 paragrafi 1.2 i Rregullës financiare nr. 01/2013 MF shpenzimi i parave publike parasheh " Çertifikuesi të siguroj që kushtet e zbatueshme të një kontrate publike të jenë përmbushur para regjistrimit të shpenzimit në SIMFK dhe autorizimit të pagesave".

Te pagesa për furnizim me pajisje mjekësore në vlerë 11,000€ dhe pagesa në vlerë 7,492€, për furnizim me veshmbathje për punëtorët shëndetësor, menaxherët e projekteve nuk kishin hartuar raportet mbi progresin ose kompletimin e kontratës. Pagesa ishte çertifikuar pa raport të menaxherti të projektit vetëm me raport të komisionit për pranim të mallit.

Kjo ka ndodhur si rezultat i mosnjohurive të menaxherëve të kontratës për të hartuar raportin mbi progresin e kontratës.

Ndikimi Mos raportimi me shkrim i menaxherëve të projektit, rrit rrezikun që pagesa të ekzekutohet përderisa punët/ mallrat dhe shërbimet të mos pranohen sipas termave dhe kushteve të kontratës.

Rekomandimi A5 Kryetari duhet të sigurojë se menaxherët e projekteve do të raportojnë me shkrim në lidhje me përmbushjen e kontratës nga operatori ekonomik si dhe certifikimi i pagesës të bëhet vetëm pasi që është siguruar raporti me shkrim nga menaxherët e projekteve.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja A6 - Regjistrat e menaxhimit të kontratave jo përmes platformës së e-prokurimit

Gjetja Pika 61. Menaxhimi i Kontratës dhe Vlerësimi i performancës se kontraktuesve paragrafi 20.f. i Rregullës dhe Udhëzuesit Operativ për Prokurimin Publik parasheh "Të sigurojë që të gjitha regjistrat e menaxhimit të kontratës të përgatiten, mbahen dhe arkivohen në modulën për menaxhim të kontratës në sistem të prokurimit elektronik"

Komuna e Kaçanikut menaxhimin e kontratave dhe vlerësimin e performancës se kontraktuesve nuk e ka mbajt dhe arkivuar përmes

sistemit elektronik të prokurimit publik.

Kjo ka ndodhur si rezultat i neglizhencës të menaxherëve të projekteve.

- Ndikimi** Mosmbajtja dhe arkivimi i kontratave përmes sistemit të prokurimit publik mund të ndikoj në një menaxhim jo të mirëfilltë të kontratave si dhe nuk ofron mundësi e mjaftueshme që menaxhmenti të merr informata me kohë në lidhje me progresin dhe performancën e kontratave.
- Rekomandimi A6** Kryetari duhet të kërkojë nga të gjithë menaxherët e projekteve për tu siguruar që menaxhimi i kontratave do të mbahet dhe arkivohet nga sistemi elektronik i prokurimit publik.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja A7 - Mbivlerësimi i Llogarive të arkëtueshme në RVF

- Gjetja** Neni 16 i rregullores 01/2017 Për raportim vjetor nga Organizata Buxhetore përcakton "Organizatat buxhetore që mbledhin të hyra janë të obliguara të mbajnë regjistra të të hyrave të mbledhura dhe shumave të faturuara e të pa arkëtuara. Të arkëtueshmet shpalosen në raportin vjetor financiar në tabelën përkatëse sipas llojit të hyrave".

Kemi vërejtur se llogarit e arkëtueshme ishin mbivlerësuar për 22,631€. Kjo vlerë ishte paguar në vitin 2022, nga palët si tatim në pronë, mirëpo zyrtari i cili mban regjistrat e LIA nuk e kishte shlyer nga regjistri i të arkëtueshmeve.

Shkak i prezantimit jo të saktë të vlerës së llogarive të arkëtueshme ishte pakujdesia e zyrtarit për ta azhurnuar regjistrin e llogarive të arkëtueshme.

- Ndikimi** Mbivlerësimi i llogarive të arkëtueshme ndikon që vlerat e prezantuar RVF të mos prezantojnë pamje të drejtë dhe krijon paqartësi tek përdoruesit e saj.
- Rekomandimi A7** Kryetari duhet të siguroj se me rastin e përgatitjes së RVF, zbatohen procedurat adekuate të kontrollit të brendshëm duke verifikuar saktësinë dhe plotësinë e të dhënave për llogaritë e arkëtueshme.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja B2 - Regjistrimi i pasurisë në klasën e gabuar

- Gjetja** Rregullorja MF-Nr. 02/2013 për Menaxhimin e Pasurisë jo Financiare në Organizatat Buxhetore, Neni 6 paragrafi 1 përcakton se "Çdo organizatë buxhetore duhet të krijojë dhe azhurnoj regjistrin e pasurive jo financiare që i ka në menaxhimin e saj. Regjistri duhet të mbahet ndaras për çdo pasuri dhe në formë të agreguar sipas kategorive të klasifikuara në bazë të planit kontabël".

Komuna në vitin 2022, veturën e blerë në vlerë 24,850€, nuk e kishte regjistruar në klasën automjet transporti ku periudha e zhvlerësimit është 7 vite, mirëpo e ka regjistruar në klasën pajisje mjekësore ku periudha e zhvlerësimit është 5 vite.

Kjo ka ndodh si rezultat i pakujdesisë së zyrtarit të pasurisë për ta regjistruar pasurinë në klasën e duhur.

- Ndikimi** Mos regjistrimi i pasurisë në klasën e duhur ndikon që norma e zhvlerësimit të jetë jo e drejtë dhe me ç'rast pasuria nënvlerësohet.
- Rekomandimi B2** Kryetari duhet të sigurojë zbatimin e drejtë të kontrolleve të brendshme lidhur me regjistrimin e drejtë të pasurisë jo financiare kapitale në pajtim me kriteret e rregullores për menaxhimin e pasurisë jo financiare.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

2.2 Çështjet tjera të menaxhimit financiar dhe të pajtueshmërisë

2.2.1 Të arkëtueshmet

Komuna në vitin 2022 ka shpalosur në RVF llogaritë e arkëtueshme në vlerë 1,830,089€. Krahësuar me vitin e kaluar (1,711,597€), ato janë rritur për 118,492€.

Çështja A8 - Dobësi në menaxhimin e llogarive të arkëtueshme

Gjetja Sipas nenit 26 të Ligjit për tatimin në pronën e paluajtshme 06-L 005, Komuna, Ministria e Financave dhe organet kompetente përmbaruese kanë autoritetin dhe kompetencat për të mbledhur detyrimet tatimore të papaguara që kalojnë shumën e dhjetë (10) Eurove dhe neni 27 Nëse një tatimpagues apo debitor nuk ka paguar plotësisht tatimin dhe gjobën nëse ka të këtillë, ose detyrimet tatimore të papaguara, në përputhje me afatet e përcaktuara, komuna nxjerr njoftimin përfundimtar me shkrim brenda dhjetë (10) ditëve pune pas ditës së fundit për pagesë, ku kërkon pagesën e plotë të detyrimeve tatimore të papaguara, jo më vonë se dhjetë (10) ditë kalendarike pas ditës që njoftimi përfundimtar konsiderohet të jetë pranuar nga debitori.

Arkëtimi i të hyrave tjera duhet të bëhet sipas afateve kohore të përcaktuar në faturë për secilin lloj të të hyrave.

Komuna nuk kishte menaxhim efektiv në mbledhjen e llogarive të Arkëtueshmeve (LLA) pasi që vazhdon rritja e tyre nëpër vite. Për mostrat tona nuk kemi vërejt që Komuna ka marrë ndonjë veprim konkret për vitin 2022 për inkasimin e LLA. Pjesëmarrjen më të madhe të të arkëtueshmeve e ka tatimi në pronë me 1,557,227€, taksa në biznese 222,020€, qiraja nga objektet (parcelat) 50,841€.

Dobësitë e identifikuara lidhur me llogaritë e arkëtueshme janë për shkak të kontrolleve të brendshme jo efektive në menaxhimin përkatës të arkëtimit të tyre.

Ndikimi Mos arkëtimi në kohë i të hyrave të ngarkuara ndikon në nivelin e fondeve të mbledhura për buxhetin komunal dhe reflekton negativisht në financimin dhe realizimin e projekteve nga të hyrat vetanake.

Rekomandimi A8 Kryetari të sigurojë përmirësimin e procesit të menaxhimit të llogarive të arkëtueshme në mënyrë të rritjes së efikasitetit në arkëtimin e tyre.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

3 Informacion i përmbledhur për planifikimin dhe realizimin e buxhetit

Ne kemi marrë parasysh burimet e fondeve buxhetore, shpenzimin e fondeve dhe të ardhurave të mbledhura nga kategoritë ekonomike. Kjo është theksuar në tabelat e mëposhtme:

Tabela 1. Shpenzimet sipas burimeve të fondeve buxhetore (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti final ⁵	2022 Shpenzimet	2021 Shpenzimet	2020 Shpenzimet
Burimet e fondeve	9,193,167	9,994,256	8,975,661	8,653,621	9,025,466
Grante Qeveritare - Buxheti	8,503,737	8,510,211	8,111,286	7,839,535	8,499,061
Financimi përmes huamarrjes	0	77,104	73,968	22,929	66,825
Të bartura nga viti i kaluar	0	706,271	386,278	365,273	145,987
Të hyrat vetanake	689,430	689,430	395,449	404,714	302,734
Donacionet vendore	0	11,241	8,680	21,169	10,859

Buxheti final në raport me buxhetin fillestar ishte rritur për 801,089€. Kjo rritje është rezultat i Vendimeve të Qeverisë, i bartjes së të hyrave vetjake nga viti paraprak, financimit nga huamarrja si dhe donacioneve.

Në vitin 2022 Komuna ka shpenzuar rreth 90% të buxhetit përfundimtar. Kjo paraqet një performancë të mirë buxhetore.

Tabela 2. Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike (në €)


Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti final	2022 Shpenzimet	2021 Shpenzimet	2020 Shpenzimet
Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike	9,193,167	9,994,256	8,975,661	8,653,621	9,025,466
Pagat dhe mëditjet	5,289,743	5,373,320	5,069,788	5,058,048	5,232,500
Mallrat dhe shërbimet	909,423	973,120	969,418	826,344	1,725,418
Komunalitë	221,000	197,805	176,626	188,597	183,233
Subvencionet dhe transferet	300,000	347,424	322,604	300,804	230,235
Investimet Kapitale	2,203,001	3,092,587	2,437,225	2,279,828	1,654,079
Rezervat	270,000	10,000	0	0	0

Shpjegimet për ndryshimet në kategoritë e buxhetit janë dhënë më poshtë:

- Buxheti final për paga dhe mëditje ishte rritur për 83,577€, krahasuar me buxhetin fillestar. Kjo rritje ishte nga fondi i huamarrjes sipas vendimeve të qeverisë për shtesa në shëndetësi në vlerë 77,103 dhe me vendim të qeverisë rritje për 6,474€.
- Buxheti final për mallra dhe shërbime ishte rritur për 63,697€. Rritja ishte si rezultat i bartjes së mjeteve me vendim të Kuvendit Komunal nga investimet kapitale në mallra për 66,832€, zvogëlim si rezultat i transferit nga mallrat në subvencione në vlerë 5,535€, rritje nga donacionet për 2,400€.
- Buxheti final për shpenzime komunale ishte zvogëluar për 23,195€, krahasuar me buxhetin fillestar. Zvogëlimi kishte ndodhur me vendim nga Kuvendi Komunal për transfer të mjeteve buxhetore nga granditë e qeverisë në kategorinë subvencione dhe transfere.
- Buxheti final krahasuar me buxhetin fillestar për subvencione ishte rritur për 47,424€, nga kjo vlerë: 23,195€ janë rrit si rezultat i bartjes nga kategoria e komunalive dhe 5,535€ nga mallrat në subvencione, 10,000€, rritje nga të hyrat vetanake të bartura dhe 8,694€ janë rritje nga granditë e donatorëve. Mjetet ishin planifikuar të shpenzohen kryesisht në subvencionimin e fermerëve, financimin e OJQ-ve dhe përfituesve individual.
- Buxheti final për shpenzime kapitale krahasuar me buxhetin fillestar ishte rritur për 889,586€. Rritja ishte si rezultat i të hyrave vetjake të pashpenzuara nga viti 2021 në vlerë 696,271€, rritje nga transferi i rezervës me vendim të Kuvendit Komunal në fondin 10 në vlerë 210,000€, dhe në fondin 22 në vlerë 50,000€, zvogëlim për 66,832€, ku me vendim të Kuvendit Komunal nga investimet kapitale ishin transferuar në mallra dhe shërbime dhe rritje prej 147€ nga granditë e donatorëve.

Mjetet e shpenzuara në vitin 2022 për Rimëkëmbjen Ekonomike ishin 77,103€, ato kryesisht ishin ndarë për shtesa në shëndetësi.

Grafiku 1. Shpenzimet sipas kategorive ekonomike për vitin 2022



Të hyrat vetjake të planifikuara për vitin 2022 ishin 689,430€, përderisa ishin realizuar 682,981€. Ato kanë të bëjnë me të hyrat nga tatimi në pronë, të hyrat nga lejet e ndërtimit, taksat administrative, të hyrat nga veprimtaritë biznesore, të hyrat nga qiraja etj. Po ashtu, komuna këtë vit ka pranuar të hyra nga gjobat nga trafiku dhe gjobat e gjykatës në vlerë totale prej 196,378€, si dhe të hyra nga Agjencioni i Pyjeve të Kosovës në vlerë 12,720€. Këto të hyra nuk janë të përfshira në tabelën e mëposhtme për arsye se këto i planifikojnë dhe realizojnë ministritë e linjës.

Tabela 3. Të hyrat (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti final	2022 Pranimet	2021 Pranimet	2020 Pranimet
Totali i të hyrave	689,430	689,430	682,981	802,799	561,138
Të hyrat tatimore	410,955	410,955	380,303	374,793	263,487
Të hyrat jo tatimore	278,475	278,475	302,678	428,006	297,651

4 Progresi në zbatimin e rekomandimeve

Raporti i auditimit për PFV-të të vitit 2021, kishte rezultuar me shtatë 7 rekomandime. Komuna kishte përgatitur Planin e Veprimit ku paraqitet mënyra se si do t'i zbatoj rekomandimet e dhëna. Raporti i auditimit i vitit 2021 ishte diskutuar në Asamblenë Komunale. Deri në fund të auditimit tonë për vitin 2022, pesë (5) rekomandime janë zbatuar; dhe dy (2) rekomandime nuk janë zbatuar ende, siç është paraqitur në Grafikon 2, më poshtë. Për një përshkrim më të plotë të rekomandimeve dhe mënyrën se si janë trajtuar ato, shihni në Tabelën 4 (ose Tabelën e rekomandimeve).

Grafiku 2. Progresi në zbatimin e rekomandimeve të vitit paraprak




Tabela 4 Përmbledhja e rekomandimeve të vitit paraprak

Nr	Fusha e Auditimit	Rekomandimet e vitit 2021	Veprimet e ndërmarra	Statusi
1.	Baza për opinion	Kryetari duhet të sigurojë zbatimin e drejtë të kontrolleve të brendshme lidhur me regjistrimin e drejtë të pasurisë jo financiare kapitale në pajtim me kriteret e rregullores për menaxhimin e pasurisë jo financiare.	Edhe në vitin 2022 kemi rast kur pasuria nuk është regjistruar në klasën e duhur	Nuk ka filluar zbatimin
2.	Baza për opinion	Kryetari duhet të sigurojë që janë ndërmarrë të gjitha veprimet e nevojshme që shpenzimet të planifikohen në ndarjet adekuate të buxhetit apo të bëhet ridestinimi i mjeteve që pagesa dhe regjistrimi i shpenzimeve më pas të bëhet sipas kodeve ekonomike adekuate.	Nuk kemi hasur gjetje të kësaj natyre.	I zbatuar
3.	Baza për konkluzion	Kryetari të sigurojë kontrolle dhe monitoroj zbatimin e kërkesave ligjore, që me rastin e inicimit të procedurave të prokurimit për kontraktimin e punëve të sigurohet paraprakisht hartimi i projekteve në përputhje me nevojat dhe kërkesat e parashikuara.	Edhe në vitin 2022 kishte mungesë të projekteve ekzekutive.	Nuk ka filluar zbatimin
4.	Baza për konkluzion	Kryetari duhet të sigurojë se zyra e prokurimit me rastin e hartimit të kontratave do t'i respektoj kriteret e parapara ligjore, në mënyrë që në asnjë rast të mos tejkalohet vlera e kontratave.	Nga testimi i mostrave tona nuk ka rezultuar ndonjë rast kur kishte tejkalime të kontratave publike kornizë	I zbatuar
5.	Të hyrat	Kryetari duhet të sigurojë arritjen e verifikimit të 20% të pronave të paluajtshme në mënyrë që ndryshimet eventuale të pronave të integrohen në bazën e të dhënave për të reflektuar detyrimin e saktë tatimor.	Komuna në vitin 2022 kishte arrit ta bëjë verifikimin e 20% të pronave komunale.	I zbatuar
6.	Pasuritë	Kryetari duhet të sigurojë ndërmarrjen e veprimeve të nevojshme për regjistrimin dhe raportimin e pasurisë jo kapitale në përputhje me kriteret e rregullores për menaxhimin e pasurisë jo financiare.	Komuna kishte ndërmarr veprime duke regjistruar pasurinë jokatiale në sistemin e e-pasurisë.	I zbatuar
7.	Detyrimet Kontingjente	Kryetari duhet të sigurojë se përfaqësuesi ligjor i Komunës me rastin e përgatitjes së RVF do t'i ofroj tek financat regjistrat e plotë të detyrimeve kontingjente.	Komuna detyrimet kontingjente i kishte raportuar konform regjistrat. Nuk kemi vërejt ndonjë çështje.	I zbatuar

Vlora Spanca, Auditore e Përgjithshme



Zukë Zuka, Ndihmës Auditor i Përgjithshëm



Lavdim Maxhuni, Drejtor i Auditimit




Florim Beqiri, Udhëheqës i ekipit



Muharrem Qyqalla, Anëtar i ekipit



Mexhit Ferati, Anëtar i ekipit



Shtojca I: Letër konfirmimi



Komuna e Kaçanikut

Opština Kačanik

Municipal Kaçanik

LETËR E KONFIRMIMIT

Për pajtueshmërinë me gjetjet e Auditorit të Përgjithshëm për vitin 2022 dhe për zbatimin e rekomandimeve

Për: Zyrën e Kombëtare të Auditimit

Të nderuar,

Përmes kësaj shkrese, konfirmoj se:

- kam pranuar draft raportin e Zyrës Kombëtare të Auditimit për auditimin e Pasqyrave Financiare të Komunitetit të Kaçanikut, për vitin 2022 (në tekstin e mëtejshëm "Raporti");
- pajtohem me gjetjet dhe rekomandimet dhe nuk kam ndonjë koment për përmbajtjen e Raportit; si dhe
- brenda 30 ditëve nga pranimi i Raportit final, do t'ju dorëzoj një plan të veprimit për zbatimin e rekomandimeve, i cili do të përfshijë afatet kohore dhe stafin përgjegjës për zbatimin e tyre.

Z. Besim Ilazi-Kryetar i Komunes,

Data: 25, prill 2023, Kaçanik,



Shtojca II: Shpjegim lidhur me llojet e të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA dhe pjesëve të tjera të Raportit të Auditimit

Raporti i auditorit për pasqyrat financiare⁶ duhet të përmbajë një opinion për pasqyrat financiare, bazuar në përfundimet e nxjerra nga dëshmitë e marra gjatë auditimit. Kur auditimi kryhet për të vlerësuar gjithashtu përputhjen me legjislacionin dhe rregulloret e tjera, auditorët kanë një përgjegjësi shtesë për të raportuar për pajtueshmërinë me autoritetet⁷, duke rezultuar me konkluzion mbi pajtueshmërinë.

Për të arritur në përfundimin se një opinion mbi pasqyrat financiare është i modifikuar ose i pa modifikuar, një auditor duhet të sigurohet që rezultatet e auditimit përfshijnë, apo jo, keq-deklarim (e) material(e) ose të përhapur(a), apo të tillë(a) të mundshëm(me), të supozuar në rast kufizimi të fushëveprimit.

Keq-deklarimi është një ndryshim mes shumës së raportuar, klasifikimit, prezantimit ose zbulimit të një zëri të pasqyrës financiare dhe sasisë, klasifikimit, prezantimit ose zbulimit që kërkohet që zëri të jetë në përputhje me kornizën e raportimit financiar në fuqi. Keq-deklarimet mund të vijnë nga gabimi ose mashtrimi.

(shkëputur nga SNISA 200)

Forma e opinionit

Opinion i pa-modifikuar

Formulohet kur nuk janë zbuluar keq-deklarime ose mos-pajtueshmëri; kur janë zbuluar keq-deklarime ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, por që nuk është i barabartë me ose nuk e tejkalon nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimi(et) dhe/ose mos-pajtueshmëria e zbuluar brenda një klase të caktuar transaksionesh nuk është e barabartë me ose e tejkalon nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve. Formulohet gjithashtu nëse nuk ka kufizim të fushëveprimit ose kur kufizimi i fushëveprimit nuk mund të shpie në shmangie të keq-deklarimit(eve) material(e) dhe/ose mos-pajtueshmërisë(ve).

Kufizimi i fushëveprimit ndodh kur një auditor nuk është në gjendje të marrë dëshmi të mjaftueshme auditimi për të arritur në përfundimin se pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale.

Auditori duhet të japë **opinion të pa-modifikuar** nëse arrin në përfundimin se pasqyrat financiare janë përgatitur, në të gjitha aspektet materiale, në pajtim me kornizën e zbatueshme financiare.

Modifikimi i opinionit në raportin e auditorit

Auditori duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit nëse konstatohet se, bazuar në dëshmitë e marra nga auditimi, pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale dhe/ose mos-pajtueshmëri, ose nuk është në gjendje të sigurojë prova të mjaftueshme të auditimit për të arritur në përfundimin se pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale dhe/ose mos-pajtueshmëri..

Opinionit i modifikuar mund të jetë:

- I kualifikuar,
- I kundërt, ose
- Mohim opinionit

Opinionit i kualifikuar

Formulohet kur janë zbuluar keq-deklarime dhe/ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, që janë të barabartë me ose e tejkalojnë nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimi dhe/ose mos-pajtueshmëria e zbuluar brenda një klase të caktuar transaksionesh është i barabartë me ose tejkalon nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve. Formulohet gjithashtu nëse ka kufizim të fushëveprimit, i cili mund të mos shpie në shmangie të keq-deklarimit(eve) material(e).

Opinion i kundërt

Formulohet kur janë zbuluar keq-deklarime dhe/ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, që tejkalon në mënyrë të përhapur nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimet dhe/ose mos-pajtueshmëritë e zbuluara brenda një klase të caktuar transaksionesh e tejkalojnë në mënyrë të përhapur nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve.

"E përhapur" është term që përdoret, në kontekstin e keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërive, për të përshkruar efektet e keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërisë në pasqyrat financiare; ose efektet e mundshme në pasqyrat financiare të keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërisë, nëse ka të tilla, që nuk zbulohen për shkak të pamundësisë për të marrë dëshmi të mjaftueshme e të duhura të auditimit. Efektet e përhapura në pasqyrat financiare janë ato që, sipas gjykimit të auditorit::

- a) Nuk kufizohen vetëm në elemente, llogari ose zëra të veçantë të pasqyrave financiare;
- b) Por nëse kufizohen si të tilla, përfaqësojnë ose mund të përfaqësojnë një pjesë të konsiderueshme të pasqyrave financiare; ose
- c) Për sa i përket shpalosjeve, janë thelbësore që përdoruesit të kuptojnë pasqyrat financiare.

Mohim i opinionit

Formulohet kur kufizimi i fushëveprimit, d.m.th. kur pamundësia për të siguruar prova të mjaftueshme të përshtatshme të auditimit, është i natyrës materiale dhe pervazive.

Paragrafët e Theksimit të Çështjes dhe paragrafët e Çështjeve të Tjera në raportin e auditorit

Nëse auditori e konsideron të nevojshme të tërheqë vëmendjen e përdoruesve në një çështje të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila është sa e rëndësishme aq edhe thelbësore që ata të kuptojnë pasqyrat financiare, por ka dëshmi të mjaftueshme e të përshtatshme se çështja nuk përmban keq-deklarime materiale në pasqyrat financiare, auditori duhet të përfshijë paragrafin e Theksimit të çështjes në raportin e tij. Paragrafi për Theksimin e Çështjes duhet t'i referohet vetëm informacionit të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare.

Paragrafi i theksimit të çështjes duhet:

- të përfshihet menjëherë pas opinionit;
- të ketë titullin 'theksim i çështjes' ose ndonjë titull tjetër të përshtatshëm;
- të përmbajë një referencë të qartë ndaj çështjes që theksohet dhe të tregojë se në ç'pjesë të pasqyrave financiare mund të gjenden shpalosjet relevante që e përshkruajnë plotësisht çështjen; dhe
- të tregojë se opinionit i auditimit nuk është modifikuar për sa i përket çështjes të theksuar.

Nëse auditori e konsideron të nevojshme të komunikojë një çështje, përveç atyre që janë paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila, në gjykimin e auditorit, është e rëndësishme për përdoruesit në mënyrë që të kuptojnë auditimin, përgjegjësitë e auditorit apo raportin e auditimit, dhe me kusht që kjo nuk është e ndaluar me ligj ose rregullore, duhet të përpilohet një paragraf me titullin "Çështje të tjera", apo ndonjë titull tjetër të përshtatshëm. Ky paragraf duhet të paraqitet menjëherë pas opinionit dhe pas çdo paragrafi të Theksimit të çështjes.

Shënimet fundore

- ¹ Pajtueshmëria me autoritetet - pajtueshmëria me të gjitha ligjet, rregullat, rregulloret, standardet dhe praktikat e mira relevante në sektorin publik
- ² Raportet tjera janë kërkesë e nenit 8 të së Rregullores 01/2017 për Raportim Vjetor Financiar
- ³ Kolektivisht të referuara si pajtueshmëri me autoritetet
- ⁴ Çështja A dhe Rekomandimi A - nënkupton çështjet dhe rekomandimet e reja
Çështja B dhe Rekomandimi B - nënkupton çështjet dhe rekomandimet e përsëritura
Çështja C dhe Rekomandimi C- nënkupton çështjet dhe rekomandimet pjesërisht të përsëritura.
- ⁵ Buxheti Final - buxheti i aprovuar nga Kuvendi i përshtatur më pas nga Ministria e Financave
- ⁶ Pasqyrat financiare në sektorin publik përfshijnë po ashtu edhe pasqyrën(at) e ekzekutimit të buxhetit
- ⁷ Pajtueshmëria me autoritetet: pajtueshmëria me ligjet, rregulloret, standardet, apo praktikat e mira.



REPUBLIKA E KOSOVES
RE PUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E KAÇANIKUT
OPŠTINA KAÇANIK



1	Data	19.06.23	Vendi	Kaçanik
Mj. org.	Numri		Shitje	
01	104/02-16581	1.		

Komuna e Kaçanikut
Opština Kaçanik
Municipal Kaçanik

Për Kuvendin Komunal-Kaçanik;

Zyrën Kombëtare të Auditimit

Nga z.Besim Ilazi, Kryetar i Komunës

Për:



PLANI I VEPRIMIT PËR ZBATIMIN E
REKOMANDIMEVE
të dhëna në Raportin e Auditimit nga Zyra
Kombëtare e Auditimit për PFV'2022

Nr.	Komponenta e Auditimit (Kapitulli)	Gjetja	Rekomandimi	Veprimet e planifikuara për tu ndërmarrë	Zyrtari/ët përgjegjës	Data e planifikuar e zbatimit të rekomandimit	Kom ente
1	Çështja A1 – Pagesa e avansit prej 10% të vlerës së kontratës për investime kapitale pa u paraparë në kontratë dhe me kushte të veçanta.	Te projekti “Ndërtimi i objektit për banim social” në vlerë 406,747€, e lidhur më 19.10.2022, zyra e prokurimit në dosjen e tenderit të kushtet e veçanta të kontratës si dhe te kontrata e lidhur me operatorin ekonomik nuk e kishte paraparë pagesën në paradhënie. Menaxheri i projektit dhe operatorit ekonomik në muajin nëntor të vitit 2022 kishin kërkuar lejim të paradhënies prej 10% të vlerës së kontratës, me q’rast Kryetari me 15.11.2022 lejon që pagesa të bëhet në paradhënie në vlerë 40,676€, edhe pse ajo nuk ishte e paraparë. Kjo ka ndodh me arsyen e operatorit ekonomik lidhur me rritjen e çmimeve në tregun e materialit të ndërtimit.	Kryetari duhet të sigurojë se nuk do të lejojë pagesë në paradhënie nëse një gjë e tillë nuk është e paraparë me kushte të veçanta të dosjes së tenderit dhe me kontratë të lidhur mes komunës dhe operatorit ekonomik.	Zyra e Prokurimit me rastin e lidhjes se kontrates duhet ti parashohë paradhëniet per ndryshe nuk duhet te percillen per pagesë paradheniet.	Udhëheqësi I Zyres se Prokurimit, Menaxheri i Kontates, Kryetari i Komunes, Zyrtari Certifikues dhe Zyrtari Kryesor Financiar (ZKF) i komunës.	Janar – Dhjetor 2023	
2	Çështja A2 – Tejkalim i sasive në pozicionet e kontraktuara.	Komuna kishte hartuar paramasën dhe parallogarinë për projektin “Ndërtimi i kanalizimeve fekale dhe atmosferike”. Në këtë paramasë ishin paraparë sasitë që duhet të kryhen për secilin pozicion që priten të realizohen. Te kontrata “Ndërtimi i kanalizimeve fekale dhe atmosferike” e lidhur me datën 22.10.2021 në vlerë 92,414€, kemi	Kryetari duhet të sigurojë se në rastet kur ka ndryshime materiale të pozicioneve të realizuara krahas të pozicioneve kontraktuara kontratat e tilla të	Do të veprohet conform ligjeve dhe rekomandimit perkates te Auditorit te Jashtem.	Udhëheqësi I Zyres se Prokurimit, Menaxheri i Kontates, Kryetari i Komunes.	Janar – Dhjetor 2023	

		vërejtur tejkalim të sasive në pozicionet e kontraktuara. Tejkalimet ishin tek pozicioni i punëve paraprake, vlera e kontraktuar ishte 900€, ndërsa e realizuar 1,453€, pozicioni punët e gërmimit vlera e kontraktuar 16,969€ e realizuar 27,368€, pozicioni punët latuese të kontraktuar 200€ të realizuara 1,036€, punët montuese të kontraktuar 43,665€ të realizuara 45,462€. Ndërsa pozicionet të cilat nuk ishin realizuar sipas kontratës ishin: punët e kanalizimit atmosferik të kontraktuar 17,834€ të realizuar 4,409€, punët e betonit të kontraktuar 10,635€, të realizuara 8,800€. Edhe pse kishte ndryshime materiale në kontratë. Komuna nuk e kishte ndryshuar a po ndërpre kontratën. Vlen të theksohet se kontrata në total nuk është tejkaluar. Ndryshimi i pozicioneve të kontraktuar ka ndodhur si rezultat hartimit të paramasës dhe parallogarisë në mungesë të projektit ekzekutiv.	ndërpren.				
3	Çështja A3 – Vonesa në deponimin e mjeteve në llogari bankare	Mjetet monetare në vlerë 4,080€, të grumbulluara gjatë muajit janar (05-28.01.2022) nga taksa për regjistrimin e automjeteve ishin deponuar po thuajse një muaj me vonesë në bankë (data e deponimit	Kryetari duhet të sigurojë se mjetet monetare të grumbullara nga taksa për regjistrimin e	Do të veprohet konform Rregullës Financiare 03/2010 për të hyrat parashëh se paratë e	Zyrtari i pranimit të mjeteve nga njësitë gjeneruese ne kordinim	Janar – Dhjetor 2023	

		31.01.2022), po ashtu, mjetet monetare në vlerë 839€, të grumbulluara nga taksa për certifikata tjera gjatë muajit nëntor (01-25.11.2022) ishin deponuar një muaj me vonesë në bankë (data e deponimit 30.11.2022). Kjo ka ndodh nga pakujdesia e zyrtarit përgjegjës për t'i deponuar mjetet monetare në llogarinë bankare të komunës.	automjeteve dhe certifikatave do të deponohen në fund të ditës.	grumbulluara në arkat e OB-ve duhet të depozitohen në total për çdo lloj të të hyre përmes agjencie mbledhëse me faturë përmbledhëse të përcaktuara me numrin identifikues UNIREF".	te plotë me Zyrtarin Kryesor Financiar të Komunës si personi përgjegjës për vendosjen dhe monitorimin e kontrollit të bendshem financiar.		
4	Çështja B1 – Mungesa e projekteve ekzekutuese	Në dy (2) raste, kemi vërejtur se Komuna ka lëshuar dokumentacionin e tenderit pa hartuar projekte ekzekutuese. Rastet ishin tek kontratat: "Ndërtimi i sallës së edukatës fizike SHFMU Nazim Osmani" në vlerë 315,916€ dhe "Rregullimi dhe asfaltimi i rrugëve urbane dhe rurale" në vlerë 275,843€. Kjo ka ndodhur nga pakujdesia e Komunës për të hartuar projekte ekzekutuese ashtu siç kërkohet me kërkesat ligjore.	Kryetari të sigurojë kontrole dhe monitoroj zbatimin e kërkesave ligjore, që me rastin e inicimit të procedurave të prokurimit për kontraktimin e punëve të sigurohet paraprakisht hartimi i projekteve në përputhje me nevojat dhe kërkesat e parashikuara.	Ekziston kontrata per hartimin e projekteve dhe me rastin e inicimit të procedurave të prokurimit për kontraktimin e punëve do të sigurohet paraprakisht hartimi i projekteve në përputhje me nevojat dhe kërkesat e parashikuara.	Mbajtesit e buxheteve Zyra e Prokurimit.	Janar – Dhjetor 2023	

5	Çështja A4 – Mungesa e dokumenteve që ndërlidhen me kërkesat e përshatshmërisë në platformën elektronike të prokurimit publik	Është vërejtur se dokumentet e kërkuara sipas kërkesave të përshatshmërisë për fituesin e kontratës siç janë vërtetimi nga gjykata kompetente, vërtetimi i ATK-së, nuk ishin vendosur në platformën elektronike të e-prokurimit. Rastet e vërejtura janë të kontrata "Renovim i ndërtesës të pallati i kulturës" vlera e kontratës 28,577€, "Shërbimet e zërimit" vlera e kontratës 22,590€ dhe "Furnizim me lëndë djegëse pellet" vlera e kontratës 78,090€.	Mungesa e dokumenteve të përshatshmërisë në platformën elektronike ndikon në mosrespektimin e kërkesës ligjore, dhe në mos marrjen e informatave në mënyrë elektronike nga përdoruesit e lejuar.	Do të respektohen ne perpikmeri rregullat strikte që dokumentet e kërkuara sipas kërkesave të përshatshmërisë për fituesin e kontratës siç janë vërtetimi nga gjykata kompetente, vërtetimi i ATK-së, te vendosen në platformën elektronike të e-prokurimit	Zyra e Prokurimit		
6	Çështja A5 – Certifikim i pagesës në mungesë të raportit të menaxherit të projektit	Neni 25 paragrafi 1.2 i Rregullës financiare nr. 01/2013 MF shpenzimi i parave publike parashihet " Certifikuesi të siguroj që kushtet e zbatueshme të një kontrate publike të jenë përmbushur para regjistrimit të shpenzimit në SIMFK dhe autorizimit të pagesave". Te pagesa për furnizim me pajisje mjekësore në vlerë 11,000€ dhe pagesa në vlerë 7,492€, për furnizim me veshmbathje për punëtorët shëndetësor, menaxherët e projekteve nuk kishin hartuar raportet mbi progresin ose kompletimin e kontratës. Pagesa ishte certifikuar pa raport të	Kryetari duhet të sigurojë se menaxherët e projekteve do të raportojnë me shkrim në lidhje me përmbushjen e kontratës nga operatori ekonomik si dhe certifikimi i pagesës të bëhet vetëm pasi që është siguruar raporti me shkrim nga menaxherët e projekteve	Do të ndermiren masat e nevojshme që menaxherët e projekteve do të raportojnë me shkrim në lidhje me përmbushjen e kontratës nga operatori ekonomik si dhe certifikimi i pagesës të bëhet vetëm pasi që është siguruar	Menaxheret e kontratave dhe zyrtari Certifikues.	Janar – Dhjetor 2023	

		menaxherti të projektit vetëm me raport të komisionit për pranim të mallit.		raporti me shkrim nga menaxherët e projekteve			
7	Çështja A6 – Regjistrat e menaxhimit të kontratave jo përmes platformës së e-prokurimit	Komuna e Kaçaniikut menaxhimin e kontratave dhe vlerësimin e performancës së kontraktuesve nuk e ka mbajtur dhe aktivuar përmes sistemit elektronik të prokurimit publik. Kjo ka ndodhur si rezultat i neglizhencës të menaxherëve të projekteve.	Kryetari duhet të kërkojë nga të gjithë menaxherët e projekteve për tu siguruar që menaxhimi i kontratave do të mbahet dhe arkivohet nga sistemi elektronik i prokurimit publik.	Do të kërkohet nga të gjithë menaxherët e projekteve për tu siguruar që menaxhimi i kontratave do të mbahet dhe arkivohet nga sistemi elektronik i prokurimit publik	Menaxheret e Projekteve, Kryetari i Komunes.	Janar – Dhjetor 2023	
8	Çështja A7 – Mbivlerësimi i llogarive të arkëtueshme në RVF	Kemi vërejtur se llogarive e arkëtueshme ishin mbivlerësuar për 22,631€. Kjo vlerë ishte paguar në vitin 2022, nga palet si tatum në prone, mirëpo zyrtari i cili mban regjistrat e LIA nuk e kishte shyer nga regjistri i të arkëtueshmeve. Shkak i prezantimit jo të saktë të vlerës së llogarive të arkëtueshme ishte pakujdesia e zyrtarit për ta azhurnuar regjistrin e llogarive të arkëtueshme.	Kryetari duhet të siguroj se me rastin e përgatitjes së RVF, zbatohen procedurat adekuate të kontrollit të brendshëm duke verifikuar saktësinë dhe plotësinë e të dhënave për llogaritë e arkëtueshme.	Do të rritet kordinimi me Departamentin e Tatimit ne Prone ne MFPT, ne menyre qe azhurnimi i regjistrit te llogarive te arkëtueshme.	Menaxheri i ZTP, Zyrtari i procesimit te shenimeve.	Janar – Dhjetor 2023	
9	Çështja B2 – Regjistrimi i pasurisë në klasën e gabuar	Komuna në vitin 2022, veturën e blerë në vlerë 24,850€, nuk e kishte regjistruar në klasën automjet transporti ku periudha e zhvlerësimit është 7 vite, mirëpo e ka regjistruar në klasën pajisje	Kryetari duhet të sigurojë zbatimin e drejtë të kontrolleve të brendshme lidhur me regjistrimin e drejtë të pasurisë	Do të sigurohet zbatimi i drejtë i kontrolleve të brendshme lidhur me regjistrimin e drejtë të pasurisë	Zyrtari i regjistrimit te pasurise kapitale	Qershorë – Dhjetor 2023	

		mjekësore ku periudha e zhvlerësimit është 5 vite. Kjo ka ndodh si rezultat i pakujdesisë së zyrtarit të pasurisë për ta regjistruar pasurinë në klasën e duhur.	jo financiare kapitale në pajtim me kriteret e rregullores për menaxhimin e pasurisë jo financiare.	jo financiare kapitale në pajtim me kriteret e rregullores për menaxhimin e pasurisë jo financiare.			
10	Çështja A8 – Dobësi në menaxhimin e llogarive të arkëtueshme	Komuna nuk kishte menaxhim efektiv në mbledhjen e llogarive të Arkëtueshmeve (LLA) pasi që vazhdon rritja e tyre nëpër vite. Për mostrat tona nuk kemi vërejtë që Komuna ka marrë ndonjë veprim konkret për vitin 2022 për inkasimin e LLA. Pjesëmarrjen më të madhe të të arkëtueshmeve e ka tatimi në pronë me 1,557,227€, taksa në biznes 222,020€, qiraja nga objektet (parcelat) 50,841€.	Kryetari të sigurojë përmirësimin e procesit të menaxhimit të llogarive të arkëtueshme në mënyrë të rritjes së efikasitetit në arkëtimin e tyre.	Veprimi konkret është të inicohet procedurat përbarimore, mirepo deri me tani keto procedura përbarimore i kemi aplikuar vetëm tek një numër i tatimpagueseve që figurojnë borzjlinjë me te medhenje ndaj komunes.	Zyra e Tatimit ne Prone, Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik dhe Drejtoria e Urbanizmit.	Janar – Dhjetor 2023	



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Kaçanikut
Opština Kacanik
Municipal Kacanik

01-Nr. 4006/01-14258 /23
Kaçanik; 14.06.2023

Mbështetur në nenin 40.2 (b.) të Ligjit nr.03/L-040 – Për Vetëqeverisjen Lokale, Ligjit Nr.03/L-048 – Për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, të Ligjit nr.03/L-221. – Për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit nr.03/L-048 – Për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësit, të nenit 15 dhe 16 të Ligjit Nr. (Nr.08/L-193) - Për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2023, te nenit 61 të Statutit të komunës, Kryetari i Komunës, propozon KPF-së, këtë:

PROPOZIM VENDIM
PËR TRANSFERIN E MJETEVE NGA REZERVA KOMUNALE SIPAS BUXHETIT TË VITIT
2023

Përmes këtij Propozim Vendimi, bëhet transferi i mjeteve nga Rezerva Komunale në kategorinë e investimeve kapitale në shumën e përgjithshme prej **120,000.00** euro, sipas tabelës të Ligjit të Buxhetit Nr.08/L-193 për vitin 2023, si në vijim:

1.Transferet-fondi 10 (Granti Qeveritar)

1.1.Nga Nën-Programi Buxhetor – Buxhetimi 17528 kodi funksional 0112 nga Rezerva komunale, fondi burimorë 10 GQ, shuma prej 10,000.00 €

→ **Transferohet:** Në Nën-Programin Buxhetor – Planifikimi urban dhe inspeksioni 66445 kodi funksional 0620 në kategorinë Shpenzimet Kapitale, në projektin kapital “Rregullimi dhe asfaltimi i rrugëve në pjesën rurale-Kaçanik me kod projekti 53198, shuma 10,000.00€.

1.2.Nga Nën-Programi Buxhetor – Administrata 92140 kodi funksional 0980 nga Rezerva komunale, fondi burimorë 10 GQ, shuma prej 20,000.00 €

→ **Transferohet:** Në Nën-Programin Buxhetor – Arsimi fillor, i mesëm i ulët 93810 kodi funksional 0912 në kategorinë Shpenzimet Kapitale, në projektin kapital “Ndërtimi i kulmit të Shkollës Filllore “Qamil Ilazi” në Kaçanik të Vjetër, shuma prej 20,000.00€, projekt i ri.

1.3. Nga Nën-Programi Buxhetor – Shërbimet e shëndetësisë primare 74700 kodi funksional 0721 nga Rezerva komunale, fondi burimorë 10 GQ, shuma prej 50,000.00 €

→ **Transferohet:** Nën-Programin Buxhetor – Shërbimet e shëndetësisë primare 74700 kodi funksional 0721 në kategorinë Shpenzimet Kapitale, në projektin kapital “Blerja e automjetit (kombi) për hemodializë”, shuma prej 50,000.00€, projekt i ri.

2. Transferet-fondi 21 (Të hyrat vetanake)

2.1. Nga Nën-Programi Buxhetor – Administrata dhe Personeli 16328 kodi funksional 0133 nga Rezerva komunale, fondi burimorë 21 (HVK), shuma prej 5,000.00 €

→ **Transferohet:** Në Nën-Programin Buxhetor – Administrata dhe Personeli 16328 kodi funksional 0133, në kategorinë Shpenzimet Kapitale, ne projektin kapital "Ndertimi i parkingut nentokësorë për Administratës komunale" me kod 50995, shuma 5,000.00 €

2.2. Nga Nën-Programi Buxhetor – Buxhetimi 17528 kodi funksional 0112 nga Rezerva komunale, fondi burimorë 21 (HVK), shuma prej 20,000.00 €

→ **Transferohet:** Në Nën-Programin Buxhetor – Planifikimi urban dhe inspeksioni 66445 kodi funksional 0620 në kategorinë Shpenzimet Kapitale, ne projektin kapital "Rregullimi dhe asfaltimi i rrugëve në pjesën rurale-Kaçanik me kod projekti 53198, shuma 20,000.00€.

2.3. Nga Nën-Programi Buxhetor – Shërbimet Kulturore 85028 kodi funksional 0820 nga Rezerva komunale, fondi burimorë 21 (HVK), shuma prej 5,000.00 €

→ **Transferohet:** Në Nën-Programin Buxhetor – Shërbimet Kulturore 85028 kodi funksional 0820, në kategorinë Shpenzimet Kapitale, ne projektin kapital "Ndertimi i stadiumit te qytetit "Besnik Begunca" me kod 45064, shuma 5,000.00 €

2.4. Nga Nën-Programi Buxhetor – Administrata 92140 kodi funksional 0980 nga Rezerva komunale, fondi burimorë 21 (HVK), shuma prej 10,000.00 €

→ **Transferohet:** Në Nën-Programin Buxhetor – Arsimi fillor, i mesëm i ulët, kodi funksional 0912 në kategorinë Shpenzimet Kapitale, ne projektin kapital "Ndërtimi i kulmit të Shkollës Fillore "Qamil Ilazi" në Kaçanik të Vjetër, shuma prej 10,000.00€ projekt i ri.

1. Pjesë përbërëse e këtij Propozim-Vendimi janë Formularet standard nga MFPT. të plotesuara me shumat e lëvizura sipas Nën-Programëve buxhetore dhe kodeve ekonomike të shpenzimeve.
2. Për realizimin e këtij Propozim Vendimi, obligohet Drejtoria e Buxhetit dhe Financave, e cila drejtori të njejtin vendim do ta zbaton në Ministrinë e Financave Transfereve dhe Punës, respektivisht në Departamentin e Buxhetit dhe Departamentin e Thesarit.

Kryetari i Komunës:

Besim Ilazi

